Rruga e Arbërit

10 vjet gazeta Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 10 (126). TETOR 2016. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Mentori i Zeralinjve të Dibrës

Nga **Abdurahim Ashiku**

6

Arif Hasanaj, doktori duarartë

Nga **Defrim Methasani**

12

Ëndrra e realizuar e Osman Begut

Nga **Osman Xhili**

7

Rruga e Arbrit, tërhiqen kinezët

Oferta e tyre nuk pranohet nga qeveria

Gjoka Konstruksion: **Oferta jonë 190 milionë euro**

‘E ndërtojmë për 3 vjet’

■ Ing.**Faruk Kaba**: Mbi By-passin e tunelit të Rrugës së Arbrit ■ **Reagim i shoqatës** “Bashkësia Dibrane”: Distancohemi nga lobuesit. ■ Deklaratë e Grupit të Lobimit: **Rrugën e Arbrit ia kërkojmë qeverisë shqiptare, jo inxhinierëve dhe shoqatave qytetare** ■ **Pranvera** “pa të shtuna” e Rrugës së Arbrit ■ **Intervistë pa përgjigje** me deputetët e Qarkut të Dibrës

Lexoni në faqet 2,3,4,5,8



Dibra në libra

■ Poeti që vjen me zërin e tij në pallatin e poetëve ■ Gjeneralët e Skënderbeut Nikollë dhe Dhimitër Berisha ■ “Kashta e Kumtrit”, një ngjitje e re në shkallaren e poezisë ■ Toponimia e Çidhnës në një vështrim etnotekstor ■ Sabri Caka, krahu i shqipes në flamur ■ Një jetë në 36 shkronja ■ Jetë në veprat e mëdha ■ Musai - Portret i njeriut fisnik ■ “Historia e Dibrës” nuk është një histori pushke, por histori e mendjes ■ “Margaritari i kurorës”, dritë e shpirtit dhe e provave të besimit ■ “Botët brenda shpirtit” të Astrit Gjunkshit ■ Prof.dr. Mahmud Hysa, i pazëvendësueshëm për letërsinë shqipe ■ Gruaja që sfidoi diktaturën ■ Shihni ku i dhëmb poetit ■ Poetesha studente

Njoftim për lexuesit në SHBA, Europë dhe vende të tjera

Duke filluar nga ky numër, gazeta Rruga e Arbërit do të shpërndahet FALAS në versionin PDF për të gjithë lexuesit jashtë kufijve. Kjo bëhet e mundur falë ndihmës bujare të kompanisë KNAUF, nën kujdesin e veçantë të z. Urim Murati.

Gazetan mund ta shkarkoni falas nga www.rrugaearberit.com ose mund të na shkruani në emailin e redaksisë.

Redaksia gjen rastin të falenderojë z. URIM MURATI për angazhimin e tij që gazeta të shkojë te sa më shumë lexues.

KNAUF Bashkëpunon me komunitetin

www.knauf.al

KUJTOJMË BASHKËPUNËTORËT tanë se çdo shkrim i botuar në një media tjetër apo rrjete sociale nuk ka përparësi botimi, përveç rasteve kur kjo është konfirmuar më parë me redaksinë!

Faleminderit për mirëkuptimin!

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 10 (125). 1 - 31 Tetor 2016

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Korrespondentë të përhershëm:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Sashenka NDREKA
Hysen LIKDISHA

Kontribuan për këtë numër:
Gëzim ALPION
Shaban SINANI
Halil TEODORI
Defrim METHASANI
Fejzula GJABRI
Ahmet PRENÇI
Azis KETA
Selman MEZIU
Mevlud BUCI
Mexhit PRENÇI
Sakip CAMI
Arsim KOLARI
Ilmi DERVISHI
Halil RAMA
Vexhi GJONI

Fotoreporter: Fehmi Lleshi

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL90202112190000004700036640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Mbi By-passin e tunelit të Rrugës së Arbrit

Nga Inxh.**FARUK KABA**

Duke lexuar shkrimin e një farë grupi të ashtuquajtur "Lobistët e Rrugës së Arbërit" dhe duke menduar një përgjigje për këta zhurmëtarë të pabesë, më shkoi mendja diku në mesin e viteve '90. Sapo kisha rifilluar punë me biznesim tim privat, zyrën e projektimit. Ishte vjeshtë dhe një përmbytje e jashtëzakonshme kishte pllakosur zonën e Kurbinit në afërsi të Milotit. Argjinatura mbrojtëse e tij, veçanërisht në zonën e Fushë-Milotit, ishte çarë vende-vende dhe një telefonate nga strukturat e pushtetit vendor kishte kërkuar prezencën tonë, për të bërë të mundur projektet dhe zgjidhjet inxhinierike për rehabilitimin e saj. Në firmën tonë punonte dhe specialisti më i mirë i mbrojtjeve nga lumenjtë në vendin tonë. U nisëm sëbashku menjëherë në vend. Grupe njerëzish nga pushteti lokal dhe ai qendror, por jo vetëm, dominonin kudo, merrnin e jepnin urdhra e porosi ngado. Duke vizituar argjinaturën e dëmtuar (për fat të keq edhe nga dora e njeriut), takojmë një prift të Komunitetit të Sant'Egidio. Kishte ardhur me një ndihmë jo të vogël për atë kohë, prej rreth 100 mijë dollarësh, për të ndihmuar fshatarësinë e dëmtuar rëndë nga vërshimet e lumenjve.

Ecëm një copë rrugë nëpër argjinaturë, shkëmbyem disa mendime në mënyrë shumë miqësorë dhe kur e pyetem se si e ndjente veten këtu në Shqipëri, u kthye dhe na tha: "Shikoni, kam qenë dhe kam dorëzua r ndihma në mbi 100 vende të botës, por vetëm këtu (në Shqipëri) më ka ndodhur që të sjell ndihma e të më kërkojnë edhe llogari." Qeshem, por në të njëjtën kohë e ndjeva veten keq. Pse jemi kështu ne? Mos vallë është sjellje e njerëzve të pa-emaincipuar?... dhe provincialë?

Kaq për "lobistët" e Rrugës së Arbërit, të cilët në fakt meritojnë një dackë shembullore.

Tani, për lexuesin edhe të revoltuar me të drejtë, por që nuk i njeh të gjitha detajet: Së pari, propozimi për ndërtimin e një bajpasi në tunelin kryesor të rrugës së Arbrit, është bërë nga unë, autor i rrugës së shumë tuneli i Murrizës në rrugën e Arbrit, është një tunel me një tub, por për fatin e mirë, ka mundësinë e një bajpasi (pasi edhe mund të mos ta kishte, nëse terreni nuk do ta lejonte). Sipas normave Europiane, nëse nuk ka mundësi bajpasi, nuk lejohet ndërtimi me vetëm një tub. Ky bajpas, në çdo rast do të duhet domosdoshmërisht të ndërtohet, qoftë për arsye të thjeshta shfrytëzimi (çdo aksident brenda në tunel bllokon të gjithë lëvizjen), qoftë për arsye të ndërtimit të shpejtë të veprës (në mënyrë që të mund të punohet nga të dy skajet e tunelit)

pritur dhe autori i këtij shkrimi, drejtuar autoriteteve zyrtare, nga të cilët nuk kam marrë ende një përgjigje. Nuk është aspak e vërtetë që kjo është iniciativë e Qeverisë. Ç'është e vërtetë është e vërtetë! Sajesat që për më tepër marrin dhe erë politike, duket se synojnë më tepër nxitjen e ndjenjat e lexuesve për t'i shfrytëzuar më pas për protagonizëm të pamerituar.

Së dyti, unë e kam shpjeguar edhe më parë se propozimi "cinik" kinez, me një ofertë financiare katastrofike dhe të tej zgjatur në terma kohorë, më detyroi t'i drejtohem autoriteteve përkatëse shtetërore, me një propozim shumë racional. Madje, para se të ndërmerrja këtë nismë, kam marrë edhe mendimin e Shoqatës "Bashkësia Dibrane" (Shoqata e vërtetë që përfaqëson Dibrën dhe Dibranët) duke gjetur mbështetjen e tyre të plotë. Arsyeja është e thjeshtë: me minimumin e mundshëm të investimit (vetëm 75 milionë euro) dhe kohës, të mundësohet ndërtimi dhe rruga të vihet në shfrytëzim (për 15 deri 18 muaj). Edhe sikur të filojë ndërtimi i rrugës në këtë moment që flasim (përfshi tunelin), do të duheshin 3 vjet. Ndërkohë, duke ndërtuar rrugën dhe bajpasin me një investim shumë modest, rruga hyn në shfrytëzim në më pak se dy vjet. Pretendimi se "propozimi i Kabës është i papranueshëm", është në rastin më të mirë tregues i mos njohjes dhe injorancës sa i përket këtij projekti në tërësi. Por më shumë se kaq, duket se është veç se një sjellje cinike provinciale, që nëpërmjet kësaj vepre kërkon protagonizëm të pamerituar. Sigurisht pretenduesit nuk e dinë, që po të ishte se unë do të doja ta bëja rrugën pa tunel, si autori i kësaj vepre përfshi tunelin, mund ta kisha bërë që në fillim të studimit dhe projektimit të saj dhe askush nuk do të kish mundur ta ndryshonte. Madje gjatë procesit të studimit, shifrat (e kostos së ndërtimit dhe të dhënat e trafikut) e sugjeronin një gjë të tillë.

Por unë me urajë civile, me ndërgjegje qytetare dhe falë edhe mbështetjes së ish-ministrit të transporteve të asaj kohe, mora përsipër në fillim të viteve 2000 rojektimin e rrugës me tunel në Qaf Murrizë. Kjo është mëse e qartë dhe këtë e dinë edhe "lobistet" pa emër, por sulmi i tyre është i mirëmenduar.

Edhe një sqarim: tuneli i Murrizës në rrugën e Arbrit, është një tunel me një tub, por për fatin e mirë, ka mundësinë e një bajpasi (pasi edhe mund të mos ta kishte, nëse terreni nuk do ta lejonte). Sipas normave Europiane, nëse nuk ka mundësi bajpasi, nuk lejohet ndërtimi me vetëm një tub. Ky bajpas, në çdo rast do të duhet domosdoshmërisht të ndërtohet, qoftë për arsye të thjeshta shfrytëzimi (çdo aksident brenda në tunel bllokon të gjithë lëvizjen), qoftë për arsye të ndërtimit të shpejtë të veprës (në mënyrë që të mund të punohet nga të dy skajet e tunelit). Bajpasi vërtetë kalon në kuota të larta, 1325 metra mbi nivelin e detit (në një pjesë të shkurtër), por së pari, bajpasi presupozohet të shfrytëzohet vetëm përkohësisht, deri në ndërtimin e tunelit, dhe së dyti, rrugë të përhershme të ndërtuara në këto kuota, janë të shumta, madje edhe ne territoret fqinje. Zhurma e "lobistëve" ka një qëllim të fshehtë. Ata nuk i ha meraku i bajpasit; ata i ha meraku i protagonizmit dhe të të qenit faktor, pavarësisht nëse kanë argumente apo jo. (gazetatema.net)

DEKLARATË E GRUPIT TË LOBIMIT PËR RRUGËN E ARBRIT:
Ne i qëndrojmë bindjes se tentativa për eliminimin e tunelit përbën 'grushtin' e fundit për ndalimin e ndërtimit të e Rrugës së Arbrit sipas standardeve ndërkombëtare.

Rrugën e Arbrit ia kërkojmë qeverisë shqiptare, jo inxhinierëve dhe shoqatave qytetare

Ata inxhinierë dhe shoqata që acarohen me përpjekjet tona vullnetare, bëjnë mirë të acarohen me qeverinë që nuk po mban premtimet për ndërtimin e Rrugës me standarde bashkëkohore.

Nga **GËZIM ALPION***

Në foto: Gjatë një takimi të Grupit të Lobimit për Rrugën e Arbrit me deputetë dibranë, intelektualë dhe përfaqësues të shoqatave dibranë më 5 maj 2014, ku pjesëmarrës kanë qenë edhe drejtues të shoqatës Bashkësia Dibrane.

Më datë 28 tetor 2016, nga një lajm i revistës *Monitor*[1], dhe më pas nga disa media të tjera (*Tema, Shekulli*, etj.), mësuam lajmin se kompania kineze *China State Construction Company* është tërhequr nga financimi dhe ndërtimi i Rrugës së Arbrit.

Sipas *Monitor*, kjo ka ndodhur para gjashtë muajsh. Burimet tona pranë qeverisë na kanë pohuar shumë kohë më parë se negociatat me kompaninë kineze kanë dështuar, por qeveria, në vend që ta bënte publike lajmin dhe të rriste përpjekjet në drejtime të tjera për të gjetur financime, e mbajti të fshehtë për shkak të fushatës elektorale të parakohshme në Dibër. Madje, Ministri i Jashtëm, lëshonte në gusht të këtij viti deklarata se "për Rrugën e Arbrit bisedimet janë në fazën finale me autoritetet kineze dhe do të arrijmë një marrëveshje të pranueshme dhe të zbatueshme nga palët"[2].

Ndërkohë, mësojmë se një kompani shqiptare ka paraqitur një ofertë dhe një grup i Ministrisë së Transporteve po e shqyrton atë dhe së shpejti do të marrë një vendim. Sipas burimeve të *Monitor*, kjo kompani do të "jetë fituesja e ndërtimit të rrugës së Arbrit".

Ashtu si deri më sot, ne nuk kemi asnjë interes të mbështesim ose të kundërshtojmë firmat apo kompanitë që do të ndërtojnë rrugën, por kemi të drejtën tonë që t'i kërkojmë qeverisë të jetë transparentë në këtë drejtim.

Ne kemi qenë dhe vazhdojmë të jemi të shqetësuar në drejtim të standardeve të ndërtimit të rrugës, pasi këto standarde ose do ta bëjnë rrugën një aks të rëndësishëm që lidh Tiranën me Dibrën dhe Shkupin ose do të mbetet thjesht një aks lokal që nuk do të luajë asnjëherë rolin e pritshëm në ekonominë kombëtare.

I bëjmë thirrje qeverisë që përpara sa të vendosë për vazhdimësinë e këtij projekti, duhet të tregojë të gjithë arsyet se përse negociatat me kompaninë kineze dështuan? Cilat ishin arsyet? Kush negocioi në emër të qeverisë? Cili ishte roli i ekspertëve? Kjo është e domosdoshme në mënyrë që jo vetëm të mos përsëriten të njëjtat gabime në të ardhmen, por të marrim edhe informacion rreth dyshimeve tona se përfaqësuesit e qeverisë në këtë proces nuk kanë vepruar në interes të kësaj çështje.

Me këtë rast, duam të sqarojmë gjithë firmëtarët e peticionit në letër dhe onlinet, në lidhje me disa sulme në adresë të Grupit të Lobimit nga njëri prej projektuesve të Rrugës, Inxhiner Faruk Kaba[3] dhe kryesia e shoqatës Bashkësia Dibrane në Tiranë, drejtuar nga z. Bujar Kapexhiu[4].

Kaba na emërton si "një farë grupimi të ashtuquajtur lobistë të Rrugës së Arbrit, zhurmëtarë të pabesë, të paemancipuar, cinikë provincialë", që gjasme propozimin e tij për "version pa tunel" ia kemi faturuar si ide të qeverisë, apo se ne e paskemi sulmuar Kabën sipas "një plani të mirëstudiuar". Sipas tij, ne "meritojmë një dackë shembullore". Më datë 21 tetor kryesia e shoqatës Bashkësia Dibrane dhe një grupim pranë saj i quajtur "Këshilli i të Urtëve", lëshojnë një deklaratë të botuar në gazetën *Tribuna*, ku ndër të tjera thonë se: ne jemi "të vetëquajtur lobistë", që paskemi përdorur "sharje" dhe "fyerje", që qenkemi "sherrxhinj dhe fjalë shumë", që lëshuakemi "shpifje që provokojmë" dhe që përpiqemi ta "intrigojmë këtë organizëm në afera, interesa dhe intriga", gjë që e detyrojnë këtë organizëm të distancohet katërcipërisht nga ne.

> Ne vazhdojmë të shpresojmë se simbolika e marrjes seriozisht të kësaj çështje do të jenë fillimet e punimeve në Tunelin e Qafë Murrizës. Çdo nisje punimesh në vend tjetër para zgjedhjeve të ardhshme do të interpretohet me të drejtë si një manipulim elektoral.

Si shkrimi-sulm i Kabës, si deklarata e pakuptimtë e kryesisë së Bashkësisë Dibrane, janë krejt të paqarta dhe përmbajtja e tyre është plotësisht e papranueshme për ne. Ato janë të mbushura më shpifje dhe të pavërteta kundër lobistëve. Ndoshta ky është i vetmi rast që një shoqatë dibrane angazhohet të sulmojë shoqërinë civile, krejt të lirë në këtë çështje dhe me angazhim tërësisht vullnetar.

Ne, asnjëherë dhe në asnjë rast, nuk kemi sulmuar asnjë individ dhe shoqatë. Kush e ka sabotuar rrugën, kush ka bashkëpunuar me qeveritë në dëm të rrugës, kush ka ndryshuar projekte në interes të kryeministrit a ministrit të radhës në dëm të rrugës, shumë më mirë se ne e dinë ata që bëjnë ato shkrime dhe lëshojë këto deklarata.

Ne do t'i thoshim Kabës që në vend që të shkruaj kundër shoqërisë civile, bën mirë t'a mprehë lapsin dhe të projektojë rrugën sipas standardeve botërore dhe t'i argumentojë qeverisë dhe institucioneve vendimmarrëse se rruga duhet projektuar me dy tunele, si ai i Kalimashit dhe Elbasanit.

Ne kemi informacione se për Rrugën e Arbrit nuk ka një projekt të plotë, dhe për këtë Kaba duhet të acarohet.

Pavarësisht këtyre deklaratave të dënueshme ne do të vazhdojmë punën tona për ta bindur qeverinë që të marrë vendimet e duhura për Rrugën e Arbrit. Gjatë tre viteve ka pasur përpjekje nga organizata ose individë të lidhura me qeverinë që t'ia heqin zërin lobimit tonë. Deklaratat e mësipërme me akuza për sherrxhinj dhe anonime duket se kanë të njëjtin qëllim, por kjo nuk do të na pengojë në përpjekjet tona të lira për të kërkuar një të drejtë që komuniteti dibran i takon.

Ata që kanë firmosur peticionin dhe mijëra të tjerë që na ndjekin në rrjetet sociale e dinë shumë mirë se nuk jemi anonimë, sepse që nga marsi i vitit 2013 kemi qenë këmbëngulës dhe parimor në lidhje me çështjen, dhe se për këtë as kemi kërkuar protagonizëm dhe as nuk i kemi shërbyer asnjë force politike, qoftë edhe në qeveri.

Ne kemi organizuar takime publike në Peshkopi, Dibër të Madhe dhe Tiranë, ku pjesëmarrës kanë qenë edhe deputetë të majtë dhe të djathtë, si dhe përfaqësues nga të gjitha shoqatat dibrane, përfshirë edhe Bashkësinë Dibrane.

Ne kemi lobuar dhe do të lobojmë pa asnjë anim politik apo përfitim financiar. Po qe se qëndrimi ynë parimor nuk i vjen për shtat ndonjë organizate apo individi, kjo është çështje e tyre.

Gjatë këtyre viteve ne kemi pasur mbështetjen e qindra të qytetarëve, kryesisht të rinj dhe intelektualë, të cilët kanë pranuar vullnetarisht të punojnë për shtimin e nënshkrimeve në letër dhe online, kanë mirëmbajtur dhe administruar faqen publike të peticionit në FB si dhe kanë përdorur takimet publike në forcat ku janë anëtarë, organizatat e tjera politike apo organizatat të tjera joqeveritare, në mënyrë që të rrisin më shumë angazhimin e qeverisë në këtë proces.

Të duash Dibrën, duhet të pranosh çdo kërkesë llogarie dhe nxitje që përshpejton Rrugën, dhe jo të kërkosh t'u mbyllësh gojën, sepse gjoja "nuk janë përfaqësues zyrtarë të Dibrës".

Ritheksojmë edhe njëherë se në asnjë deklarate nuk e kemi sulmuar asnjëherë asnjë shoqatë dibranë, as Bashkësinë Dibrane dhe asnjë inxhinier, kushdoqoftë ai, që ka projektuar dhe ndërtuar rrugën. Ne thjesht jemi kundër eliminimit të ndërtimit të tunelit në këtë fazë, pasi me këtë angazhim të qeverive shqiptare deri më tani, në qoftë se rruga ndërtohet pa tunel, ajo kurrë nuk ka për t'u ndërtuar.

Ne shkurt dhe qartë ritheksojmë se: propozimi i Kabës për "ndërtimin paraprakisht të një bypass-i në vend të tunelit të Murrizit" është i papranueshëm.

Ne i qëndrojmë bindjes se tentativa për eliminimin e tunelit përbën 'grushtin' e fundit për ndalimin e ndërtimit të e Rrugës së Arbrit sipas standardeve ndërkombëtare.

Ne i qëndrojmë deklaratave tona të mëparshme se "do ta mbështesim qeverinë shqiptare që të vazhdojë përpjekjet për gjetjen e burimeve të financimit dhe kompani ndërtuese serioze brenda e jashtë vendit, me qëllim që sa më parë të fillojnë punimet në rrugë.

Ne vazhdojmë të shpresojmë se simbolika e marrjes seriozisht të kësaj çështje do të jenë fillimet e punimeve në Tunelin e Qafë Murrizës. Çdo nisje punimesh në vend tjetër para zgjedhjeve të ardhshme do të interpretohet me të drejtë si një manipulim elektoral.

Ne jemi të vendosur të vazhdojmë përpjekjet tona për të bashkëpunuar me qeverinë në këtë proces, me qëllimin e vetëm, ndërtimin sa më shpejt të Rrugës së Arbrit me cilësi dhe standarde bashkëkohore.

[1] http://www.monitor.al/rruga-e-arberit-shqiptaret-marrin-persiper-ndertimin-e-plote/

[2] http://albanian.cri.cn/1552/2016/08/26/28s154617.htm

[3] http://www.gazetatema.net/web/2016/10/11/debatimbi-bajpasin-e-tunelit-te-rruges-se-arbrit/

[4] http://telegraf.al/politike/bashkesia-dibrane-nuk-ka-lobiste-te-shoqates-sone-per-rrugen-e-arbrit

Rruga e Arbërit nr. 126

koment

Karikaturë nga **BUJAR KAPEXHIU**

MBI LOBIMIN E RRUGËS SË ARBRIT

REAGIM I SHOQATËS "BASHKËSIA DIBRANE"

Prej disa kohësh, në median e shkruar veçanrsisht, po përballemi në mënyrë të çfrenuar me një grup apo individ, të vetëquajtur "lobistët e rrugës së Arbërit". Vetë kjo vepër "e nisur por e pa bitisura", sigurisht që ka ngjallur shumë debate, veçanrisht në komunitetin dibran dhe dibranët kudo ku janë. Por abuzimi duke u vetëdeklaruar, kush të mundet e me shumë, si lobistë, mbrojtës të rrugës së Arbërit me tunel pa tunel, sharje dhe fyerje pa fund për "sabotatorë të rrugës" etj, jo vetëm që nuk i bëjnë mirë çështjes së ndërtimit të saj, por në të kundërt, për ne dibranët, që njihemi si njerëz të veprave dhe të punës, krijon imazhin e sherrxhinjëve dhe të fjaleshumeve. Shoqate "Bashkësia Dibrane", përfaqësuese e denjë e dibranëve në Tiranë, ajo që i ka dhënë shumë këtij emri, që i ka dhënë shumë Dibrës dhe Tiranës sëbashku, distancohet katërcipërisht nga këta të vetëquajturit lobistë.

Shoqata "Bashkësia Dibrane" ka mbështetur që në fillimet e organizimit të saj ndërtimin e Rrugës së Arbërit, pavarsisht qasjeve politike apo individuale. Intrigimi për të përfshirë këtë organizëm në afera, interesa, intriga apo debate politike apo të ngjashme që janë jasht etikës së saj, jasht principeve të saj, jasht programit të saj, janë të papranueshme dhe në këtë kontekst ajo distancohet kategorikisht. Marrja përsipër nga "lobistë" te vetëshpallur, nga persona të panominuar dhe që nuk kanë asnjë mbështetje të komunitetit dibran, por që "lobojnë" për protagonizëm, nuk i shërben qëllimit dhe interesit tonë për ndërtimin sa më parë të kësaj vepre.

Ne nuk mund të pranojmë, që persona apo një person, që nuk perfaqëson veçse veten e tij (apo veten e tyre), me synime të qarta jo të sinqerta, që bëjnë akuza të shumfishta dhe mundohen te instrumentalizojnë opinionin publik me të vërteta e të pavërteta, qoftë edhe kundër autorëve të rrugës së Arbërit, nuk i shërbejnë komunitetit tonë. Pa mbajtur anën e askujt, ne jemi koshientë, jo vetëm se kush ka kontribuar më shumë, kush është më i përkushtuar dhe më i interesaur për këtë rrugë, prandaj insinuatat e paprincipta dhe të pafund nuk i shërbejne synimeve tona; ato janë të huaja për të. Për më tepër nuk janë në sjelljen, etikën dhe traditën tonë. Nëse dikush është i interesuar të bëjë lobing për një gjë të tillë, le të bëjë, por, së pari, të deklarohet me emra dhe të mos fshihet pas fjales "lobistët", që askush nuk i ka nominuar (shoqata "Bashkësia Dibrane" ka ngritur një grup ekspertësh për lobimin e rrugës së Arbërit) dhe, së dyti, para se të leshoj shpifje dhe të pavërteta pafund, le të njihet me faktet.

Shoqata "Bashkësia Dibrane" nuk është një shoqatë me orientim politik. Ajo nuk pranon asnjë provokim dhe askënd, që abuzon dhe cënon parimet tona, të mbështetura në patriotizmin, në ngritjen e vlerave më të mira dhe traditave tona. Gjithashtu dhe në të njejtin kontekst, shoqata jonë, nuk është një organizatë politike; në të kundërt, ajo është e interesuar për zhvillimet e vendit. Ajo ka në thelbin e saj asnjëanesinë politike dhe të mosndërhyrjes në çeshtje politike. Në këtë kontekst ajo nxit çdo formacion politik në qeverisje, për të bërë më të mirën në interes të dibranëve në Tiranë dhe kudo tjetër ata janë, veçanrsht për ndërtimin sa më të shpejtë të rrugës së Arbërit. Çdo qëndrim tjetër dhe që është jashtë kësaj kornize, është në dëm të interesit të përbashkët të komunitetit tonë.

KRYESIA dhe KESHILLI I TE URTEVE I SHOQATES "BASHKESIA DIBRANE"

KOMENT

Intervistë pa përgjigje me deputetët e Qarkut të Dibrës

Nga **HYSEN LIKDISHA**

Mesi i muajit tetor 2016-të, ka shënuar për rajonin e Dibrës një ngjarje do thonim të pazakontë, port ë mirpritur, ku të gjithë deputetët e Dibrës, të të gjithë krahëve politikë, tani në fund të mandatit të tyre, janë parë bashkë në një tryezë, për të zhvilluar një bisedë me shoqërinë civile. Kështu më në fund, pas 25 vitesh demokraci, deputetët pavarësisht ngjyrimeve politike, shihen bashkë në një forum në Bulqizë, për forcimin e rolit dhe bashkëpunimit ndërmjet Shoqërisë Civile dhe Parlamentit, organizuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së.

Takimi u zhvillua në një nga sallat e Pallatit të Kultures Bulqizë. Morën pjesë deputetët e Qarkut Dibër, Përparim Spahiu, Roland Keta, Dhurata Çupi, Shkëlqim Cani dhe Ulsi Manja, drejtues të institucioneve vendore në shumicë, si dhe ndonjë për të mos thënë asnjë përfaqësues i shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në Qarkun e Dibrës. Në fjalen e tyre deputetët e vunë theksin tek rëndësia e madhe që ka dëgjimi i Shoqërisë Civile dhe grupeve të interesit, para hartimit të projektvendimeve për t'i sjelle ata për miratim në Parlament. Dhe pikërisht për këtë , thanë deputetët, duhet të ndërtojmë urat e bashkëpunimit midis Parlamentit dhe Shoqërise Civile. Nuk kuptohej se për kë Parlamentarë duhej të hidheshin këto ura bashkëpunimi, për këta ekzistuesit që janë drejt përfundimit të mandatit, apo për ata që priten të vijnë në 2017-tën. Kështu deputeti Përparim Spahiu, duke marrë si shembull ligjin e fundit të miratuar në Kuvend për importin e mbetjeve, tha ndër të tjera se do ishte shumë më mirë që ky ligj para se të miratohej të diskutohej me Shoqërinë Civile për të marrë edhe mendimin e saj dhe të grupeve të interesit

Gjithsesi takimi vlerësoi se urat e bashkëpunimit mes Parlamentit dhe Shoqërisë Civile, mund dhe duhet të ngrihen në një nivel edhe më të lartë. Për këtë u tha se Kuvendi në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor, hap në çdo rreth të vendit zyra të veçanta për deputetët e mazhorancës dhe opozitës. Kuvendi emëron në zyrat përkatëse një specialist dhe pais zyrat me mjetet e nevojshme të punës, ku qytetarët komunikojnë direkt me deputetët pa dallime partiake për problematikat që kanë, për tu dhënë atyre zgjidhjen e duhur.

Pjesmarrësve në këtë takim pak interes u ngjallën premtimet e deputetëve se në të ardhmen fjala e tyre do të dëgjohet. Pasi dibranët e dijnë fare mirë, madje më mirë se kushdo, se premtimet e deputetëve, në asnjë rast nuk janë mbajtur, por kanë qenë vetëm mashtrime për ta, sa për tu marrë atyre votën. Kryemashtrimi për dibranët, ka qenë dhe mbetet ndërtimi i "Rrugës së Arbërit".

Zhgënjimi që u bëhet dibranëve me ndërtimin e kësaj rruge, nuk mund të anashkalohet lehtë . Kjo u vu re edhe në këtë takim, ku u kërkua që deputetët të shprehen pse nuk po mbahet premtimi i dhënë për ndërtimin e kësaj rruge. Pyetjes se a ndjehen keq tani që janë në fund të mandatit të tyre, dhe nuk arritën që të lobojnë në Parlament për ndërtimin e kësaj rruge, kur ka qenë rasti më optimal për një gjë të tillë, pasi siç thuhet ky ka qenë Parlamenti, që ka patur në përbërje të tij jo pak, por 19 deputetë me origjinë nga Dibra, ju shmangën duke ripremtuar për të disatën herë ndërtimin e saj. Shkëlqim Cani, ish ministër i Financave, nisur edhe portofoli më i rëndësishëm ministror që mbante, duket se ndjehet vërtet keq, kur para mikrofonit të TVBulqizës e mbylli gojën duke mos i dhënë përgjigje kësaj pyetje. Të gjithë deputetët e tjerë, pasi ju shmangën pyetjes për lobim apo interpelancë me Kryeministrin, nisën të flasin me "avazin e vjetër", duke ripremtuar ndërtimin e saj. Deputetët në mazhorancë, thanë se rruga do nisë ndërtimin në pranverën e ardhshme, pra në prag të fushatës së 2017-tës, ndërsa deputetët e djathtë thanë se rrugën do ta ndërtoje vetëm PD-ja. Gjithsesi një gjë bëhet e qartë, se edhe në fushatën elktorale të 2017-tës, sllogani premtues për ndërtimin e Rrugës së Arbërit, do zërë vendin kryesor, nga të gjithë krahët e politikës. Por ajo që mbetet për tu parë është se kush do guxojë që të bëjë vota edhe kësaj here duke premtuar ndërtimin e "Rrugës së Arbërit", kur Dibrës dhe dibranëve një premtim i tillë ju ka ardhur në "majë të hundës".

Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit ose ndiq linkun: goo.gl/1bq2r6

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORËT!

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit.

Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

Pajtohu në gazetën RRUGA E ARBËRIT

Merr versionin PDF ose kopjen print duke filluar me 50 lekë/muaj

Për informacion: E-mail: rrugaearberit@gmail.com
Tel: +355 69 20 68 603

"Ne i kemi bërë një propozim qeverisë Shqiptare para disa muajsh, për ndërtimin e plotë të të gjithë pjesës së mbetur të Rrugës së Arbrit. Koha e realizimit të punimeve 3 vjet dhe me një kosto shumë më të ulet se ajo e kompanisë kineze dhe standard më të lartë teknik"

Nga punimet në ndërtimin e Rrugës së Arbrit (Dalje Ura e Vashës – Bulqizë, Loti 3). Foto: gjokakonstruksion.al

Tërhiqen kinezët, oferta e tyre nuk pranohet nga qeveria

Gjoka Konstruksion: **Rruga** e mbetur **e Arbrit kushton 190 milionë euro**

"Kompania kineze China State Construcion ka tërhequr ofertën e bërë në qeverinë shqiptare në lidhje me ndërtimin e Rrugës së Arbrit" shkruan revista Monitor, e specializuar për lajmet në fushën e ekonomisë, më 28 tetor 2016.

Sipas revistës, "kjo lëvizje e papritur duket se do të vërë në vështirësi premtimin e qeverisë shqiptare për të nisur punimet në pranverën e vitit 2017".

Burimet zyrtare kanë thënë për "Monitor" se zyrtarët kinezët kanë 6 muaj që janë shprehur se nuk do të ndërtojnë këtë rrugë, pasi dhe vetë pala shqiptare këmbënguli në uljen e kostos së ndërtimit.

Për ndërtimin e 27 kilometrave të rrugës së Arbrit, kinezët dhanë një ofertë prej 300 milion dollarësh, e cila nëse nuk arrihej të përfitohej nga taksa e rrugës, do të subvencionohej nga buxheti i shtetit".

Revista thekson më pas se tani "qeveria shqiptare duhet t'i drejtohet Kuvendit për të shfuqizuar kontratën e nënshkruar gati një vit më parë".

Në këto kushte ekzekutivi duhet të marrë në konsideratë angazhimin e firmave shqiptare. Mësohet se kompania Gjoka Construction ka propozuar të përfundojë të gjithë pjesën e mbetur të rrugës së Arbrit, dhe jo vetëm 27 kilometra të saj, për një vlerë prej 190 milion dollarësh. Një komision i ngritur në Ministrinë e Transporteve është duke marrë në shqyrtim këtë ofertë, e cila me sa duket do të jetë fituesja e ndërtimit e rrugës së Arbrit.

Me anë të një emaili në adresën zyrtare të kompanisë Gjoka Konstruksion, ne kërkuam më shumë informacion rreth ofertës së tyre.

"Kompania jonë operon në infrastrukturën e qarkut Dibër dhe veçanërisht ka qenë e angazhur në ndërtimin e Rrugës së Arbrit prej më shumë se 7 vitesh", shkruan një përgjigje për gazetën Erind Gjoka, drejtor i përgjithshëm i Gjoka Konstruksion.

"Deri më tani ne kemi ndërtuar rreth 16 km të Rrugës Arbrit, pavarësisht vështirësive financiare të atyre viteve", shkruan Erind Gjoka.

"Dëshira jonë ka qenë dhe vazhdon të jetë, që pavarësisht se kush do jetë kompania që do e marrë përsipër, ajo rrugë të përfundojë dhe të vihet në operim. Si rrjedhojë e kësaj dëshire të madhe, ne i kemi bërë një propozim qeverisë Shqiptare para disa muajsh, për ndërtimin e plotë të të gjithë pjesës së mbetur të Rrugës së Arbrit. Koha e realizimit të punimeve 3 vjet dhe me një kosto shumë më të ulet se ajo e kompanisë kineze dhe standard më të lartë teknik".

Lidhur me kërkesën tonë për më shumë informacion, Gjoka shkruan se "Ne e kuptojmë kërkesën tuaj ku doni të dini sa më shumë detaje, por ne duhet të ju informojmë që në këtë fazë nuk mund të japim më tepër detaje. Ajo që duhet të theksojmë është që, sipas mendimit tonë, shanset që pjesa e mbetur e Rrugës së Arbrit të fillojë para pranverës 2017, janë më të mëdhaja se asnjëherë".

Cila është Gjoka Konstruksion?

"Gjoka Konstruksion sh.a është themeluar në vitin 1994 nga Rrok Gjoka , administrator dhe aksioner i vetëm", shkruhet në profilin e kompanisë në Web.

"Aktiviteti i saj ka filluar në 1994 me seli në qytetin e Pukës. Gjoka Konstruksion sh.a në fillimet e saj ka realizuar objekte me vlerë të vogël, duke marrë parasysh edhe vështirësitë e asaj kohe. Me kalimin e viteve kjo kompani e vogël por e vendosur fitoi eksperiencë duke marrë përsipër projekte të ndryshme të infrastrukturës në sektorin civil dhe industrial. E gjitha kjo, duke shtuar fuqinë punëtore, parkun e mjeteve teknologjike dhe transportuese, kapacitetet ndërtuese dhe duke rritur cilësinë e punimeve në çdo sektor".

"Në vitin 1998 selia e shoqërisë zhvendoset në Tiranë. Rritja e vazhdueshme dhe suksesi solli edhe projekte më të mëdha dhe më të komplikuara. Ndër të parat ishte përfundimi i Unazës së Re, në vitin 2000".

"Gjoka Konstruksion sh.a ka përfunduar një shumëllojshmëri të gjerë projektesh. Nga rindërtimi i rrugëve dhe autostradave, deri të urat dhe ujësjellësit. Pavarësisht nga projektet dhe vështirësitë që kanë, ne mbetemi të angazhuar për të dhënë më të mirën. Nga pronari, Rrok Gjoka, deri te menaxherët tanë te projektit, ne punojmë së bashku për t'u kujdesur për çdo detaj. Si rezultat, ne e kthejmë vizionin në realitet".

"Ne krenohemi me ekipin tonë të punës i cili është i përbërë vetëm nga profesionistët e ndërtimit më të talentuar dhe më me përvojë në këtë industri", shkruhet në profilin e kompanisë.

Gjoka Konstruksion është duke ndërtuar tashmë dy lote të Rrugës së Arbrit nga ura e Vashës deri në Bulqizë. Ajo ka operuar edhe në ndërtimin e veprave të tjera në Dibër, si në rrugës Maqellarë - Peshkopi, ndërtim sistemi të furnizimi me ujë të fshatrave Melan, Grevë, Trenë, Pekë, Pjeçe dhe vepra të tjera të infrastrukturës në Qarkun e Dibrës, si dhe po ndërton me koncension Hidrocentralin e Okshtunit.

Sipas revistës Monitor, "vetëm në vitet 2013-2015 qeveria aktuale ka investuar 6 miliard lekë, ndërkohë që kërkohen edhe mbi 200 milion euro për të përfunduar segmentin kryesor prej 26.7 km të kësaj rruge".

Ky projekt është iniciuar në vitin 2008, dhe parashikon një gjatësi prej 72 km nga Tirana në Dibër të Madhe, krahasuar me lidhjen e vjetër ekzistuese që është rreth 140 km dhe ka një gjerësi të planifikuar prej 10.5 m.

Deri më sot janë investuar nga kjo qeveri 6 mld lekë, në vitin 2013 është investuar në vlerën e 3 miliardëve duke paguar dhe borxhet, 2014 janë investuar 1,4 mld dhe në 2015 shifra shkon në 1,34 mld lekë".

B.Karoshi

FEJTON

Pranvera "pa të shtuna" e Rrugës së Arbrit

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Udesh ardhja e një delegacioni të Qeverisë Maqedonase të kryesuar nga Ministri për Investimet e huaja Arlind Zeqiri, Gëzim Beadini - zv. Ministër i Financave dhe Faton Pollozhani, zv. Ministër i Transportit që ministri më i ri i Qeverisë Shqiptare Sokol Dervishaj të njoftojë "Angazhimin e Qeverisë Shqiptare për të filluar punimet për ndërtimin e Rrugës së Arbrit në pranverën e 2017-ës" (?!)

Këtë zë të parë që nga ardhja e tij në Qeveri si përfaqësues i LSI, Dervishaj e konsideroi si "një arterie të rëndësishme rrugore që forcon lidhjen mes Shqipërisë e Maqedonisë me korridoret rajonale".

Nuk di si ta cilësoj këtë: si sihariq i madh i nxjerrë nga goja e një Ministri të Transportit dhe Infrastrukturës apo si lojë e re elektorale në vijim të lojërave pambarim që janë luajtur me këtë rrugë për të cilën flitet e flitet, e askush nuk ngul një kazmë e zbraz një lopatë.

Fillimet e punimeve të Rrugës së Arbrit tash e sa kohë (më se një dhjetëvjeçar) kanë filluar në fushatat elektorale për zgjedhjet e përgjithshme kuvendare të Shqipërisë. Shiritat e përurimit i kanë prerë udhëheqësit më të lartë të shtetit në rang kryeministror, Nano, Berisha Rama...

Prenë shiritat, prenë financimet.

Rruga e Arbrit mbeti si në rrëfenjat e moçme me "Kalenda Greke" e "Javë pa të shtunë".

Po çfarë janë "Kalendat Greke?".

Fjala "kalendë" nuk na qenka fjalë greke por qenka fjalë e vjetër latine-calenda...

Tek romakët e lashtë calenda ishte dita e parë e muajit. Shprehja "në kalendat greke" ka kuptimin që gjëja për të cilën flitet e premtohet nuk do të zgjidhet kurrë sepse grekët e lashtë nuk kishin Kalenda

Ministri Dervishaj thotë që "punimet për ndërtimin e Rrugës së Arbrit fillojnë në pranverën e 2017-ës" (?!)

Pranvera në fjalorin e përditshëm fillon më 1 mars e përfundon më 31 maj. Në kalendarin hënor fillon më 14 mars e mbaron në 13 qershor. Në kalendarin astronomik fillon më 22 mars e mbaron më 21 qershor.

Ministri Dervishaj për fillim të punimeve për ndërtimin e Rrugës së Arbrit jep pranverën e vitit 2017 pranvera e nxehtë zgjedhore (ndoshta më të nxehtën e të gjitha kohërave) zgjedhje të cilat do të përcaktojnë "kuajt e rinj në pajtonin qeveritar"

E shikuar kjo në syrin e premtimeve të mëparshme, pranverat zgjedhore të viteve 2005, 2009 dhe 2013, Rruga e Arbrit fillon e mbaron si "premtim ala "Kalenda Greke" duke u shndërruar në një "Pranverë pa të Shtuna".

Ministri Dervishaj duket se ka konspektuar me "laps të mprehur mirë" kryeministrin Rama i cili në fushatën elektorale për kryetarin e Bashkisë së Dibrës tha se nuk do të ikte nga karrigia e Kryeministrit pa mbaruar Rrugën e Arbrit (!)

Pranvera 2017, si të gjithë pranverat fiks do të ketë tre muaj ose zbërthyer në ditë, plotë 92 ditë.

Ministri deklaroi se "punimet për ndërtimin e Rrugës së Arbrit fillojnë në pranverën e 2017-ës". Nuk përmendi as njërin prej tre muajve të pranverës 2017, as edhe njërën nga të 92 ditët e pranverës (!)

U tha se "punimet për ndërtimin e Rrugës së Arbrit fillojnë në pranverën e 2017-ës". Dhe kjo kur aktualisht janë ndërtuar disa kilometra rrugë dhe ajo që mbetet dhe përbën kryesoren në ndërtim janë tunelet e Qafë Murrizes dhe Ura e Vashës...

Në Shqipëri, me "Pranverën 2017" për Rrugën e Arbrit", fillon fushata premtimore elektorale.

Rruga e Arbrit doli nga "Kalendat Greke" për të hyrë te "Pranverën pa të shtuna"...

Mentori i Zeralinjve të Dibrës

Kam nostalgji jashtëzakonisht të madhe edhe për rrugët e gurët e Peshkopisë. Unë tani kur shkoj, të them të drejtën nis të qaj (një rrjedhë e loti kapërcen rrudhat e jetës).

Shumë njerëz e duan vendin e vet por unë kam një dashuri të jashtëzakonshme për vendin tim, për atë kulturë që ka, për atë edukatë që ka, njerëz të mirë, të ndershëm, punëtorë, të sjellshëm, jo intrigantë, jo hajdutë.

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Mentor Zeraliu në oborrin e shtëpisë në Tiranë. Foto: A.Ashiku

Fëmijëria dhe fillimet e rinisë sime lidhen me Peshkopinë, me shtëpinë në dy poda në teposhtën e rrugës së kalldrëmtë drejt hapësirës së gjerë ku të enjtet bëhej pazari me prodhime bujqësore e blegtorale, me anën tjetër të përroit ku bëhej pazari i kafshëve, me hanet dhe qarkun rrethues të sheshit me dyqane të vegjël, me xhaminë në lagjen e shehëlerëve...

Mua më ka ndihmuar edhe ajo që pasi u diplomova inxhinier dhashë për 14 vjet mësim në Universitetin e Tiranës. Jepja katër lëndë me buletinin teknik që e kisha shumë qejf dhe Besim Daja, dekan i fakultetit dhe pedagog imi. Ky më tha që të vish pedagog. Kjo ishte në vitin 1956. Kam dhënë teknologji ndërtim makinash për gati 12 vjet.

Një shtëpi e thjeshtë tiranase me avlli në një rrugicë që takohet me rrugën Hoxha Tahsim...

Një shtëpi e ringritur nga një zjarr në vitet shtatëdhjetë, zjarr që mori mes flakëve kujtesën e shkruar të tre brezave, por nuk preku kujtesën e të zotit të shtëpisë, Mentor Zeraliut, jeta e të cilit shkon drejt shekullit...

Ulur në ballkon, përballë një limoni tek i cili, siç më tha, numëroheshin 180 kokrra të pjekura, me vështrimin mbi një karton mbi të cilin end figura me fara hurme të ndara në mes...

Ngrihet në këmbë, më përqafon dhe më fton të ulem përballë. Dielli i vjeshtës ia ndriçon rrudhat e fytyrës dallgëzuar nga një jetë e mbushur me ngjarje të mëdha në tre kohë të ndryshme jete...

Zëri i qartë vjen e ngrin në shiritin e diktofonit...

MENTORI I FUNDIT...

Kam lindur në Peshkopi më 8 qershor 1923...

Baba im Jashar Zeraliu është nip tek Bahollët, një familje e madhe në Dibër të Madhe. Sheh Hyseni, gjyshi im, mik i ngushtë i Bahollëve, kishte lënë amanet që në qoftë se janë dakord krahu tjetër me jua dhënë gocën time të madhe...

Jashari dhe Zyraja ishin prindërit e mi...

Gjyshi im, babai i nënës, ka pas katër vajza e tre djem: Habibka martuar me Ali Pustinën, nëna ime Zyraja martuar me Jashar Zeraliun, Tixhja martuar me vëllain e babës tim Munirin dhe Nuneja martuar me Isuf Jarecin në Durrës. Ka pas edhe tre djem: Musa Shehun, Haki Shehun dhe Myrteza Sehun që trashëguan 12 djem e vajza.

Të shtatë fëmijët, tre djem dhe katër vajza, në shtatorin e egër 1913 kur babai i tyre Sheh Hyseni u pushkatua nga serbët si pjesëmarrës në kryengritjen e shtatorit 1913, e kaluan Drinin e Zi në koshat e dy kuajve, dy e nga dy futur zhveshur tërësisht nga pasuria, veshur vetëm me rrobat e trupit...

Teqeja e Sheh Hysenit në Dibër të Madhe ka qenë bazë e udhëtimit të Abdyl Frashërit drejt Prizrenit dhe Ai ka qenë shoqërues i tij në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Për këtë është dekoruar me rastin e 100 vjetorit të Lidhjes.

Baba im ka pasur nëntë fëmijë. Tetë lindën dhe vdiqën. Vetëm dy kishin emra të ndryshëm, të tjerët quheshin Mentor, Mentor, Mentor...derisa mbeta unë, Mentori i fundit, fëmija i vetëm...

Ishim një familje e mirë, shumë kompakte, shumë e lidhur me njerëzit e vet, me rrjetin familjar.

EMIGRACIONI I PARË- MIKPRITJA E FAMILJES JELLA NË TIRANË

Jam 93 vjeç sot. Baba im, pas vitit 1913, në emigracionin e parë, ka ardhë në Tiranë. Shkuan në Elbasan, por Elbasani nuk i mbajti. Shkuan në Durrës, edhe Durrësi nuk i mbajti. Erdhën në Tiranë, dhe Tirana i mbajti.

Janë strehuar për herë të parë tek Jella, familje e vjetër tiranase, e cila me shumë dashamirësi i ka mbajtur gjashtë muaj pa hapur plaçkat. U ka thënë je mik i familjes time. Do të hash, do pish, do të flesh dhe do të jetojmë bashkë. Mbas gjashtë muajsh u tha urdhëro dy dhoma të familjes time, krijo familjen tënde dhe jeto.

Kur panë se serbi nuk po e lironte Dibrën e Madhe atëherë u kthyen në Peshkopi.

Në Peshkopi shkoi jo për të ndenjur përfundimisht por të krijonte një far baze jete. Mbetën atje deri më 19 dhjetor 1944. Atëherë prej Peshkopie kemi ardhur në Tiranë.

MALLI PËR DIBRËN

Jam rritur me dibranët, me fëmijë e banorë nga Ushtelenca, Brezhdani, Pilafe, Tomini, Dohoshishti, Greva, Begjuneci, Bellova, Staraveci...

Kam nostalgji jashtëzakonisht të madhe edhe për rrugët e gurët e Peshkopisë. Unë tani kur shkoj, të them të drejtën nis të qaj (një rrjedhë e loti kapërcen rrudhat e jetës).

Shumë njerëz e duan vendin e vet por unë kam një dashuri të jashtëzakonshme për vendin tim, për atë kulturë që ka, për atë edukatë që ka, njerëz të mirë, të ndershëm, punëtorë, të sjellshëm, jo intrigantë, jo hajdutë.

Fëmijëria dhe fillimet e rinisë sime lidhen me Peshkopinë, me shtëpinë në dy poda në teposhtën e rrugës së kalldrëmtë drejt hapësirës së gjerë ku të enjtet bëhej pazari me prodhime bujqësore e blegtorale, me anën tjetër të përroit ku bëhej pazari i kafshëve, me hanet dhe qarkun rrethues të sheshit me dyqane të vegjël, me xhaminë në lagjen e shehëlerëve...

Në Peshkopi mbarova katërvjeçaren, filloren si e thonë sot. Asokohe nuk kishte shkollë më të lartë. Vonë do të ndërtohej Internati i Kastriotit.

Kam shkuar në vitin 1935 në Liceun e Korçës. Kam qenë deri në vitin 1939 ku për pjesëmarrje në një demonstratë në Korçë na futën në burg. Baba u tremb dhe më mori, nuk më la ta vazhdoj shkollën.

Në Peshkopi, kur u ktheva nga Korça deri në vitin 1944 kam punuar në dyqanin e babës.

Gjatë kësaj kohe me ndihmën e kushëririt tim të parë Besnikut që ishte partizan me Brigadën e Parë Sulmuese, i çetës së Mokrës, jam aktivizuar me Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Kam pas shokë Zeqi Agollin, Nazmi Rushitin...

Gjatë kësaj kohe u lidha me çetën e Haxhi Lleshit. Kam bashkëpunuar shumë me të duke i dërguar armë, ushqime, veshmbathje...

Në Brigadën e 18-të kam ndejë jo ma shume se tre muaj e gjysmë se Esat Ndreu, Dali Ndreu, Zoi Themeli, Milo Qirko, kishin nevojë shumë për lajme, informacione nga Peshkopia.

Njëherë, me disa të rinj aktivistë të luftës për çlirimin e vendit u ngjitëm në fshatin Ilnicë. Ishte mezi i dimrit. Ilnica i ka themelet shumë lart në malin e Hynoskës. Dëbora afrohesh me mesin e trupit. Akulli varej në hej të gjatë poshtë tjegullave të shtëpive. Misioni ynë ishte të bënim propagandë për luftën, ti tërhiqnim njerëzit në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Tek bisedonim nëpër shtëpitë e fshatit dëgjohet një breshëri automatiku. Gjermanët ishin ngjitur në fshat. Për të mos u krijuar vështirësi banorëve dolëm nga shtëpitë dhe u fshehëm ku mundëm. Të ftohtit ishte i madh. Na ngrinë duar e këmbë. Mezi mbanim frymën. Gjermanët vazhdonin bastisjen shtëpi në shtëpi. Një krismë arme në Rabdisht na shpëtoi nga vdekja e sigurt nga të ftohtit. Gjermanët ikën. Fshatarët dolën të na kërkonin. Na morën në shtëpitë e tyre. I Zoti i shtëpisë që e kishte mik babanë tim menjëherë theri një dash. E rropi, më tha të zhvishem lakuriq dhe më mbështolli me lëkurën e ngrohtë të dashit. Jetën e kam prej tij...

Kam qenë intendent i komandës së Qarkut të Dibrës e Matit. Pas Çlirimit kam punuar në komandën e përgjithshme të ushtrisë me Beqir Ballukun. Për dy vjet e gjysmë kam punuar shef llogarie në spitalin ushtarak në Tiranë me Sinan Imamin drejtor.

Pastaj kërkova të dal në lirim dhe të shkoj në shkollë. Shkova u regjistrova në liceun e Tiranës dhe kam bërë tre vjet shkollë. Më doli e drejta për të shkuar në Çeki për studime. Më doli bursa. Atë ditë që po bëhesha gati për të shkuar në Çeki më vdiq baba. Kështu unë nuk shkova dhe mbeta në Tiranë. Vazhdova Institutin Politeknik të Tiranës në degën mekanike. E fillova në vitin 1951 dhe e mbarova në vitin 1954. Më caktuan në Ministrinë e Transportit në Tiranë dhe kryeinxhinier në NSHRAK-un e Tiranës.

NSHRAKU-DASHURIA DHE MERAKU I MADH

Që nga 19 qershor 1954 dhe gjatë gjithë kësaj periudhe deri më 16 tetor 1988 kam punuar në NSHRAK me një ndërprerje 9 vjet si drejtor i Drejtorisë Mekanike në Ministrinë e Transporteve.

Në NSHRAK kam marrë pjesë në disa rikonstruksione. NSHRAK ka qenë ndërmarrje e riparimit të makinave vetëm të transportit me 208 punëtorë. Kur ika NSHRAK-un e kam lënë me 1980 punëtorë. E kam gjetur me 14 riparime kapitale në muaj dhe e kam lënë me 1000 riparime kapitale në muaj.

...Sot jam nëntëdhjetë e ca vjeç dhe them se ne kemi bërë gabim shumë të madh që kemi hequr dorë nga "Skoda". Ne jemi një vend fukara, jemi një vend jo me mundësi të mëdha. Ne arritëm që 92 për qind të pjesëve të ndërrimit të "Skodës" ti prodhonim në Shqipëri. Kur erdhi këtu për të tretën herë drejtori i "Skodës" dhe kur pa në NSHRAK prodhimin e disa pjesëve u habit. Ai tha se këto ju i keni blerë tjetërkund dhe i paraqitni se janë tuajat. Kur e futa unë nëpër uzina, në Uzinën e Autotraktorëve, Uzinën "Enver",

(Vijon në faqen 8)

profil

Për gati tetë vjet Osman Begun e shohim të drejtojë bujqësinë e gjithë qarkut të Dibrës.

Ëndrra e realizuar e Osman Begut

Nga **OSMAN XHILI**

Dikur, në vitet para nëntëdhjetës, Vakufi ishte pjesë e fermës së njohur të Zdojanit, me fruta të mrekullueshme e plot aromë, që shkonin në vende të rajonit, pse jo dhe në perëndim. Ishte dhe një fidanishte, po kaq e bukur dhe e pasur, që prodhonte fidanë të pastër e të shëndetshëm. Furnizonte Dibrën, por një pjesë fidanësh shkonin në Kukës, Tropojë, Pogradec e ndonjë vend tjetër.

Osman Begu, atëherë i ri dhe plot energji, shihte këta mjeshtra të mëdhenj të frutikulturës dhe mendonte të bëhej dhe vetë, si njëri prej tyre. Por studimet e larta i kreu për zootekni, racat më të mira të kafshëve, teknikat e mbarështimit, racionet ushqimore, ose e thënë shkurt, çdo hallkë që rriste prodhimin e qumështit e të mishit. Për gati dhjetë vite shërbeu si kryetar i degës së blegtorisë në N. B. Punoi me përkushtim, siç dinte ai ti bëjë gjërat. Deri atëherë, kur njerëzit si të droguar, morën kafshët nga stallat, prenë fidanët që ishin në kulmin e prodhimit dhe në librat e historisë do të shkruhej... na ishte njëherë...

Si gjithë të tjerët dhe Osmani mori tokën e tij. Nuk ishte shumë, por as pak nuk mund ti thoje, dy hektarë. Duart i hanin për punë. Vërtet ishte i angazhuar në drejtorinë e bujqësisë, në rolin e ekstensionistit, duke e marrë një rrogë, por ai donte të bëjë gjëra të tjera, akoma më të mëdha. A nuk kishte ëndërruar të bëhej si mjeshtrat e mëdhenj të frutikulturës, si Xhevdet Rina, Hysen Mikli, Tahir Laçi, Aqif Gjeleshi, e të tjerë si këto. Ja tek e kishte tokën e tij. Nëse nuk kishte shumë eksperiencë, ajo fitohej gjatë punës. Mehmet Meçe ishte një personalitet në fushën e frutikulturës, ku mbante titullin e doktorit të shkencave. Bashkë me të, Osmani krijoi fidanishten në tokën e tij, te shtëpia e tij. Fillimisht u mbollën tre - katër mijë fidanë. Më pas, Mehmeti shkon në Tiranë dhe Osmani i vetëm trajton deri në 8 - 9 mijë fidanë. Njerëzit donin të korrigjonin gabimin që kishin bërë, duke prerë pemët dhe tregu kishte uri. Fidanët ishin të certifikuar nga enti i farnave dhe fidanave. Mbillte kryesisht, mollë, dardhë, qershi dhe kumbull. Pak pjeshkë dhe kajsi. Fitoi njohuri të bollshme, a thua se gjithë jetën kishte studiuar për agronomi e frutikulturë. Mësoi të shartojë e të krasisë, mjaft mirë. I njihte nga lëkura varietetet e mollës, starkingun, gran smithin, goldenin, renetën. Po kaq mirë dallonte llojet e dardhave e qershive.

Në vitin 2004 – 2005, Osmani mendoi që kishte ardhur koha ti mbillte për vete, një pjesë fidanësh që ai prodhonte. Donte të kishte një pemëtore që të kënaqte syrin dhe shpirtin me bukuritë e saj. Nusen dhe fëmijët i kishte në krah, në çdo hap që hidhte, bile të gjitha vendimet konsultoheshin fillimisht me të gjithë anëtarët e familjes. Shumë shpejt, dy hektarët u mbollën me mollë, qershi e dardhë, të cilat filluan të japin frutat e para. Tani Osmani arrin të marrë mbi 250 kuintalë mollë, 40 kuintalë qershi dhe mbi 80 kuintalë dardhë, me një vlerë totale mbi 15 milionë lekë.

Arti i shartimit i pëlqente shumë, ishte një mister i madh, një botë në vetvete. Në pranverë, kur lëngjet limfatikë vërshonin sipër, Osmani bënte gati kalemat për shartim. Pritej nënshartesa, çahej ajo me kujdes dhe më pas dy kalema me nga tre katër sythe, ngjisheshin në të dy anët e saj, duke u izoluar e bërë njësh. Po kaq i bukur ishte dhe shartimi me syth në muajin gusht. Çahej nënshartesa në formën e germës "T" dhe futej aty sythi i llojit që ne pëlqejmë. Më pas një lidhje dhe sythi i vogël, kthehej në lastar e në pemë të madhe. Teksa zhytej në botën e shartimit, Osmanit i dukej vetja herë si doktor që kryen operacione dhe transplante e herë të tjera si një zbutës kafshësh të egra. A nuk kish zbutur dhe ai ato mijëra fidanë të egër, me fruta të vogla, në lloje të buta, kokërrmëdha, të shijshme, plot lëng e shkëlqim? "Gjithë jeta, - thotë Osmani, - është një shkollë e madhe. Problemi është, nëse ti do, që vërtetë të mësosh e të përfitosh prej saj".

Në vitin 2004 – 2005, Osmani mendoi që kishte ardhur koha ti mbillte për vete, një pjesë fidanësh që ai prodhonte. Donte të kishte një pemëtore që të kënaqte syrin dhe shpirtin me bukuritë e saj. Nusen dhe fëmijët i kishte në krah, në çdo hap që hidhte, bile të gjitha vendimet konsultoheshin fillimisht me të gjithë anëtarët e familjes. Shumë shpejt, dy hektarët u mbollën me mollë, qershi e dardhë, të cilat filluan të japin frutat e para. Tani Osmani arrin të marrë mbi 250 kuintalë mollë, 40 kuintalë qershi dhe mbi 80 kuintalë dardhë, me një vlerë totale mbi 15 milionë lekë.

Një zë i brendshëm i kujtonte se ai i kishte mbaruar studimet për zootekni. Sigurisht, Osmani nuk e harronte këtë. Pothuaj gjatë gjithë kohës, ai ka mbarështuar të paktën, tre lopë laramane, me mbi njëzetë litra për krerë, apo me një prodhim vjetor prej 6000 litrash. Qumështi dhe viçat i kanë shtuar ndjeshëm të ardhurat në buxhetin e familjes së tij, kurse plehu ushqen pemët dhe bimësinë, që ai e kultivon.

Për gati tetë vjet Osman Begun e shohim të drejtojë bujqësinë e gjithë qarkut të Dibrës. Kompetenca, profesionalizmi, korrektesa dhe komunikimi njerëzor, ishin cilësi dhe vlera, që ai manifestoi me shokët dhe kolektivin që drejtonte. Shumë vizita institucionale pati gjatë kësaj kohe. Në Paris, ndoqi për një javë një ekspozitë ndërkombëtare të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Në Dinjë, po të Francës, përfituan mjaft të reja shkencore nga frutikultura, kurse në Savojë shkuan për të parë lopën Taranteze në origjinën e saj.

"Sot ka shumë raca lopësh, me vlera të larta në prodhimin e qumështit dhe mishit, - thotë Osmani, - por lopa Taranteze, paraqet disa cilësi specifike. Rezistenca e lartë ndaj kushteve të disfavorshme të mjedisit, qumështi me shumë proteinë, djathi i një cilësie shumë të mirë dhe pjelloria e lartë, e bëjnë këtë racë shumë të kërkuar, sidomos për kushtet e rrethit tonë".

Osmani kujton gjithashtu dhe një vizitë pune në Udine të Italisë për vreshtin. Të gjitha këto eksperienca të paharrueshme, herë vetëm, e herë me një pjesë të stafit, i hapën atij dritare të reja se si duhej të drejtonte, çfarë duhej tu sugjeronin fermerëve dhe si mund ti mbështesnin ata, sa më mirë të ishte e mundur. Në vitin 2011, në Peshkopi hapet filiali i universitetit të Durrësit "Aleksandër Moisiu". Osman Begu, që mbante dhe titullin e doktorit të shkencave, u ftua të japë kontributin e tij si pedagog, fillimisht si i jashtëm e më pas me kohë të plotë. Ai u mësoi studentëve të tij lëndë të tilla si: "Fiziologjia e kafshëve", "Teoria e evolucionit", "Mikrobiologji" dhe "Bazat e prodhimit bujqësor" .

"Ishte një përvojë shumë interesante, - kujton Osmani. - Rifreskova dhe unë njohuritë që kisha marrë në fakultet, duke shtuar dhe të rejat shkencore të kohëve të fundit. Me studentët kam pasur gjithmonë marrëdhënie normale e korrekte dhe ndiqesha me shumë vëmendje prej tyre."

Vërtet është vështirë të kuptosh përmasat dhe vlerat e këtij njeriu. Nuk di nëse ka ndonjë profesion që nuk është në gjendje ta bëjë. Ai di të krasisë e të shartojë, të kosisë barin, të spërkasë pemët, duke i njohur me emra, sëmundjet dhe preperatet kimike. U shërben lopëve, jo vetëm duke u hedhur një deng bari në grazhd, por duke përpiluar racione ushqimore, sipas fazave të laktacionit. Ka dhjetë koshere bletësh dhe me mjaltin e tyre qeras miqtë e shumtë që i vijnë në shtëpi. Ka vite që kryen me shumë korrektesë inseminimin artificial te lopët. Është ky një shembull model, ku puna fizike lidhet me ata mendore, ku punëtori bashkohet me intelektualin, ku baza shkrihet me drejtuesin, ku njeriu i thjeshtë shkrihet natyrshëm me shkencëtarin, dhe ti nuk je në gjendje të dallosh kufirin mes tyre.

Osman Begu ka një familje të madhe, prej tetë anëtarësh. Ka gjashtë fëmijë, katër vajza dhe dy djem. Vajzat janë të martuara dhe e kanë bërë nëntë herë gjysh. Për ti vizituar ato, duhet të udhëtojë në Tiranë, Durrës, Francë dhe Angli. Po në Angli punojnë dhe jetojnë dy djemtë e tij, Arturi dhe Andi, me punë serioze dhe të ndershme. Kështu punon babai i tyre, kështu i mësoi dhe fëmijët të veprojnë në jetë. Ftesa të shumta ka çdo ditë nga fëmijët, djemtë dhe vajzat. Jo vetëm për vizita të shkurtra, por për të qëndruar bashkë, me familjet e tyre të reja. Deri tani kërkesat e tyre janë refuzuar.

Osman Begu drejton sektorin e bujqësisë në bashkinë e Dibrës dhe ka akoma për të dhënë nga përvoja dhe eksperienca e tij 60 vjeçare. Nuk mund ta ndërpresë punën këtu, në këtë moment delikat të riorganizimit të strukturave. Nuk mund ta lerë as pemëtarinë e tij në mëshirë të fatit, ata pemë, të cilave u dha aq shumë dhe po aq shumë mori prej tyre. Çdo qenie e gjallë do të përjetojë vdekjen, ky është ligji i Zotit. Ndoshta pas shumë e shumë dekadash, kur të ndërrojë jetë, Osmani do të donte të prehej tek toka e tij, atje ku janë prindërit, gjyshërit e të parët e tij. Do të donte që pemët që mbolli ta ndriçojnë me lulet e tyre të bardha në pranverë dhe ta veshin me gjethet e tyre në vjeshtë. Frutat le ti hanë njerëzit e tjerë dhe të luten për këtë njeri të mrekullueshëm, që Zoti ta bëjë prej banorëve të xhenetit.

Për gati tetë vjet Osman Begun e shohim të drejtojë bujqësinë e gjithë qarkut të Dibrës. Kompetenca, profesionalizmi, korrektesa dhe komunikimi njerëzor, ishin cilësi dhe vlera, që ai manifestoi me shokët dhe kolektivin që drejtonte.

Një kërkesë "hekurudhore"... në Kinë?! Dhe një harresë për Rrugën e Arbrit...

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Mësohet se Kryetari i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Ilir Meta në vijim të takimeve me personalitete të larta të politikës dhe bizneseve në Republikën e Kinës është takuar me drejtues të njohur të kompanisë kineze "Power Construction Corporation of China", cilësuar si "një investues aktiv në Shqipëri".

Yan Zhiyong, kreu i kompanisë kineze, citohet të ketë deklaruar se "Përveç by-pass-it të Beratit, ne po angazhohemi për ndërtimin e rrugës Thumanë-Vorë-Rrogozhinë"

Ishte rasti më i bukur që Kryetari i Kuvendit të parashtronte me drejtuesit e kompanisë më të madhe kineze për ndërtimet në infrastrukturë zotimin e sivëllait të tij politik në koalicion Edi Rama para dibranëve në fushatën e përbashkët elektorale për kryetarin e bashkisë së Dibrës i cili pat deklaruar se nuk do të largohet nga karrigeje e tij e kryeministrit pa përfunduar Rrugën e Arbrit (?!)

Kuvendit Ilir Meta kërkoi nga korporata kineze që të shihet me shumë interes edhe ndërtimi i hekurudhës që lidh Shqipërinë me Maqedoninë, projekt me interes edhe në kuadër të Korridorit të 8-të.

Lidhja hekurudhore midis Shqipërisë dhe Maqedonisë është lakuar më larg se një çerek shekulli më parë, është lakuar nga të gjitha qeveritë që erdhën e u ulën në kolltukun zyrtar shtetëror. U kërkua edhe nga Kryekuvendari Ilir Meta. Nuk e komentoj gabim. Lidhje hekurudhore përveç asaj me Malin e Zi duhet të ketë jo vetëm me Maqedoninë por edhe me Kosovën, edhe me Greqinë, me "Korridorin e 8-të" dhe me "Korridorin Blu". Është zhvillim, është frymëmarrje, na lidh me Evropën, me Lindjen e Perëndimin. Por...

Por përpara se të flasim shkruajmë e kërkojmë lidhje me fqinjët duhet të "lidhemi në vedvedi". Shqipëria ka një sistem hekurudhor në ditë të hallit, sistem të amortizuar, sistem që ende ka shinat (në mos edhe një pjesë të traversave) të viti 1946-1947, shina jugosllave të shtrira në degëzimin Durrës-Peqin e Durrës-Tiranë. Shqipëria ka në përdorim për pasagjerë (!) dhe për transport mallrash vagonët e ardhura nga Kina në vitet shtatëdhjetë të shekullit të kaluar...

> Shpresojmë që përfaqësuesit e kompanisë "Power Construction Corporation" në inkursionin e tyre për lidhjen e Shqipërisë me Maqedoninë me sistem hekurudhorë të udhëtojnë nga Vora në Lin të Pogradecit ulur në një ndër vagonët xhama thyer, relikte të miqësisë Shqipëri – Kinë...
>
> Pse jo, edhe rrugës së vjetër këmbësore nga Tirana në Dibër, "Rrugës së Arbrit"...

Në se gjendet në botë një sistem hekurudhor jashtë çdo norme ndërkombëtare ai gjendet vetëm në Shqipëri...

Meta, Rama dhe të tjerë (përfshi opozitën) të parën gjë që duhet të kërkojnë është rehabilitimi i sistemit hekurudhor të Shqipërisë, vënia në shfrytëzim e tij për tu shërbyer pasagjerëve, për transportimin e mineraleve dhe materialeve të tjerë që hanë si të babëzitur vlera të mëdha monetare. Sistemi hekurudhor shqiptar duhet të kalojë nga sistem me një kalim në atë me dy kalime, nga sistemi tepër i vjetruar i vënies në lëvizje me karburant në sistemin elektrik. Nga gjendja aktuale ku mbi shina kullosin lopët e luajnë fëmijët në sistemin e rrethuar ku të mos mundet të kalojë askush përveçse me nënkalime apo me mbikalime.

Ndonjë segment i sistemit hekurudhor shqiptar si ai Tiranë Kavajë duhet të shndërrohet në sistem qytetës udhëtarësh në mënyrë që mijërat e apartamenteve të ndërtuara në plazhet e Durrësit, Golemit, Malit të Robit të shndërrohen në qendra banimi të përhershme për poseduesit e tyre çka do të zgjidhte jo vetëm problemin e ngërçit nga babëzia e ndërtimeve masive me refleks mos shitjen e tyre por edhe lehtësim të zgjidhjes së problemit të banesave të qytetarëve. Linja në fjalë nuk është veçse 5-7 kilometra më e gjatë se sa linja Kifisia-Pire (26 kilometra), linjë e cila i jep një frymëmarrje të madhe hapësirës së banimit, përcjell çdo ditë nga shtëpia në punë dhe anasjelltas një popullsi aktive sa "dy Tirana plus Durrësin e Fierin" të marrë së bashku.

Pas këtyre lutjeve përfaqësuesit e kompanisë "Power Construction Corporation" vendosën të dërgojnë një grup pune në Shqipëri për të vlerësuar në terren propozimet e bëra nga ana e delegacionit shqiptar...

Shpresojmë që përfaqësuesit e kompanisë "Power Construction Corporation" në inkursionin e tyre për lidhjen e Shqipërisë me Maqedoninë me sistem hekurudhorë të udhëtojnë nga Vora në Lin të Pogradecit ulur në një ndër vagonët xhama thyer, relikte të miqësisë Shqipëri – Kinë...

Shpresojmë që "Korridorin e 8-të" të lidhjeve të Shqipërisë me Maqedoninë. Bullgarinë, Rumaninë, Turqinë e më tej me Azinë ta shohin nëpërmjet Rrugës së Arbrit, rrugës më të shkurtër drejt "lindjes shqiptare" e më tej drejt lindjes ballkanike.

Shpresojmë...

Kërkohen korrespondentë në Peshkopi dhe Dibër të Madhe

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.

Të interesuarit të shkruajnë email në adresën

< rrugaearberit@gmail.com >

ose të telefonojnë në numrin

069 20 68 603.

Bëj pajtimin tënd me

PayPal

përmes emailit

<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:

Në Shqipëri: 600 lekë.

Në Europë: 10 Euro.

Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA

është vetëm në versionin PDF.

Mentori i Zeralinjve të Dibrës

(Vijon nga faqja 6)

UMT e Durrësit, uzinën e Korçës u habit.

Mua më ka pas dhënë Adil Çarçani, ministër i Industrisë dhe Minierave në atë kohë, 900 mijë dollarë. Na duheshin për të blerë një makineri të kohës për të bërë riparimin e kushinetave. Unë arrita ta bindi shokun Adil dhe mi dha. Më vjen shumë keq që atë makinë që edhe sot e qaj, që bënte punë në të dhjetë mijtën e mikronit, e kanë shit për skrap në Mal të Zi. Kam shkuar dhe e kam gjet në Mal të Zi , kam shkuar dhe e kam gjet në uzinën që e ka ble. Ata e blenë për skrap, e pastruan dhe e vunë në punë dhe akoma punon në Mal të Zi...

Unë në NSHRAK nuk them se kam bërë ndonjë gjë të madhe. Nuk e mendoj se unë kam bërë, por punëtorët e mi, duarartët e mi. Ata kanë bërë shumë gjëra. Ata kanë bërë gjëra që janë habitur qoftë në Gjermani, në Munih ku kam shkuar dhe i kam parë, qoftë në Çeki, qoftë në Milano, qoftë në Romë, qoftë në Paris kur kanë parë prodhimin e pjesëve të ndryshme. Kanë thënë se kjo nuk është e vërtetë, nuk mund të prodhoheshin. I prodhonim shtrenjtë? Po. I prodhonim me materiale jo shumë të mira? Po. I prodhonim me ato që kishim. Nuk kishim çelikun suedez. Në Elbasan e merrnim. Ne i prodhuam.

Ne arritëm edhe një sukses tjetër që ia dedikoj pak vetes por shumë specialistëve. Unë arrita të bëj nga 13 vetë me arsim të mesëm që gjeta, gjysmën e personelit me arsim të mesëm, burra dhe gra. E hapa shkollën me dy klasa dhe arrita me 9 klasa, me dy turne, turni i parë dhe turni i dytë. E detyroja çdo punëtor që e shikoja se ishte në gjendje, kishte mundësi, i jepja edhe mundësi financiare, edhe mundësi kohe. I rregullova turnet me qëllim që secili ta mbarojë shkollën. Dhe arriti ta mbarojë shkollën. Sot unë jam krenar për disa njerëz që vijnë nga Gjermania, Amerika, Kanadaja, Japonia, kudo ku kanë shkuar dhe më falënderojnë.

Njeri kohët e fundit erdhi me të fejuarën. Unë i njihja shumicën e punëtorëve me emër e mbiemër. Nuk e njoha, mbase nga mosha, mbase kishte kaluar shumë kohë, mbase emigracioni i kishte dhënë të tjera ngjyra. Më tha si nuk më njeh inxhinier Mentori? Nuk të njoh, i thashë.

Unë jam ai Manoli që e ka përzënë katër herë nga puna drejtori jot. Ju, tinëz, ai më përzinte nga dera kurse Ju më fusnit nga dritarja.

Mu kujtua. Një djalë i brishtë, me zemër të mirë. Ishte rritur, kishte krijuar familje dhe kishte mbaruar universitetin në Sidnei të Australisë dhe punonte në një kompani të nderuar. Dhe më tha se ai ishte kryetar grupi në kompani.

Këto gjërat e vogla më japin shumë gëzim, shumë kënaqësi, ma shtojnë jetën.

Mua më ka ndihmuar edhe ajo që pasi u diplomova inxhinier dhashë për 14 vjet mësim në Universitetin e Tiranës. Jepja katër lëndë me buletinin teknik që e kisha shumë qejf dhe Besim Daja, dekan i fakultetit dhe pedagog imi. Ky më tha që të vish pedagog. Kjo ishte në vitin 1956. Më tha se më duhet një njeri që ta njohë profesionin por të njohë edhe punën. Kam dhënë teknologji ndërtim makinash për gati 12 vjet. Me ndihmën e Tahir Haxhiymerit që ka qenë një pedagog i shkëlqyeshëm mora teknologjinë e ndërtimit të metaleve. Kam dhënë edhe teknikën e sigurimit.

Të të tregoj një incident që më ka ndodhur. Isha në Moskë me një delegacion. Shkova takova pedagogun që më ka dhënë mësim sepse ne në atë kohë na jepnin mësim pedagogë të huaj. Vetëm dy pedagogë kanë qenë shqiptarë, të gjithë të tjerët kanë qenë rusë. E takova pedagogun. I çova një tufë me lule dhe një tufë me dafinë. Dafinën ata e kanë si një gjë shumë të shtrenjtë. Më mori për drekë. Më mori për darkë. Më çoi në vendet më të bukura të Moskës. Në fund më dha disa libra por më pyeti se çfarë lëndësh jepja mësim. I thashë se jap teknikën e sigurimit. Më dha një libër përkthim nga anglishtja nga një autor amerikan. Një ditë u them studentëve një shprehje nga parathënia e librit " Njeri! Ruaje veten nga rreziku. Zoti kur të krijoi nuk ka krijuar pjesë këmbimi për ty". Një spiun, një maskara po them shkoi më paditi dhe më futi në kallëpin se po bën propagandë Zotin. Nuk ngeli njeri pa më thirrë. Më thirri deri zëvendësministri dhe më futën në këtë kanal. Në muhabet e sipër me një pedagog të universitetit i tregoj librin dhe i them se nga rusishtja e kam marrë. Më thotë se nuk është e vërtetë. I Them urdhëro, merre librin. E lexoi. Shkon ky dhe u thotë a jeni në vete ai e ka thënë nga libri. I thonë se nuk është e vërtetë. Urdhëro librin dhe ua jep. Thanë se ky qenka me e përjashtuar nga universiteti dhe me e çuar inxhinier se bën propagandë...

Kohë me njerëz të vegjël të mbyllur në guaskën e përgatitur të kohës...

E pyes se si e kalon kohën...

Kam një nip të vogël dhe aty (më tregon kopshtin) kam mbjellë me duart e mija perime bio.

Merrem edhe me pikturë, me krijime artistike...

Nuk e bëj as për interes, as për të shitur. E bëj për ta mbajtur veten time në zhvillim.

Abdurahim Ashiku

recensë

Toponimia e Çidhnës në një vështrim etnotekstor

Nga **SHABAN SINANI**

I.

Studimet shqiptare i kanë një detyrim shumë të madh *toponimisë*. Teza se vetëm emërtimet e mëdha (të maleve, lumenjve, qyteteve, kështjellave dhe krahinave) kanë rëndësi për etnogjenezën e shqiptarëve, së cilës iu përmbajt E. Çabej në të gjitha studimet e tij etimologjike, duke qenë një premisë që i siguronte kthjelltësi kësaj diturie, historisë së gjuhës, nuk ishte me vend të zbatohej edhe në disiplina të tjera, në mënyrë të veçantë në *gjuhësinë etnotekstore*.

Ishte Francesco Altimari, një figurë e njohur e albanologjisë së sotme, ai që i riktheu vëmendjen kësaj *motre të vogël e të re* të shkencave gjuhësore, duke propozuar ndryshimin e sjelljes ndaj pasurisë leksikore, për ta parë atë jo thjesht si mjet komunikimi, por para së gjithash si pasuri kulturore, si bartëse dhe përcjellëse e një rezervàti të dhënash, që përmbajnë kodin e trashëgimisë.

Duke e parë trashëgiminë gjuhësore si pasuri etnotekstore dhe duke hedhur ura ndërdisiplinore për kërkimin e sotëm shkencor, Francesco Altimari dhe ndihmësit e tij krijuan përvojën e parë të *etnogjuhësisë shqiptare*, pjesë e së cilës është edhe toponimia. Kjo gjeti shprehje të drejtpërdrejtë në nismën për shpalljen e pasurisë leksikore jo në mënyrat e deritashme, me renditje alfabetike në fjalorë shpjegues, por me një renditje mbi bazën e lidhjes së fjalës në çerdhen etnotekstore: *parmenda, bujku, ara, drithi, buka, mulliri, lumi* e kështu më tej, duke e përshkuar skaj më skaj gjuhën e gjallë. Hapi tjetër i rëndësishëm i kësaj përvoje qe kapërcimi i konceptit tradicional për fjalët quajtëse dhe ato të veprimit, duke konsideruar bashkë me to si emra edhe emërtimet e përveçme, duke parë vlera etnogjuhësore edhe tek toponimia. Dhe kështu morën rëndësi jo vetëm emërtimet e mikrovendeve, por dhe *toponimia vendore*, me emrat e fortesave dhe kishave, *xhiteteve* dhe *varosheve*, varreve, kullave, puseve, udhëve, urave, arave, pyjeve, bjeshkëve, *sheve*, shkëmbinjve, *rogave* (*rogjave*) dhe rudinave, livadheve, krojeve, përrenjve, mullinjve, qafave, grykave, lugjeve dhe *vaheve*; *fitonimia*, *zoonimia* e *hidronimia*, që janë dëshmitaret e historisë gjuhësore të bartësve krahinorë dhe shprehje e individualitetit etnografik të tyre.

Ka qenë një tezë e argumentuar pikëpamja e E. Çabejt, sipas të cilit shqiptarët, në punë të emërtimeve të mesme e të vogla të vendeve, *e kanë të humbur çështjen*, sepse këto emërtime kanë ndryshuar sa herë kanë ndryshuar sunduesit. Dhe sunduesit, në dymijë vjet, kanë qenë të shumtë: në bisedën me Fr. J. Strauss, A. Buda numëronte mbi 60 ushtri të huaja të pranishme në tokën shqiptare. Indiferentë ndaj ripagëzimit të shpeshtë të vendeve të tyre prej këtyre ushtrive dhe administratave të tyre ushtarake e civile, sepse nuk kishin nevojë për dëshmi gjuhësore për të provuar se ishin autoktonë dhe jo aloktonë në këto vise, shqiptarët lejuan që toponimia e tyre vendore të përshtatej sipas gjuhës së ardhësve. Kjo shpjegon pse *toponimia e shkallës së dytë dhe të tretë* arriti t'i ngjajë një palimpsesti, ku mbivendosen sipas kohëtores së sundimit ushtarak a kulturor: shtresa helenike e ajo latine, shtresa bizantine e ajo veneciane, shtresa sllave e ajo osmane. Në këto shkallë të toponomastikës nuk mungon as gjurma anzhuine e ajo gjermanike, gjurma kelte e ajo hispanike.



HAKI PËRNEZHA, RRUZHDI BITRI
Toponimia e Çidhnës
(Me 110 ilustrime fotografike dhe me një fjalës të leksikut të rrallë)

Botimet M&B
ISBN 978-9928-172-91-4
336 faqe
Çmimi: 1500 lekë

Botimin e këtij libri e mundësoi z. Shaban Bitri. Autorët dhe botuesi i shprehin atij mirënjohje.

Në librin e këtyre dy autorëve janë ndërthurur meritat e mbledhësit, tejshkruesit dhe të studiuesit. Aty janë bashkë edhe filologu, edhe dialektologu, edhe antropologu e historiani.

Përkundër kësaj indiference, shkolla sllave e etnogjuhësisë qysh në shekullin e romantizmit iu drejtua tokës shqiptare për të gjetur dëshmi përkatësie kudo që ishte e mundshme: në emërtime, para së gjithash në toponiminë e shkallës së dytë dhe të tretë, ndaj së cilës vendësit paleoballkanas kishin bërë lëshime historike. Libri i A. Selishçevit *Popullsia sllave në Shqipëri* (A. Селищев, *Славянское население в Албании*), i botuar në Sofje më 1931 nga Instituti Shkencor Maqedon (*Македонский Научный Институт*), do të ishte një prej sprovave jo pa gjurmë e ndikim të përpjekjes për të vërtetuar një prani konsistente sllave në hapësirën historike shqiptare. Do të mjaftonte vetëm njëra nga pesë hartat e emërtimeve sllave në Shqipëri, me të cilat hapet ky libër, për të kuptuar se çfarë funksioni iu dha këtyre dy shkallëve të toponimisë në funksion të etnogjenezës dhe përhapjes së sllavëve në faqen perëndimore të Ballkanit, veçmas në mjedisin shqiptar.

Keqkuptimi i tezës së E. Çabejt, për një ndarje të qëndrimit ndaj toponimisë historike protoshqiptare, kryesisht ndaj *toponimisë së shkallës së parë* (duke nënkuptuar me këtë, bashkë me makrotoponiminë, edhe arkeonimet, etnonimet, endonimet dhe ekzonimet), me qëndrimin ndaj *emërtimeve të shkallës së dytë dhe të tretë*, çoi në një mosvëmendje të qortueshme shkencore sa i takon atij fondi të dhënash gjuhësore-historike që përmban toponimia vendore. Nëse kjo toponimi vërtet nuk kishte ndonjë vlerë të dukshme dhe nuk jepte shumë argument për vazhdimësinë historike të shqiptarëve që nga periudha ilire (në mos, në ndonjë rast, mund të kthehej në veprim të kundërt), ajo pa dyshim kishte vlera për shkenca të tjera etnogjuhësore. Frika se mos prej shqyrtimit të kësaj toponimie do të dilnin dyshime për karakterin vendës të emërtimeve të vogla e të mesme çoi në arkivimin e këtyre të dhënave dhe në mungesën e studimeve. Për afro një gjysmë shekulli toponimia u mblodh bashkë me leksikun, u bë pjesë e Kartotekës së Leksikut të Shqipes, duke numëruar disa milionë njësi, por vetëm si një pasuri e fjetur, e ngrirë, në përfytyrimin e ndokujt ndoshta dhe e rrezikshme.

Provat për ta kthyer toponiminë e shkallës së dytë dhe të tretë në armike të makrotoponimisë dhe në sabotuese të vazhdimësisë kronotopike të shqiptarëve nuk kishin munguar. Këto prova të sjellin ndërmend menjëherë emrin e akademikut serb Jovan Cvijić dhe veprën e tij *La Péninsule balkanique, géographie humaine* (*Gadishulli i Ballkanit, një gjeografi njerëzore*) botuar më 1918 në Paris dhe më vonë përkthyer e botuar në dy vëllime në serbokroatisht (Zagreb e Beograd, 1922-1931), me titullin *Balkansko poluostrvo i južnoslovenske zemlje: osnove antropogeografije* (*Gadishulli i Ballkanit dhe territoret jugusllave: bazat e antropogjeografisë*).

Në këtë vepër, si dhe në studimin tjetër, *Antropogeografski problemi Balkanskog poluostrva* (*Probleme antropogjeografike të gadishullit të Ballkanit*), në kuadër të konceptit të tij për kushtëzimin e natyrës dhe të identitetit të bashkësisë nga mjedisi gjeografik (*географска средина и човек*), Jovan Cvijić u përpoq që ta shndërronte natyrën, mjedisin, gjeografinë, në shkencë etnologjike. Duke iu përmbajtur tezës së gabuar se çdo trashëgimi e krishterë në Kosovë është serbe, ai, ashtu sikurse do të vepronte A. M. Selishçev me emrat e vendeve, *e rikrishteroi* këtë hapësirë pikërisht përmes emërtimeve vendore të shqiptarëve, duke e mbushur gjithkund me emra kishash dhe manastiresh, me emra shenjtorësh e martirësh, me qëllim që shqiptarët e atjeshëm, popull me shumicë myslimane, të mbeteshin të çarmatosur përballë pyetjes për hershmërinë e tyre. Kështu ndodh kur një trashëgimi nënçmohet: ajo kthehet menjëherë në vlerë të dobishme për të tjerët. Mbi bazën e emërtimeve të krishtera në Kosovë J. Cvijić e mbushi hartën e saj me emra kishash e manastiresh, që do të shndërroheshin në kryeargument për *karakterin ardhës* të shqiptarëve, për më tepër të favorizuar e të shpërblyer nga ish-perandoria osmane për merita shpate dhe besnikërie, për merita lufte dhe devocioni.

II.

Nëse toponimia e shkallës së dytë dhe të tretë nuk ofron argumente për lashtësinë parashqiptare, ajo është më se e dobishme për qëllime të tjera: për shtresëzimin e pranive kulturore të tjera më së pari; për karakterin e hapur të gjuhës dhe kulturës shqiptare; për historinë e ndryshimeve në emërtime nga koha në kohë; për sekretimin e informacionit të kryehershëm brenda një veshjeje gjuhësore të re dhe shpesh të huaj; për njeriun në familje e farefis, në fshat e krahinë; për individin *më vete e me të tjerë*, siç do të shprehej M. Camaj.

Libri i Haki Përnezhës dhe i Rruzhdi Bitrit *Toponimia e Çidhnës*, shoqëruar me mbi 100 foto ilustruese dhe me një *lexicon* të fjalës së rrallë e në zhdukje, së bashku me frazeologjinë që lidhet me to, është një provë burimore dhe shkencore e rëndësisë kulturore e historike të emërtimeve vendore. I shkruar pas një vëzhgimi kërkimor prej shumë vitesh, prej dy njerëzish që janë edhe vetë subjekt i kërkimit; me një vëmendje diturore të kthyer në qëllim prej dekadash më parë, *Toponimia e Çidhnës* është një *regestum* i emërtimeve të përveçme të kësaj krahine etnografike, një *hipotekë* e kësaj pasurie shpirtërore, e cila për fat tashmë ka zot, dhe ky zot është folësi shqiptar i atyre anëve, bartës brez pas brezi i saj, një bartës sa krijues aq dhe ruajtës, sa pragmatik, aq dhe sintagmatik, sa figurativ aq dhe përdorues.

Në librin e këtyre dy autorëve janë ndërthurur meritat e mbledhësit, tejshkruesit dhe të studiuesit. Aty janë bashkë edhe filologu, edhe dialektologu, edhe antropologu e historiani. Libri i tyre është një arritje etnogjuhësore, në të cilën fjala dhe bartësi i saj nuk ndahen.

Lexuesit që e merr këtë libër si një punë të përfunduar mund t'i duket thjesht një pasqyrë: pasqyra e një pasurie që është e gjallë dhe e gatshme ndër banorët e fshatrave të Çidhnës. Kjo është më pak se gjysma e së vërtetës. Të krijosh pasqyrën e të dhënave etnotekstore është meritë, por përtej kësaj merite gjendet një proces pune të mundimshme e të padukshme: procesi i kalimit prej ligjërimit të folur në ligjërimin e shkruar. Ky është një proces shumë i ndërlikuar, duke e ditur se ç'piramidë të ndërlikuar fonematike kanë të folmet e Dibrës, sidomos sistemi sonor, me zanoret e dyfishta, me zanoret hundore; me zanoret tonale e gjysmëtonale; dhe sidomos me zanoret e ndërmjetme, zanoret e gjysmëlartësisë, për të cilat duket sikur nuk do të mjaftonin shenjat grafematike të alfabetit të indoeuropeishtes. Nuk është aspak më i thjeshtë sistemi bashkëtingëllor i këtyre të folmeve, me shmangiet e shumta prej tingujve bazë të shqipes dhe deri me shuarjen e dallimeve në çiftet e tyre minimale. Puna e tejshkruesit të kumteve zanorë është po aq e vështirë sa dhe e filologut klasik, që mundohet të çkriptojë kodet e hershme shkrimorë dhe të stabilizojë, qoftë në rrafshin hermenenutik, qoftë në atë kulturor-historik, *tekstin e shkribës*, nëse do të huanim një neologjizëm të M. Camajt.

(vijon në faqen 17)

Rruga e Arbërit nr. 126

Fotoreportazh / Udhëtim në kohë

Njeriu ynë i mirë, Baftjar Shahini

Ai iku më 17 nëntor 1989 për të mbetur i paharruar midis nesh. Moto e jetës së tij ishte "Jam i lumtur kur shoh njerëz të gëzuar" -vënë kjo edhe si epitaf në banesën e fundit të tij.

E gjeta midis fletëve të zverdhura të koleksionit të gazetës "Ushtima e maleve". Më dhembi shumë ikja e parakohshme e shokut dhe mikut tim, shok e mik i të gjithëve, njeriu që qeshte me shpirt, njeriu me zemër të madhe. Nuk mund ta lija midis fletëve të zverdhura, e mora dhe po e përcjell tash pas 27 vjetësh për ti dhënë pak shpirt.

I përjetshëm qoftë kujtimi i Baftjar Shahinit.

Më poshtë po botojmë një fragment shkrimi, shoqëruar me një fotoreportazh nxjerrë nga A.ASHIKU - ARKIV

7 tetor 2016

* * *

Njerëzit e mirë, edhe kur nuk janë më, jetojnë. Dhe kjo ndodh se me punën e tyre, në jetën e tyre të shkurtër, kanë arritur të vendosin diçka të paluajtshme në truallin e jetës sonë.

Babait të tij, Xhaferrit, në ato vite të stuhishme të Luftës i takoi të vinte jetën në themelet e Shqipërisë së re.

Baftjar Shahini, i biri, ra në krye të detyrës më 17 nëntor 1989.

Kam shumë mbresa për këtë shok punëtor e të sakrificës, njeri të aksionit e të punës sulmuese, njeri ku intelektuali dhe punëtori, qenë shkrirë në një.

Vite më parë, si tani dhjetë vjet të shkuara kur punonim për psikologjinë shoqërore për punën e pronën, Baftjari kishte dëshirë të ndalej tek psikologjia e punës e minatorit të Bulqizës. Ishin shumë jetësore mendimet e tij, të pjekura e të menduara mirë. Buronin nga thellësitë e minierës së kromit ku kishte punuar dy vjet radhazi si kandidat partie, nga zemrat e shokëve të tij minatorë e vagonistë, nga mendimi e psikologjia e njerëzve që ai i kish njohur mirë. Shokë të shumtë kishte mes minatorëve të Bulqizës Baftjar Shahini, mes punëtorëve kudo në rreth...

...Në ndërmarrjen e ndërtimit ku punonte kohët e fundit, gjithnjë e kam takuar midis specialistëve ndërtues në Peshkopi, Bulqizë, Sllovë, Kala të Dodës. I donte dhe kishte dëshirë të shkruante për ta, për përvojën e tyre, dashurinë për profesionin. Dhe shkroi. Duke menduar e punuar për ta, ra në krye të detyrës.

Dhembjet kapërcehen me forcë. Kështu vepronte edhe Baftjar Shahini. Humori i tij, ngrohtësia shoqërore, optimizmi që krijonte, na qëndrojnë kurdoherë para syve.

Midis fotografive të shumta që kam për Baftjarin, shkëputa njërën prej tyre, atë të 26 qershorit të këtij viti, kur shkuam bashkë në Kala të Dodës për të bërë reportazhin për punëtorët e ndërtimit...

Abdurahim Ashiku
"Ushtima e maleve", 30 nëntor 1989

botime të reja

Sabri Caka, krahu i shqipes **në flamur**

Nga **HALIL TEODORI**

Që kur mora përsipër të shkruaj këto radhë për Sabri Cakën, nuk mund të lija pa përmend Okshtunin, Ternovën, Zerqanin, Gollobordën dhe fshatrat përreth. Janë këto piketa gjeografike, janë këto toponime, me të cilat mbetet e lidhur vegjëlia e heroit, andrallat dhe shpresimet, e djeshmja, e sotmja dhe e ardhmja e atyre banorëve. Me ndërgjegje të kthjellët dhe përgjegjësi,pohoj, se sado të përpiqesha për ta dhënë të përplotësuar panoramën, e pamundur do të ishte të arrija të thoja gjithçka që duhej.

Gjithçka që dija do të ishte e paplotë dhe e pamjaftueshme për të qenë në vetvete një dëshmi e shtresimeve të ndryshme që do të përfaqësonin në tërësinë e vet këtë rrekje promovuese, këtë panoramim përmes së cilës përshkohet e gjithë ajo rrjedhojë, gjithë ajo tokë e gatuar prej gjakut dhe amaneteve, lotësh dhe shpresimit.

Kjo mëdyshje i ngjet një ngulmi për të marrë mbi vete synime, të cilat kërkojnë të përsosurën dhe vetëm të përsosurën. Me gjithë përpjekjet që bëra, për ta plotësuar këtë kuadër, duke konsideruar si të frytshme njëherazi ndihmën e dhënë nga bashkëpunëtorët që mu gjendën pranë me gatishmërinë e tyre për të më mbështetur me fakte dhe dëshmi për botimin e këtij libri, e ndjej se kam ende shumë gjëra. Megjithatë, çdo vullnet pozitiv është një përpjekje dhe çdo rrekje për të dëshmuar të shkuarën është një rreze drite që udhërrëfen rrugën e brezave. Por e ndjej obligim t'u kërkoj ndjesë bashkëfshatarëve të mi të nderuar, ku u lindëm dhe u rritëm të më mirëkuptojnë në këtë dashamirësi.

Gjithsesi, për të qenë i sinqertë me lexuesit, shpresoj dhe besoj, që kam hapur një dritare sado të vogël, për të hedhur dritë në plotësimin e imazheve për ata që mund dhe duhet të guxojnë të marrin penën dhe të shkruajnë në këtë drejtim, pasi çfarëdo që të shkruash, përsëri e përsëri do lësh e do mbetesh mangët në dhënien e panoramës dhe portreteve të plota të gjithë atyre personaliteteve që shërbyen dhe sakrifikuan jetën e tyre në shërbim të trevës së "Grykës së Zajeve" dhe më gjerë, të Dibrës e gjithë Shqipërinë.

Historia duhet të jetë e shkruar dhe duhet t'u përcillet brezave ashtu siç është, ku ata të shohin veten në të kaluarën.

Jo vetëm për periudhën post-komuniste, por edhe ato të mëhershmet pak është shkruar për historikun e vendlindjes sonë. Zona jonë ka nxjerrë heronj dhe figura të shquara, personalitete të rëndësishme të kulturës dhe dijes, guximit dhe vendosmërisë, traditës dhe atdhetarisë. Kjo kolanë e gjatë dishepujsh të vlerave dhe krenarisëi ka shërbyer vendit, por ata kanë ngelur pa u bërë të njohur, përfaqësuar dhe vlerësuar. Sepse është detyrim i gjeneratave që në emër të mirënjohjes, në emrin e thirrjes së gjakut, në emër të më të shtrenjtës që na ndjek nga pas kudo që të shkojmë, në emër të plisit, t'i njohim, t'i promovojmë dhe ta çmojmë

Historia duhet të jetë e shkruar dhe duhet t'u përcillet brezave ashtu siç është, ku ata të shohin veten në të kaluarën.



HALIL TEODORI
Sabri Caka, krahu i shqipes në flamur
Botimet M&B
ISBN 978-9928-172-93-8
240 faqe
Çmimi 700 lekë

kontributin e tyre. Sepse është kjo përpjekje, është ky angazhim, është kjo detyrësi, ajo që na nxit të jemi ne ata që do të shkruajmë ato faqe të historisë që trualli na i ka besuar ne, sepse vetëm ne mund ta matim dhimbjen e kësaj toke, ta dëgjojmë kushtrimin e këtyre maleve, t'u bindemi këshillave të etërve flokëbardhë, ta lehtësojmë dhimbjen e kësaj plage.

E shkuara vetëm përmes gojëdhënave ka ardhur brez pas brezi deri në ditët tona. Ne duhet të pranojmë se kemi detyrën historike të nënshkrimit të kësaj kontrate për të dëshmuar, për të trashëguar, për të çuar më tej, për të mos e lënë të shuhet, të vdesë, ta nënshtrojë harrimi një pjesë të krenarisë sonë, një domosdo që mbartet për t'ua pasuar brezave si amanet, të cilin nuk e tret as dheu.

Arsyeja pse unë i hyra këtij studimi ishte se në realitet është shënuar një ndryshim shumë i kufizuar në drejtim të shkrimit ndërnacional të historisë.

E rëndësishme është që të sjellim ndër mend se historia e zonës është pak e njohur. Në të vërtetë mund të thuhet se për periudha të gjata, vështirë se mund të thuhet se kanë ekzistuar këto njohuri. Është mirë ta bëjmë vetë historinë e brezave tanë dhe të mos e lëmë atë, në duar të dikujt tjetër. Sepse vetëm ne e njohim këtë ritëm gjaku, këtë vërshim limfe, këtë kreshtë krenarie që matet me malet, ku bora shkrin me vonesë.

Çfarëdo interpretimesh që janë bërë për atë kohë që ka shkuar, në kuptimin e atmosferës së përgjithshme të historiografisë, duhet thënë se pasqyrimi ka qenë jo i mjaftueshëm.

Vetëm në historinë e Okshtunit, Ternovës, Smollikut, Lubaleshit, Kojavecit dhe zonës përreth, kanë zënë vend episode të tilla dhe këtu flitet për martirizimin, me figura të tilla si: Hoxhë Hasan Muglica dhe Heroin e Popullit Qemal Stafa të cilët luftuan për nacionalizmin shqiptar parimor, duke flijuar jetën e tyre në rrethana të vështira.

Një **jetë** në 36 **shkronja**

I dashur lexues

Kur nisa të shkruaj jetën time, u ktheva vite pas. Mendoja se mendimet e kujtimet më ishin zbehur, se ishin harruar, por ndërsa shëtisja brenda tyre, e ndjeva veten të vogël. U çudita se si ishin regjistruar në kujtesë si në një hartë të grisur nga plagët e mbetura, të pashërueshme, pavarësisht se isha përpjekur t'i shëroja. Ato vuajtje, ato plagë më bënë të vras frikën. U ktheva në botën time të thjeshtë, të vuajtur me pak gëzime, me një dritë të lehtë, të zbehtë si ajo e xixëllonjës në kohën e të korrave. Dëgjoja përallat e gjyshes, ndjeja gëzim, i cili më dërgonte larg detit, pranë tim eti...

Jam përpjekur t'i përshkruaj thjesht e pa zbukurime, pa sajesa, me fjalët e shpirtit.

Ëndërroja dikur të shkruaj. Të shkruash më dukej gjëja më hynore, me dritë si e hënës, bashkuar me diellin. Më vinte dëshira si një re e lehtë, por para saj qëndronte një mjegull e një furtunë jetësore që nuk e çaja dot. Të gjitha këto ëndrra qenë një iluzion.

Ka kaluar kohë. Sot, me rrudha në ballë, mora penën të derdh në shkronja dhe kujtimet. Dëshira ka qenë e madhe, por nuk pata guximin të zbuloja misterin e jetës sime, misterin që mbaja fshehur në shpirt. Nuk e mora guximin nga kuçedra e luftës së klasave. Nuk mund të ngrija kokë, të kundërshtoja, të shkruaja se do merrja shumë njerëz me vete. E mbylla brenda vetes të vërtetën, e mbylla në zemër me shtatë çelsa, deri sa erdhi dita,

Me penën time, bëj thirrjen e një zemre që ndjen për këtë tokë të bekuar e të varfëruar thellë në shpirt. Kjo është lufta ime me shkrimet e mia. Jam paraqitur te ju me botimin e parë në prozë "Një jetë në 36 shkronja" në vitin 2011, "I Përkushtuari" me bashkautor F. Xhanin 2012, dhe me librat me poezi lirike "Zemër e lënduar" 2012, "Pikojnë yje mbi sytë e tu", 2015 dhe sot me librin e ribotuar "Një jetë në 36 shkronja" dal sërish.

Në shkrimin e këtij libri jam munduar të shtjelloj ngjarjet, jo vetëm të miat, por të shumë Hatixheve, nënave, gjysheve dhe fëmijëve tanë. Me shpresë se kam mundur të godas me forcë poshtërsitë, mizoritë, plagët. Jam munduar të sjell ide fisnike, të sjell emocione e dashuri. Pavarësisht nga emrat e personazheve, ngjarjet janë simbol i brezit tim të vrarë, internuar, dhunuar dhe injoruar. Cilido lexues mund ta gjejë veten në pjesët e këtij libri. Mendoj se e meritojnë të shkruhen këto ngjarje që të mos përsëriten më kurrë. Pati shumë familje që vuajtën shumë e më shumë se unë.

Çkyça kujtimet që janë "thesaret e shpirtit" të çdo njeriu që i ruan si gjënë më të shtrenjtë. Si mësuese, e ndjeva për detyrë

HATIXHE EREBARA
Një jetë në 36 shkronja
Botimet M&B
ISBN 978-9928-172-89-1
330 faqe
Çmimi: 800 lekë

t'i shkruaj për brezat e ardhshëm, që të njohin vuajtjet e këtij populli të vogël, por hallemadh, nga ai sistem i uryer.

Unë vrava ndrojtjen dhe frikën t'ju dhuroj juve disa nga thesaret e mia. T'i ndaj me ju, t'ua lë brezave që vijnë. Duke i lexuar, shpresoj se do të jem më e besueshme. Fjalën gojore e merr era, kurse fjala e shkruar nuk harrohet.

Kur mora penën ndjeva përgjegjësi për punën. Vendosa të isha besnike e realitetit, se jeta që jetova më solli dhimbje. Në këtë libër u përpoqa t'i tregoj, t'i sjell brengat e mia të padeformuara.

Vitet largohen njëri pas tjetrit e unë sot jam nën ndikimin e puhizës së maleve dibrane. Kujtesa m'i risjell, por ajo nuk është në gjëndje të më errësojë të sotmen, por nuk dua të ma fshijë, se nuk do shijoja të sotmen, pjesën e mbetur.

Trillet e fatit qenkan të gjithëpushtetshme dhe të padeshifrueshme. Megjithëse e gjendur në një kohë pa fre, jeta shkoi para dhe unë e ndjeva atë në shpirt. Nuk desha të largohem nga kjo botë , pa i shkruar ato që lash pas.

Jeta ime po ndrit, te unë kanë hyrë tingujt e magjishëm që më lumturojnë .

Hatixhe Erebara

Autorë dibranë në Panairin e Librit





Rruga e Arbërit nr. 126

Arif Hasanaj shpallet "Qytetar Nderi i Dibrës".

Dibra **nderon doktorin** duarartë

Nga **DEFRIM METHASANI**

Arif Hasanaj "Qytetar Nderi i Dibrës"! Emocionet që përjetuan atë mesditë tetori të pranishmit e shumtë në Pallatin e Kulturës Peshkopi, vërtet ishin të rralla. Respekti i një pune afro 50-të vjeçare bëri bashkë stafin e spitalit të Peshkopisë, mjekët e ardhur nga Durrësi e Tirana, banorët e fshatit të tij të Trebishtit, por edhe qytetarë të Peshkopisë, Bulqizeës e Tiranës dhe miq e familjarë.

Prej muajsh, doktori shumë i njohur nga dibranët, Arif Hasanaj, kish merituar titullin më të lartë "Qytetar Nderi i Dibrës", por ceremonia u rezervua një ditë të bukur të muajit tetor.

Fillimisht, në skenën prestigjioze të atij pallati po të tillë, në qytetin e Peshkopisë, u shfaq dokumentari televiziv "Duararti", një dokumentar që zbulonte jetën, arritjet dhe sukseset e një mjeku kirurg, që krahas mjeshtërisë profesionale dhe jetëve të shpëtuara, kishte edhe një art tjetër, atë të komunikimit. Me kamerën e Agron Hotit, zbuloheshin detaje të një jete plot sfida, si në sallën e operacionit, ashtu edhe në jetën e përditshme.

Doktor Arif Hasanaj ishte kthyer në një simbol popullor, që pas studimeve të shkollës së mjekësisë, duke qenë një shërbëtor i zellshëm, sa në Trebishtin e tij, ku lindi në vitin 1947, aq edhe në Bulqizë e Peshkopi, ku punoi deri në vitin 2008, por po aq edhe në Durrës, qytetin që zgjodhi të jetojë tashmë e të punojë me kolegë po aq të nderuar. Më tej folën e përshëndetën dhjetëra personalitete, miq, kolegë e dashamirës, por që dukeshin pak, përpos dëshirës që të dukej se e gjithë salla, kërkonte të ngjitej në skenë.

Gjithsesi, përzgjedhja e vështirë e emrave, ka ftuar në skenë drejtorin e spitalit të Peshkopisë, Beqir Biçi, kirurgun Gazmend Bordulla, mësuesin nga Trebishti, Adem Abdia, Dr Nazmi Koçi, stomatologu i njohur që dikur drejtonte shëndetësinë në rrethin e Dibrës, Dr. Dhimtraq Gjergo dhe Dr. Jena Milloshi nga Durrësi, artistja e madhe durrsake e humorit Aishe Starja, njëherësh bashkëshorte e drejtorit të parë të spitalit të Peshkopisë, dibranit Fehmi Agolli, kryetari i qarkut Dibër, Hajri Laçi, si dhe mjaft personazhe të tjerë që shpalosën fjalët e zemrës dhe vlerësimet e pafund për këtë njeri. Përkushtimi, profesionalizmi, por edhe humanizmi, ishin tri kolonat e një "monumenti të gjallë", që rivinte kokëlartë në atë qytet, ku ndau më shumë se 30 vite, konkretisht Arif Hasanaj.

Doktor Arif Hasanaj ishte kthyer në një simbol popullor, që pas studimeve të shkollës së mjekësisë, duke qenë një shërbëtor i zellshëm, sa në Trebishtin e tij, ku lindi në vitin 1947, aq edhe në Bulqizë e Peshkopi, ku punoi deri në vitin 2008, por po aq edhe në Durrës, qytetin që zgjodhi të jetojë tashmë e të punojë me kolegë po aq të nderuar.

Arif Hasanaj nuk ka qenë vetëm një doktor i mirë i spitalit të Peshkopisë, por ai ka luajtur edhe një rol të rëndësishëm si veprimtar aktiv i shoqërisë.

Ka qenë disa herë anëtar i Këshillit Bashkiak, deputet i Kuvendit të parë pluralist të Shqipërisë pas viteve 1990, si dhe për disa vite ka qenë drejtor i spitalit, shef i shërbimit të kirurgjisë, pedagog i Medikom në Peshkopi e Durrës, etj.

Në sallë ishin shumë kolegë të ardhur nga Durrësi, si mjekët Dhimtraq Gjergo, Roland Katroshi, Taulant Baku, Neritan Myterizi, Ilir Doda, Fitim Shini, Shaban Dedei, Mehmet Miha, Jena Milloshi, Donika Manjani, Xhuljana Ngota, ndërsa nga Tirana kishin ardhur Dr. Nazmi Koçi, Selami Nazifi, por edhe dy mjekë me duart e arta, Rezart Deveja dhe Shkëlqim Methasani, të cilit kohë më parë kishin shpëtuar jetën e doktor Arif Hasanajt, duke bërë një ndërhyrje të suksesshme në zemër në spitalin "Hygea". Ndërkaq që nuk munguan edhe miqtë e tij të shumtë dhe bashkëkohësit, si Jonuz Kasa, pronari i shkollës jopublike "Kasa" në Durrës, Hasan Shahinaj, kryeredaktori i gazetës "Zëri i Gollobordës", Gjetan Nura, kryetar i shoqatës "Kuvendet e Gollobordës", por edhe personazhe interesantë të ardhur nga Trebishti, si Fitim Balla, administratori i komunës së Trebishtit, Ramush Seferi, "Hero i Punes" dhe djali i tij, prokurori i krimeve të rënda në Tiranë, Njazi Seferi.

Më pas, pos edhe shumë numrave artistikë të ansamblit Dibra, erdhi finalja e madhe e një dite dedikuar doktorit, ceremonia e dekorimit me titullin e lartë "Qytetar Nderi". Nënkryetari i bashkisë Sali Tërshalla, kryetarja e këshillit bashkiak Lulzime Dani, si dhe sekretarja e përgjithshme e prefekturës Donika Hyseni, ishin autoritetet vendore që nderuan në skenë, ndërsa i është dorëzuar edhe titulli i lartë, që u propozua prej anëtarit të këshillit bashkiak Astrit Ademi dhe më pas u votua unanimisht nga i gjithë Këshilli Bashkiak i Dibrës.

Pas fjalëve të tyre shumë domethënëse, vjen momenti shumë emocional, kur në duart e mjekut duarartë nuk ka bisturi apo pajise mjekësore, por dekoratën artë të titullit më të lartë. Më pas, tejet i emocionuar dhe i përlotur, "Qytetari i Nderit i Dibrës" i saposhpallur Arif Hasanaj, me lot në sy dhe emocione pozitive brenda shpirtit, ka pohuar se ky moment ishte më i bukuri në jetën e tij. "Pasi më shpëtoi jeta nga operacioni në zemër, kjo është jeta tjetër e imja dhe do të mundohem që t'ia shpërblej sërish Dibrës dhe dibranëve kudo që ata jetojnë".

Fotot e përbashkëta dhe urimet e pafund kanë mbyllur një ditë të tillë promovuese, vlerësuese, por edhe festive në qytetin e Peshkopisë, ditë kjo që la shumë mbresa jo vetëm te protagonist kryesor, por edhe te qindra të pranishëm, të cilët respektuan njeriun e duhur dhe të mirë Arif Hasanaj... tashmë edhe zyrtarisht i nderuar me titullin më të lartë: "Qytetar Nderi i Dibrës"!

"Pasi më shpëtoi jeta nga operacioni në zemër, kjo është jeta tjetër e imja dhe do të mundohem që t'ia shpërblej sërish Dibrës dhe dibranëve kudo që ata jetojnë".

Arif Hasanaj nuk ka qenë vetëm një doktor i mirë i spitalit të Peshkopisë, por ai ka luajtur edhe një rol të rëndësishëm si veprimtar aktiv i shoqërisë. Ka qenë disa herë anëtar i Këshillit Bashkiak, deputet i Kuvendit të parë pluralist të Shqipërisë pas viteve 1990, si dhe për disa vite ka qenë drejtor i spitalit, shef i shërbimit të kirurgjisë, pedagog i Medikom në Peshkopi e Durrës, etj.

Panairi i librit 2016

"Historia e Dibrës" nuk është një histori pushke, por histori e mendjes

Kam shkruar jo Dibrën që kam njohur unë, por Dibrën që më përcjellin dokumentet e historisë.

Unë e mendoj historinë e Dibrës jo si një histori pushke, luftëtarësh, siç e kanë qejf shumë malësorët e Dibrës kur flasin e tregojnë trimëritë. Unë dua bashkë me trimëritë, bashkë me gishtin - si i thonë pushkës, - kam dashur të shoqëroj dhe mendjen.

Se Dibra ka pas edhe njerëz të mendimit. Ka dhe një prodhim që është prodhimi intelektual popullor, edhe prodhim intelektual që quhet refleksiv shkencor.

Por Dibra në tërësinë e saj ka një pasuri të madhe aspektesh të jetës shoqërore, të jetës familjare edhe të jetës krahinore. Këtë kam dashur të përshkruaj në këtë libër, nuk e di sa ia kam arritur."

"Vështirësia për shkrimin e këtij libri kanë qenë kolosale, sepse Dibra përveç këtyre meritave të mira, ka dhe një dobësi: dibranët nuk e kanë pasqyruar në shkrime historinë e tyre nëpërmjet dokumenteve. Për dibranët dokument ka qenë fjala e dhënë. Nuk janë si ato popujt evropianë, që nga frika se mos shkelet fjala, bëjnë kontrata e shkruajnë marrëveshje.

Dibranët lidhen me besë, japin fjalën, s'kanë nevojë të firmosnin. Bënin traktate me njëri-tjetrin nuk kishin nevojë t'i shkruanin, sepse ishin të dy palët dibranë të bindur dhe të vendosur ta respektonin. Por kjo për historianin është një fatkeqësi. Sa krenari është për dibranin, aq fatkeqësi është për historianët". (Shkëputur nga intervista me autorin, nëntor 2012.)

Kristo Frashëri
Historia e Dibrës
Botimet M&B
ISBN:978-99956-04-82-0
620 faqe
Çmimi : 1500 lekë

Dibra në tërësinë e saj ka një pasuri të madhe aspektesh të jetës shoqërore, të jetës familjare edhe të jetës krahinore.

Jetë në veprat e mëdha

Libri është shkruar me një ndershmëri që e përjashton përshtatjen me kohën, cilado qoftë ajo: e shkuara apo e sotmja.

Ky libër nuk ka për qëllim t'i bëjë gjyqin një kohe, as të ngrejë përmendoren e një tjetre. Qëllimi i tij është të tregojë se autori ka ditur të jetojë, dhe kjo është dëshmia më e rëndësishme që ai dëshiron t'u bëjë të njohur brezave.

Me vërtetësinë që është shkruar, pa iu trembur pranimit të varfërisë e prapambetjes, libri i Shaban Bitrit të fton me zë të lartë: Besoëni!

Nuk gjeta asgjë patriarkale në përmbajtjen e këtij libri, ndonëse fisi dhe uniteti i tij janë gjithkund.

Libri ka një paqe të brendshme që vjen nga urtësia, një tejpashmëri qelqore që vjen nga gjeni i të parëve, një pasuri informacioni që vjen nga pasuria e jetës.

Një prej pasurive të shkëlqimta të këtij libri është Afroviti, e pandarë prej jetës së autorit në të mirë e në të keq, në prani e në mungesë, në lartësim e në rrënim, në fashitje e në ringritje. Midis shumë veprash të mëdha, me të cilat lidhet jeta e inxhinier Shaban Bitrit, pa dyshim, në mos më e madhja, do të mbetet kjo martesë dashurie, jashtë kodit etnojuridik verior po aq sa dhe jashtë traditës bregdetase. Nëse sot nuk jemi në gjendje ta ndajmë këtë meritë midis dy individëve dhe kohës, kjo tregon se autori ka të drejtë kur sillet miqësisht me të, sepse ajo kohë është pjesë e jetës së tyre.

Libër i një njeriu që ka jetuar dhe i një autori të ditur: meriton lexim dashamirës.

Shaban Sinani

Shaban Bitri ishte një djalë punëtor, i ndërgjegjshëm, serioz në punë. Ai e kishte me pasion punën e inxhinierit, e donte profesionin e tij dhe kjo është arsyeja që ngrihej vazhdimisht nga ana profesionale.

Ismail Ahmeti

Shabani ishte kryeinxhinier i kantierit të prodhimit. I papërtuar, me iniciativë...

Ing. SHABAN BITRI
Jetë në veprat e mëdha
Botimet M&B
ISBN: 978-9928-172-55-6
232 faqe
Çmimi: 800 lekë

Vlerësoj në mënyrë të veçantë punën që ka bërë për prodhimin e disa betoneve me karakteristika të veçanta, që ishte një punë e mirëfilltë shkencore, duke ndikuar fuqimisht në zgjidhjen e disa probleme teknike që na dolën te tunelet e devijimit.

Kujtim Bejtaj

Si Shaban Bitri është vështirë të gjesh inxhinierë. Është një ndër më të mirët në fushën e inxhinierisë së ndërtimit. Për ing. Shaban Bitrin mund të them me bindje të plotë se është njëri nga talentet e inxhinierisë shqiptare. Dhe këto talente, që janë të paktë, shteti shqiptar duhet të gjejë mundësinë t'i vlerësojë e t'i respektojë.

Faruk Kaba

Musai - Portret i njeriut fisnik

Siell e flamur sjell fjala e Musait në qenien time. Energji dashurie e impulse krijuese zgjohen te dibrani, kur i bie numrit të celularit të ish "profesorit" në shkollën e mesme pedagogjike.

Musa Riçku e çliroi shpirtin duke e tjerrë zgjuarsinë me fjalët e botës së dijes që mblodhi nga gjuha e mësuar e shkollës, në odat e kullave dibrane dhe nga valët e fjalës së Drinit, duke i shijuar këto valë nga shpirti i lirisë.

Lutfi Hanku

... "Pasuria dhe fëmija janë bukuria e kësaj jete." Musai është një person që pasurinë e gëzon me të tjerët, kurse fëmijët e Musait, me ndershmërinë që kanë ndaj prindërve, e stimulojnë edhe më shumë aktivitetin e Musait. Për mendimin tim në asnjë vend ku jetojnë shqiptarët, Musa Riçku nuk është jabanxhi, por është vendas dhe njeri i shtëpisë.

Ruzhdi Lata, Myfti i Dibrës së Madhe

... Të tjerë përpiqen të ndërtojnë vila e hotele, ndërsa Musai nuk le jashtë vëmendjes dhe investon për të përjetësuar të kaluarën e lavdishme dhe për të ndërtuar një të ardhme të sigurt. Të gjitha këto investime në ndërtimin e xhamive, libra për shkollën, veshje e ushqim për njerëzit në nevojë e bëjnë Musa Riçkun një ambasador të Limjanit, të Dibrës e më gjerë, me të cilin krenohemi të gjithë.

Haxhi Ahmet Çaushi

... Familjar i mirë, miku i vërtetë, shoku i papërtuar, qytetari i ndërgjegjësuar, dibrani me zemër të madhe janë pak nga tiparet që unë mund të përmend për Musain. Është fat, themi ne shpesh, të kesh një familje të mirë. Por është dhe zotësi. Unë besoj se Musai ia ka dalë, me ndihmën e bashkëshortes, të ngrejë një familje që reflekton të gjitha vlerat e tij. E kjo është jo vetëm fat.

Prof. dr. Edlira Haxhiymeri

... Ky libër i ofron lexuesit një nga modelet e heroit të shoqërisë së sotme, duke dhënë portretin e një biznesmeni, që formësohet



SHAQIR SKARRA
Musai - Portret i njeriut fisnik
Botimet M&B
ISBN: 978-9928-172-68-6
324 faqe
Çmimi: 1000 lekë

pak e nga pak, në vitet e vështira të tranzicionit, portretin e suksesshëm njerëzor të Musa Riçkut, të arritur me djersën e ballit dhe mençurinë karakteristike të njeriut punëtor. Historia e tij përbën simbolikisht edhe një histori përfaqësuese të një klase njerëzish të suksesshëm, të cilët janë shpirti i ndershëm dhe korniza e kulluar morale e Shqipërisë në këto 25 vite lirie të trazuar. Ne e ndjejmë, e prekim nga afër, dhe na mbush me krenari e mirënjohje fakti, që ka, kanë ndodhur edhe histori të suksesshme me origjinë të pastër e të ndershme, prej punës këmbëngulëse. Kjo i jep vlerë e moral shoqërisë sonë dhe përbën zemrën e sinqeritetit për arritjet e merituara.

Agron Tufa

Rruga e Arbërit nr. 126

Më 22 tetor, në mjediset e restorant "Nëna Mbretëreshë" u prezantua libri poetik i Ahmet Prençit, "Udhë në pasqyrë"

"Udhë në pasqyrë", poezitë që kanë "zbutur" Ahmet Prençin

Më 22 tetor, në mjediset e restorant "Nëna Mbretëreshë" u prezantua libri poetik i Ahmet Prençit, "Udhë në pasqyrë", botuar nga Botimet M&B.

Për shumë nga pjesëmarrësit ky botim ishte surprizë, pasi duke e njohur Ahmetin të veshur me detyra të rëndësishme në organet ligjzbatuese, nuk u kishte shkuar kurrë mendja se ai shkruan poezi.

"Ahmet Prençi vjen me këtë vëllim poetik me një lloj traditë qe ka letërsia shqipe, tha shkrimtari Besnik Mustafaj, dhe këtu kam parasysh poetin Naim Frashërin, i cili ka qenë një nga kryeçensorët e perandorisë otomane. Prençi vjen në traditën e një poezie ku "Uni" dhe "Neja" është një. Pasqyra është subjektiviteti i tij, dhe kjo është e rëndësishme për ta bërë poet".

"Ky botim është një surprizë e bukur jo vetëm për ata që e njohin nga larg autorin, por edhe për miqtë e tij, ndër të cilët e rendis veten" shkruan shkrimtari Besnik Mustafaj në recensën e librit.

"Të gjithë, pra, do të zbulojmë me këtë rast një personalitet tjetër të Ahmet Prençit, të cilin ai jo se na e kishte mbajtur fshehtë, por nuk kishte synuar kurrë ta nxirrte në pah."

"Unë e kisha njohur prej shumë vitesh si një lexues të pasionuar, shkruan Mustafaj, gjë që, siç e shihja, kishte ndikimin e vet mbi qasjen e tij ndaj njeriut, natyrës, politikës, historisë. Por nuk do e kisha marrë dot me mend se ai kishte gjithashtu aftësi t'i shprehte me poezi marrëdhëniet e tij të brendshme me botën që e rrethonte. Tashmë nuk do të ketë vend të shprehim atë habinë, qoftë kjo edhe një habi e bukur, pse ai na është shfaqur gjithmonë si një prokuror ndryshe, një kryepolic ndryshe, një inspektor i kontrollit të pasurive të zyrtarëve të lartë ndryshe".

"Ahmet Prençin e ka "zbutur" dhe vazhdon ta "zbusë" e ta përsosë poeti që ka nën lëkurën e vet' shkruan në rencensën e tij shkrimtari Mustafaj.

"Poezia e Ahmet Prençit ka ndikuar shumë në fillimet e mia letrare, shkruan Agron Tufa. Një cikël poetik i Prençit, i botuar në gazetën lokale të Dibrës në fund të viteve '80, më pati lënë mbresa të thella. Vargje të çlirëta, me muzikalitet spontan, që rridhnin natyrshëm, me shpengimin karakteristik të frymëzimit origjinal, ato kishin ajrin e lirë të bjeshkëve dhe peizazheve të vendlindjes. Metaforat e freskëta që i hapnin udhë përfytyrimit dhe ndjenjës pa dhunën pedante dhe pa shtampat e klishetë me të cilat shtërzonte poezia e atyre viteve.

Më vjen mirë e më gëzon fakti, që këto cilësi artistike janë konservuar të padëmtuara ndër vite dhe përbëjnë tharmin e poezisë së tij në këtë vëllim. Është shumë e vështirë të shkruash këtë lloj poezie sot, në epokën e spekulimeve dhe modave jetëshkurtra. Ta nxjerrësh thellë prej vetes këtë thelb të padhunë të poezisë së pastër, plot luhatje, kadenca e ritme, është t'i mbetesh besnik konceptit të artit si mahni, emocion e meditim njëherësh. Të shkruash si sakrificë, sikur "shkep mish" prej vetes, të shkruash nga "shapi i shpirtit" tënd".

Prezantimi i librit u drejtua nga aktori i njohur Bujar Asqeriu. Disa nga poezitë e Ahmetit u recituan plot ndjenjë prej tij dhe aktorit tjetër Xhevahir Zenelit.

Për Prençin poet foli edhe Besnik Bakiu, poeti Agim Doçi, miq dhe bashkëpunëtorë të tij.

Në fund, autori falënderoi shkrimtarët Besnik Musafajn, Islam Çengën dhe Arben Çejkun për nxitjen që i dhanë që këto poezi të shkruara në vite t'i botonte në një vëllim poetik, si dhe piktorin Zaim Elezi për realizimin e kopertinës.

RRETH AUTORIT:

Ahmet Prençi u lind më 25 prill 1968 në Dibër. U diplomua në Fakultetin e Ekonomisë dhe Drejtësisë në Universitetin e Tiranës. Ka punuar dhe punon në institucionet ligjzbatuese të shtetit shqiptar.

Poezitë e para i ka botuar në vitin 1985 në disa gazeta të kohës.

Ky është vëllimi i parë poetik.

Mënyra si e përcepton poeti realitetin jetësor, si e përjeton e reflekton dhe si e formëson si realitet poetik, nëpërmjet një sistemit metaforik krejt origjinal dhe të freskët, - është unike.

Në shtresat dhe nënshtresat e tekstit poetik zbulova më mirë kuptimësitë e metaforave, të simboleve e mjeteve të tjera figurative dhe cilësinë e shprehjes poetike, me gjuhë të pastër e stil poetik ku Ahmeti është Ahmet si poet dhe qytetar me integritet.

Poeti që vjen **me zërin** e tij në pallatin **e poetëve**

Nga **MEXHIT PRENÇI**

Me librin poetik "Udhë në pasqyrë" Ahmet Prençi vjen pa trokitur në portën e pallatit të poetëve, me një poezi të freskët dhe origjinale, në qendër të së cilës është njeriu, vendlindja, natyra dhe fenomenet e saj. Vjen si bir i Reçit, i Dibrës dhe Shqipërisë, vjen me aromën e fushës dhe të malit, të tokës dhe qiellit, të udhës së shkelur e të pashkelur.

Mënyra si e përcepton poeti realitetin jetësor, si e përjeton e reflekton dhe si e formëson si realitet poetik, nëpërmjet një sistemit metaforik krejt origjinal dhe të freskët, - është unike.

Një qasje e tillë e krijimit të poezisë sipas Prençit e bën atë të jetë vetëvetja poetike.

Nga poezia "Dhe vitet ikin", citoj: " Në sytë e mi rrathët e moshës / disi mavi, tkurrur nga vitet; / kërrusur nga halli, puna e stresi / si valët e lumit që brigjeve priten.../ S'jam trung i prerë nyje në brinjë, / as lis i djegur nga rrufeja ne vjeshtë. / Jam në udhë-hije udhëtarësh / dhe strall i gjallë i mbirë në kreshë. / Midis dy shpateve në llërë burimesh / aty ku ylberi kapërcen ylberin, / Sytë e mi me rrathët e moshës, / lidhur si kulmi me themelin".

Kjo kredo poetike e tij është shfaqur që në fund të viteve 1980, në disa tufa poezish, botuar në gazetën lokale "Ushtima e Maleve" e Dibrës, që i kishin lënë mbresa te thella poetit Agron Tufa i cili shkruan: "Poezia e Ahmet Prençit ka ndikuar shumë në fillimet e mia letrare: "Vargje të çiltra me muzikalitet spontan, që rridhnin natyrshëm me frymëzim origjinal; ato kishin ajrin e lirë të bjeshkëve dhe peizazheve të vendlindjes.

Metaforat e freskëta i hapin udhë përfytyrimit dhe ndjenjës, pa dhunën pedante dhe shtampat e klishetë me të cilat shtërzonte poezia e atyre viteve. Më vjen mirë, e më gëzon fakti që këto cilësi artistike janë konservuar të pa dëmtuara në vite dhe përbëjnë tharmin e poezisë së tij në këtë vëllim", shkruan Tufa.

Poeti Ahmet Prençi, ndonëse në heshtje mbështjellë modestia e tij, ka shkruar poezi me tema e motive te ndryshme e të larmishme, do të thosha të virgjëra, të freskëta dhe me lëng jete; - gjatë këtyre dy dekadave,

AHMET PRENÇI
Udhë në pasqyrë
Poezi
Redaktor: Besnik Mustafaj

Botimet M&B
ISBN: 978-9928-172-85-3
Faqe: 160
Çmimi: 700 lekë

por i ndrojtur për t'i konsultuar me të tjerët, i pa sigurt për t'i botuar. Falë miqësisë me poetin Besnik Mustafajn, më në fund ka guxuar t'i jepte disa poezi në dorëshkrim që t'i lexonte... Këtu nis filli i mbledhjes, përzgjedhjes dhe redaktimit të poezive të librit "Udhë në pasqyrë" të Prençit.

As mua nuk m'i kishte dhënë t'i lexoja poezitë e tij. Kur më telefonoi në një ditë me diell të këtij tetori, se kishte botuar një libër me poezi, qe e papritur për mua dhe një befasi. Por kur lexova poezitë kjo ishte befasi e këndshme. Që në leximin e parë mora kënaqësi estetike; në të dytin mora më shumë sepse në shtresat dhe nënshtresat e tekstit poetik zbulova më mirë kuptimësitë

Poeti Ahmet Prençi, ndonëse në heshtje mbështjellë modestia e tij, ka shkruar poezi me tema e motive te ndryshme e të larmishme, do të thosha të virgjëra, të freskëta dhe me lëng jete...

e metaforave, të simboleve e mjeteve të tjera figurative dhe cilësinë e shprehjes poetike, me gjuhë të pastër e stil poetik ku Ahmeti është Ahmet si poet dhe qytetar me integritet.

Nga mënyra origjinale si e formëson poezinë sipas un-it krijues të spikatur, më jep argumentin ta konsideroj personalitet poetik. Këtë e ka shprehur edhe poeti Besnik Mustafai. Citoj: "Unë e kisha njohur prej shumë vitesh si lexues të pasionuar Ahmetin, gjë që, siç e shihja, kishte ndikimin e vet mbi qasjen e tij ndaj njeriut. natyrës, politikës, historisë. Tashmë nuk do të ketë vend të shprehim habinë, qoftë kjo edhe një habi e bukur, sepse ai na është shfaqur edhe si një prokuror ndryshe, hetues ndryshe dhe kryepolic ndryshe ... Ahmet Pençin e ka "zbutur" dhe vazhdon ta "zbusë" e ta përsosë poezia që ka brenda vetes"

Është një vlerë e shtuar për çdo poet, kur poezia bëhet pjesë e ndërgjegjes së tij si qytetar apo si funksionar në rrafshet e të katër pushteteve. Ndikimi i një poezie të tillë do të jetë efektiv në gjykimin racional të gjërave për të përsosur vetveten që njerëzorja, shpirtërorja, të sfidojë të kundërtat negative që bashkëjetojnë te çdo njeri, por sidomos te njerëzit e pa ngopur me pushtet dhe pasuri në kurriz të shumicës. Kumtet e një poezie të tillë janë të lexueshme te libri "Udhë në pasqyrë" të Ahmet Prençit, në raportet poet-qytetar- funksionar i drejtësisë, i cili është ndryshe nga të tjerët edhe për shkak të poezisë.

Do ta mbyll këtë fjalë të shkurtër sintetike duke i uruar poetit Ahmet Prençi të krijojë poezi të reja sipas kësaj qasje poetitke, ta kultivojë dhe përsos poezinë me rrënjët në vendlindje, e të ec udhëve të pashkelura në rrugëtimin e gjatë poetik, duke kënduar me zërin e tij. Kur e ke talentin asgjë nuk është e pamundshme.

poezi

Ahmet Prençi, “Udhë në pasqyrë” – Poezi

KULLA

Po shembet kulla në fshat
I ka rënë suvaja, hatullat, parvazet;
Muret mezi mbahen në erën e thatë
Siç mbahen me paterica sakatët…

E anuar kulla.
I dhëmbin ijet.
Kurrizi i dalë.
Reumatizma ia ka mpirë këmbët;
Me syze miopi anuar në një anë,
Si nallane i kërcasin dhëmbët.

Qindra vjet do të rronte kulla
Ndërtuar me gurë e gëlqere safi;
E shkretë vatra e udha pa njerëz
Vdes dhe Planeti po s’pati njeri!

MIGJENI MË SFIDOI MBRËMË

Migjeni më sfidoi mbrëmë…
Se si e nisëm bisedën nuk e kujtoj,
Në inbox më shkroi ai i pari,
Iu përgjigja me mburrje njëfarësoj.

Njëfarësoj për të qenë pak modest,
Për kohët moderne në delir dhe mall,
Ai ikte, Ai zbriste, Ai ngjitej e habiste
Me “Kanga e dhimbës krenare” si hamall.

“Lulin e vocërr” në rrugë e gjen më tha,
Dhe “Moll e ndalueme” farmak në gojë!
Një kokërr misër shkela mbrëmë
                    në ëndërr,
T’ shitoftë Zana! Lanet, njëfarësoj!

E trishtueshme nata, i mpirë Migjeni,
E kolla e thatë si gjarpri në lojë…
A don qymyr zotni, e ndrojtur malësorja,
A don qymyr… nderin - njëfarësoj.

Nuk munda Migjenin. Koha ime
                    më mundi,
U trishtova dhe heshta krejt në vaj,
Kollitej stërdhëmbësh tuberkulozi,
Dhe rrudhat e vuajtjes pa formë e pa skaj.

Kapërceva pragun, në zhgjëndërr,
                    në ëndërr,
Një shkreptimë apo krismë më zgjoi,
Siluetë e Migjenit largohej në ag,
Në ag, në udhën e qiellit njëfarësoj.

Me Migjenin isha. Me Migjenin jam,
Smartphone-in s’e kisha ndër sy aspak,
Kur do soset e tretet kjo natë,
Të zgjohem nga ky makth e të iki larg!

ADOLESHENCË

Nën sqetullën e rrugicës
Si foleja e qyqes,
Strukur nga syri i botës
Në lagunë të gjoksit.

Ti me fustan basme
Me sy të mëndafshta,
Më fshihesh me gjasme
Si bora ndër rrasa.

Gjithçka m’u mjergullua
M’u nda mish e thua,
Në lugun mes gjinjve
Si bora më shkrive!

Mendja seç më iku
Më iku, më fiku!

RIMA NË DIMËR

Rimë, vargje po shkund nata
Porsi gjethet nëpër vjeshtë,
Dhe pak fat në jetë u dashka
Dhe në shteg një dor’ e lehtë.

Kur në lukth të zë pikëllimi
Ngërçi, bryma gishtat mpin,
Ngrirë mëllenja nga thëllimi
Mekur, ndrydhur shpirti im.

Zbresin ujqërit në turm’ kope
Nëpër borë, në udhë pa udhë;
Ngrin nga frika dhia plle,
Sytë bën katër delja rudë.

Atëherë kur një krism’ arme
E shpon natën tej për tej,
Si një mbret gërhet ky dimër
Putra, gjurmë gjithandej.

S’ka si dimri kur ke zjarrin,
Bardhësi pa fund e anë;
S’ka si jeta kur ngroh mallin,
S’ka si mikja që ke pranë.

STRES

Pikon i gjelbërt si loti i pjergullës
shpirtin ma gërryen si acari në mars,
E lëmuar pasqyra e syve të mi,
Brenda,
Përroi i stresit më gërryn gjithë maraz...

NË VEND TË BALADËS

Lart në mal ku syri tretet
Krejt i largët, krejt i turbullt,
Cjap i egër turfullon
Dhi e egër seç ka humbur.

Se janë dashur në çdo stinë
Puthur, ndukur, përqafuar;
Sa herë cjapi dredh mustakun,
Dhia pranë e përmalluar!

E janë puthur, trashëguar
Nëpër shkrepa, në çdo stinë;
Cjap i egër thyen shkrepa
Se ka humbur grua-dhinë.

E lëshon piskamë e lot
Sa orteqet shkundin malet;
Cjapi egër përpjek brirët
E me thundra po çjerr faqet.

Se ka humbur grua-dhinë
E kërkon, rrëmon ngado;
Ka humb shtëpinë, katandinë
Perëndeshën, si ajo!

PËRROI I VENDLINDJES

Si një ninullë për kullën time
Një grusht uji je në verë,
Kur në vjeshtë mblidhen prodhimet,
Rritesh ti me shi dhe erë.

Ti që sjell motive malli
Kryet vë në gjoksin tim
Dhe dëgjoj tik-takun tënd,
Si një mall e mërmërimë.

E sa herë që bie mbrëmja
Si mëndafshi ndër lajthi,
Pranë dritares luan syrin
Si kodoshi, sevdalli.

Ç’ka se vend nuk bën në hartë
Dhe në Drin derdhesh modest,
Rrjedh në “hartën” e syve t’mi
Jetë e dritë bëhesh në Fierzë.

LLAMBA E VAJGURIT

Në polisën e oxhakut llamba e vajgurit
Me shkrepësen ngjitur, tymi e flaka,
Sa herë suferina fryn e fik dritat
Si magjistare ndez llambën, më plaka.

Aladini ndrit në heshtje natën e errët
Të fryjë suferina, bora të ngrijë pragun,
Ajo llambë magjike që nëna fshin ngahera
Yll i rënë nga qielli në qoshen e oxhakut.

Ne ikëm në qytet. Mbyllëm shpi e katandi
Llambat e vajgurit s’janë për qytetet!
Por nëna e mori, e ruajti të shtrenjtë
Aty pranë dritares, aq pranë me shkrepësen.
E lan e pastron me shumë dashuri
Për të mbajtur ndezur mallin në gji…

PYLLI ME PISHA

- Në kujtim të babait -

Pylli me pisha të moçme
Si xhaketa e babait varur në gozhdën e kreshtës,
Nëna ia ka kthyer dikur jakën,
Jakën e rrjepur nga kripa e djersës.

Pishat e moçme me jakën e kthyer
Nga e gjelbërta në jeshile,
Aty xhaketa e babait
Ka mote që bën hije!

Pylli me pisha të moçme
Anuar nga era e luginës si kërrabë,
Rrudhosur si xhaketa e babait
Në acar dhe në vapë.

Rralluar pylli me pishat e moçme;
Rrudhur e rrjepur si xhaketa e babait
Pa portofol, pa xhepa e pa kopsa…

LULE LISNE

Lule lisne mbledhim në verë
Për groshët në dimër t’i thajë nëna,
Odat të mbushen me aromë,
Me erën dehëse jashtë edhe brenda.

Për rrënojat nuk jam arkeolog
As në livadhe një bujk për plisa,
Unë thjesht po mbledh nektarin
Me nektarë në mollëzat me lisna.

Pas meje le të vijë si të dojë dimri
Me erë, me borë, lloh e furtunë,
Lisnën e mbledh që në ditë-verë,
Ditë-verën çoj në shtëpi për gunë.

E nëna ime e urtë dhe e mirë
Me lisnën bën edhe ndere,
Për xhajen e hallat në qytet
Pak lisna mbështjellë si ditë vere.

MBRËMJA NË FSHAT

Para se të perëndojë dielli
Njerëzia shpejton të sosë punët e ditës:
Zogjtë për gjumë shtrojnë dyshekët me pupla;
Kuajt shkundin pluhurin çokollatë të udhës;
Lopët mbushin grushtet me qumësht;
Nëna për vaktin e darkës kripos groshët;
Motra fsheh nën qepallë të parën puthje;
Shelgjet në buzë lumi varen si gërsheta;
Bleta në koshere me lloz mbyll deriçka;
Pulat flenë si pulat;
Merimangat, si merimanga struken
                    në skuta,
Mushkat flenë në këmbë si mushkat;
Derën e avllisë së fundmi e mbyll babai…

Kur hëna-klloçkë të mbledhë zogjtë-yje
Niset për në qiell ëndrra ime…

KËNGA E DRINIT

Kënga e Drinit pranë kullës time
Tund perdet prej basme,
Gu-gu-të e guguçeve,
Thurin ojna dasme.

Kënga e Drinit,
Në krahë dallëndyshesh
Si ninulla në djep,
E,
Kushedi sa kohë,
E,
Kushedi sa vjet…

Kënga e Drinit
Çel lulet e mollës
Në trung e në degë,
Shkrin akullin e borës
Në pllajë e në shkrep,
E,
Kushedi sa kohë,
E,
Kushedi sa vjet!

Kënga e Drinit piskamë e dhimbje
Në Dardh e në Reç!
E,
Kushedi sa kohë,
E,
Kushedi sa vjet…

NËNA

S’ka më të bukur se ti,
Me sy të mëdhenj - një pash qiell
E prehrin me nektar perëndish;

S’ka më fisnike se ti,
Me zemrën e dhembshur për një zog të trembur
E me kurmin - Zanë bjeshke.

S’ka më të shtrenjtë se ti,
Që mbushe fletën time të bardhë
Me dashurinë e sakrificën bashkë;

S’ka më punëtore se nëna ime,
Qelibare, e urtë, ëmbëlsi në ëndërr
Që më bekoi ende pa u ngjizur;
Nëna ime, Hirushja në zhgjëndërr!

KORABI

Jam zgjuar që në lindje me Korabin në sy,
Me Udhën e Diellit - që pa gdhirë jam zgjuar,
Lind dita me Korabin e diellin përkarshi
Ngryset nata mbi Kurorë - përmalluar.
E njoh më së miri me gjysh e katragjysh,
Sy më sy i hapim kanatat,
Me nurin e ditës i ndrisin siluetat,
Në muzg të perëndimit me të kuq përflaket.

Korab! Përtej reve, përtej qiellit,
Përtej ëndrrës, përtej zhgjëndrrës,
Lahet me sirenat e Egjeut
Krihet nëpër erërat e mëllenjës.

Perënditë në Olimp i kanë shtëpitë
Në Korab bëmat, intrigat, dashuritë…

Rruga e Arbërit nr. 126

Mendime rreth librit më të ri
të shkrimtarit e publiçistit Osman Xhili

“Margaritari i kurorës”, dritë e shpirtit dhe e provave të besimit

Nga **MEVLUD BUCI**

Çdo libër i ri, ngjan me blerimin, me beharin, me mineralin e çmuar të thellësive. Tek libri, çdo lexues, zbulon vlera, dritë shpirti e zemre, gdhend në mendje bukuri jete, universi e besimi. Kështu të ndodh dhe me librin e pestë monografiko – publiçistik, “ Margaritari i kurorës “, të të palodhurit e fisnikut të besimit, Osman Xhili të Dibrës. Është sa i thjeshtë e domethënës, aq tërheqës e mbresëlënës, i shkruar me realizëm, dashuri e sinqeritet.

Ky libër, qysh në titull, shpërfaq kuptim të thellë metaforik, ku nëpërmjet gjurmëve e veprave të individit, del në pah jeta, tradita, besimi, shpirtmadhësia e mirësia njerëzore. Jeta është e shkurtër, e shenjtë, e çmuar, e ndritshme. Këtë kuptim na jep në plotësi, libri “ Margaritari i kurorës “, i të nderuarit Xhili.

Dy fjalë në togfjalëshin e titulluar me mjeshtëri, shpërfaqin vlera, mirësi, dritë, besim, dashamirësi, e mbi të gjitha, rrezatim hyjnor. Margaritari, është njeriu i thjeshtësisë, i urtësisë, i besimit,pa bujë e famë, por që mbart dritë hyjnore, ndërsa kurora është simboli i madhështisë, i provave të jetës e të mirësisë, të veprave të bamirësisë e humanizmit, në emër të Allahut, të jetës e të drejtësisë.

Libri “Margaritari i kurorës “, pa mëdyshje, është një vlerë e shtuar në letërsinë bashkëkohore, një testament, ku u bën thirrje brezave të besojnë, të duan, të vlerësojnë dritën e besimit, dritën e të vërtetës, dritën e urtësisë, për të merituar qënjen njeri. Në parathënje, mes të tjerash, me të drejtë, autori i shquar, Osman Xhili thekson : Gjykojmë, që libri është përtej një monografie të thjeshtë, pasi aty ka kapituj për ardhjen e kosovarëve, pajtimin e gjaqeve, për ndërtimin e xhamive, të huajt për islamin, e plot episode të tilla, që janë të gjitha të protokolluara e të dokumentuara,(faqe 6).

Ky libër, me të drejtë mund të quhet një arkiv, një thesar, një minimuzë për fenë dhe besimin, libër që dëshmon për shpirtbardhësinë, për vlerat dhe virtytet njerëzore, rritjen e njeriut të mirë e të përkushtuar, për dritën e besimit, vëllazërimin e gjurmët e jetës. Janë shkruar plot ndjenjë e korrektësi, materialet si “ Ardhja nga Dibra e Madhe “, “ Historia e Abas Zanit “, “ Vitet e para”,” Medreseja “, “Një jetë e re”, “ Shumbat “, e plot të tjera.

Në udhët e besimit e të diturisë, në mjedise urtësie e përkushtimi, me vështrimin tek e ardhmja, me Allahun në zemër, me shpirtin e dëlirë të bamirësisë, duke demostruar në jetë ajetet Kuranore. Kështu eci në jetë, heroi i këtij libri të çmuar e me plot vlera në llojin e vet. Koha dhe jeta, shoqëria dhe brezat, kanë nevojë për libra të tillë. Margaritari i kurorës është besimtari që rrezaton, dritësimi i vlerave, dritësimi i shpirtit njerëzor, dritësimi i jetës në bahçen e blertë të vëllazërimit, të humanizmit, të dashurisë dhe respektit.

Autori i librit, Osman Xhili, ka bërë një punë serioze, rrezatuese dhe korrekte, duke na dhënë detaje jetësore, të cilat na shpërfaqin madhështinë e thjeshtësisë, bukurinë dhe shenjtërinë e njeriut të besimit. Haxhi, Ahmet Çaushi, është një rrugëtim hyjnor drejt bardhësisë së kësaj jete dhe jetës tjetër, modeli i urtësisë dhe mirësisë. Pra, ai që jep prova besimi, korr fryte nderimi. Shoqëria, fisi, koha, miqësia, njerëzit e thjeshtë, që bartin madhështinë e mirësisë e të besimit, kanë nevojë të besojnë dhe të imitojnë, personazhe jetësorë e plot virtyte, si haxhi Ahmet Eqerem Çaushi i Dibrës.

Nga e vogla, lind e madhja. Nga e thjeshta, lind e madhërishmja, e bukura, hyjnorja. Në libër pasqyrohet qartazi familja, fëmijëria, shkollimi, puna në frontin e mësuesisë, shëmbëllimi fetar e hyjnor i haxhi Ahmetit. Shkrimtari dhe publiçisti, Xhili, është një vëzhgues i hollë, realist, human, e mbi të gjitha, një kronikan pendëdritë. Episodet, dialogjet, faktet, përshkrimet mjeshtërore e domethënëse, i mësojnë lexuesit se si duhet të jetë njeriu. I mësojnë se si rrezaton besimi, mirësia, e drejta, e vërteta, përkushtimi Kuranor, e mbi të gjitha, besimi ndaj Allahut të Madhnueshëm. Pas pasqyrimit të familjes, të babait, Eqerem Çaushi, me shërbim tregtar në Muhur e Blliçe, autori Xhili, na përshkruan thjeshtë e bukur, punën e haxhi Ahmet Çaushit, si mësues i parë në Shumbat. Udhëtime djerse, mirësie, diturie, përkushtimi e humanizmi, një devizë e vërtetë për njeriun e besimit.

Vërtet, haxhi Ahmeti, nisur nga modestia e thjeshtësia që e karakterizon, fillimisht nuk ka qenë dakort për botimin, por libri, nuk është një kult për një besimtar, por një monument mirësie e besimi, që buron nga libri i përsosur i Kuranit dhe suneti i Profetit, Muhamedit a. s. Provat e personazhit

Libri “Margaritari i kurorës “, pa mëdyshje, është një vlerë e shtuar në letërsinë bashkëkohore, një testament, ku u bën thirrje brezave të besojnë, të duan, të vlerësojnë dritën e besimit, dritën e të vërtetës, dritën e urtësisë, për të merituar qënjen njeri.

(heroit të librit), Ahmet Çaushit, janë qysh në fëmijëri, në medrese, si drejtor në Kastriot, si mësues me shpirt hyjnor në Shumbat, Qafë Murrë, apo kudo ku shtegëtoi, në fshatra e zona të tjera.

Tek libri “ Margaritari i kurorës “, autori Xhili, na jep me anonime se si shqipja fluturon me krah, se si i miri ka pranë të mirët, i nderon dhe nderohet prëej tyre. Në një paragraf të librit tregohet se si haxhi Ahmeti, që ishte vetëm në vitin e pestë të punës si mësues, refuzon ofertën e shefit të arësimit, Selim Alliu, për të drejtuar shkollën e Kastriotit. I thotë se është ende herët për mua, të drejtoj një shkollë të përmasave të tilla. Por shef Selimi ngulmon në të tijën. Ai kishte bindjen që Ahmeti do t’ja dilte me sukses. Nuk ishte hera e parë që punonte me medresistë. Ivzi Shehu, inspektor në seksionin e arsimit, Halim Shehu, drejtor shkolle në Sllovë, Adem Shehu, inspektor, Fehmi Xhepa, mësues i përkushtuar dhe plot të tjerë, kishin treguar qartë, përgatitjen profesionale, këmbënguljen dhe vendosmërinë e kësaj kategorie mësuesish (f 36).

Rrugëtimi i haxhi Ahmet Çaushit është një rrugëtim hyjnor, rrugëtim përmes sakrificave, dallgëve të jetës, sfidave të kohës. Kur rilexon librin “ Margaritari i kurorës “, të kujtohen vargjet epike mirditore, “ ...nuk kalb toka mineral ...”. Minerali këtu është besimtari i devotshëm që bën vetëm vepra të mira, duke rritur pozitën morale në shoqëri dhe me shpresën për të siguruar parajsën e vërtetë. Dilema jetë, prova mirësie, ecje drejt majave të diturisë, e mbi të gjitha të besimit, na shpërfaqen në kapitujt “ Telashet e fejesës “, “ Fillimi i punës “, “ Grevë 1968 “, “ Stacionet e fundit “, “Dita e verës “, “ Rreze drite “, “ Kursi i Katarrit “, etj. Në to pasqyrohet shembulli e veprat e njeriut, intelektualit virtuoz, të besimtarit me shpirt të dëlirë, hyjnor e me vepra mirësie në çdo hap që hedh.

Autori, Osman Xhili, gdhend saktë e qartë episode, detaje, fakte , dialogje të spikatura, shprehje frazeologjike, të cilat e madhështojnë figurën e myftiut të shquar të Dibrës, haxhi Ahmet Eqerem Çaushi. Lexuesi i thjeshtë, studiuesi, historiani, gjuhëtari, e mbi të gjithë besimtari, gjen tek ky libër monografiko – publiçistik, pse jo dhe studimor, modelin e njeriut me shpirt hyjnor, të drejtësisë, të diturisë e të thjeshtësisë. Në libër, zenë vend shokët, fisi, pedagogët e nderuar, bashkëqytetarët dhe njerëzit e thjeshtë. Janë gjurmëlënës, mes të tjerash, kapituj të tillë si “ Medreseja e Dibrës”, “ Marrja e detyrës “, Institucioni i besë “, “ Të huajt për islamin”, “ Në Komunitetin musliman “. Të gjitha këto shkrime dhe të tjera që përmendëm më parë, studime dhe informacione brilante për haxhi Ahmetin, përbëjnë një epope shenjtërie, përkushtimi e mirësie.

Ky libër, me 270 faqet që ka, bashkë me fotografitë me ngjyra, përbën një mesazh bashkëkohor, hyjnor, Kuranor, dhe thirrje për të vlerësuar besimin, jetën, drejtësinë. Libri “ Margaritari i kurorës “, është kurorë e mirësisë, simbol i nderimit, dritë e shpirtit dhe e provave të besimit. Urime dhe penda dritë, Osman Xhili i Maqëllarës, i Dibrës, i botës dhe jetës së shenjtëruar.

Botim i ri

ASTRIT GJUNKSHI
Botët brenda shpirtit
Poezi dhe poema
Botimet M&B
ISBN: 978-9928-172-92-1
Faqe: 202
Çmimi: 700 lekë

Poezitë e përfshira në librin *Botët brenda shpirtit* janë shkruar kryesisht gjatë këtij viti. Por motivet, fabulat, dhe idetë e një pjese të mirë të tyre kanë lindur përgjatë një periudhe prej më tepër se një dekadë. Madje, në disa raste, autori i ka të skicuara në dosjen e krijimtarisë në forma të tjera të shkrimit, si në skica tregimesh, thëniesh e mësimesh për jetën.

Duket se poezia, ashtu si piktura, nuk i shpëton mekanizmit krijues të kalimit nga skicat tek krijimi përfundimtar. Jo më kot, duke filluar nga Plutarku, filozofi i lashtësisë, poezia është quajtur si një pikturë që flet. Ndërkaq, mjaft poezi të tjera, nuk e patën të vështirë të dalin në dritë sepse idetë dhe ndjenjat që ata shtjellojnë janë thellë në vetëdijen, botëkuptimin, formimin dhe përvojën e autorit.

Një nga synimet kryesore të poezisë së Astrit Gjunkshit është që ato të sjellin kënaqësi. Dhe, natyrisht, kënaqësia e poezisë nuk vjen vetëm. Sipas Samuel Johnson, poezia është arti që bashkon kënaqësinë me të vërtetën, duke thërritur imagjinatën të ndihmojë arsyen. Prandaj, për ta sjellë poezinë si art, Gjunkshi është përpjekur që, në secilën prej tyre, të bashkojë të gjithë elementët e nevojshëm që duhen për këtë si kënaqësia, e vërteta, imagjinata dhe arsyeja.

Imagjinata dhe arsyeja janë bërë prej kohësh pjesë e jetës së Astrit Gjunkshit edhe për shkak të profesioneve dhe detyrave që ka kryer në jetë. Dihet se matematika, profesioni i tij i parë, ka në themel të saj imagjinatën dhe arsyetimin. Siç është shprehur Thomas Hill, matematika dhe poezia janë shprehje e të njëjtës fuqi të imagjinatës, veçse njëra i adresohet kokës dhe tjetra shpirtit. Ndërsa diplomacia, profesioni i tij i i dytë, që zë gjysmën e karrierës, duke qenë një art në vete, e ka ndihmuar të zgjeroj njohjen më të thellë të botës dhe të racës njerëzore, ashtu siç ka ndikuar në artikulimin e kujdesshëm të fjalës në komunikim dhe në krijimet e tij. Gjykimi i matur, analiza e gjithanëshme dhe sinteza e ideve, shtrimi dhe sistemimi i alternativave, elementet e mendimit krijues dhe pragmatizmi në zgjidhjen e problemeve, që janë të domosdoshme në diplomaci, veçanërisht në diplomacinë e mbrojtjes, por edhe në matematikë, janë mishëruar natyrshëm në këto poezi.

Tematika e poezive është ndikuar nga qëndrimi i autorit ndaj dukurive të jetës dhe atyre socialw- politike. Në poezitë e këtij vëllimi, përveç disa temave me karakter autobiografik apo temave të ndjenjave më të bukura njerëzore, vibrojnë ato pikëpamje dhe mesazhe që ka pasqyruar në libra të mëparshëm, që lidhen me interesat kombëtare, me sfidat e konsolidimit të demokracisë, forcimin e identitetit kombëtar, emancipimin e shoqërisë sonë, filozofinë e jetës, me moralin e shëndoshë, me tejkalimin e konflikteve, me kapërcimin e fenomeneve negative dhe me edukimin.

Kur njerëzit përgatisin jetëshkrimin, CV-në e tyre, paraqesin shumë gjëra që lidhen me identitetin e tyre. Poezia, kur synon dhe arrin të sjellë në mënyrë të sinqertë e krijuese të vërtetën dhe jetësoren, si dhe të shprehë mesazhe të mbushura me dëshirën dhe rrugët për ndryshim drejt së mirës, përbën në fakt një CV të tillë të plotë e të detajuar që nuk mund të paraqitet në asnjë CV zyrtare, sepse ajo përmban të padukshmen, përmban edhe Botët brenda shpirtit të autorit, ato botë me filozofinë dhe ndjenjat që ai kërkon t’i ndajë me të tjerët.

botime

Toponimia e Çidhnës *në një vështrim etnotekstor*

(Vijon nga faqja 9)

Haki Përnezha e Rruzhdi Bitri, autorë të librit Toponimia e Çidhnës, meritojnë nderimin e bashkëvendësve të tyre jo vetëm për faktin që i kanë dhënë krahinës një pasaportë të vërtetë të banorëve në trojet e tyre, qysh prej kohës së zotërimit të Kastriotëve, të aristokracisë së motit të madh, me kisha e shenjtorë, me kroje zojash e zotnish, me udhë të madhe tregtarësh e karvanarësh dhe ura druri për popullin; me fortesa kështjellarësh dhe sheshe të kavalerisë e të topave; me kopshte kuvendesh e me pyje kusarësh; me varosh e dogana.

Haki Përnezha dhe Rruzhdi Bitri kanë mundur ta përballojnë me denjësi këtë sfidë, duke ndihmuar dora-dorës bartësi studiuesin e studiuesi bartësin.

Lexuesi i zakonshëm nuk do të dallojë dot dhe një proces tjetër krejt të padukshëm të punës së dy autorëve. Ekziston një dallim cilësor kategorik midis fjalës së zakonshme quajtëse të gjuhës shqipe, në çfarëdo dialekti qoftë, dhe emërtimeve, sidomos emërtimeve të shkallës së dytë e të tretë. Fjala apo njësia leksikore me kuptim të përgjithshëm, qoftë për emrat e sendeve, qoftë për emrat e veprimit, mund t'i mjegullojë lidhjet me burimin e vet semantik, por jo t'i errësojë apo t'i shkëpusë. Ndërsa emërtimet e përveçme, duke pasur karakter thjesht shenjues, ashtu si emrat e rrugëve, bulevardeve, shesheve dhe lagjeve në një metropol, në një shumicë rastesh desemantizohen, siç ka ndodhur dhe me shumë emërtime të krahinës së Çidhnës. Në këtë situatë, rivendosja hipotetike e lidhjeve midis formës së sotme të emërtimit e formës së tij të kryehershme, ndriçimi i lidhjeve historike-kuptimore midis fillimit dhe fundit të tij, është shumë më e vështirë se gjetja e një etimoni për një fjalë të përgjithshme të shqipes. Në shumë raste, ky proces interpretimi, më shumë se libra dhe teori gjuhësore, kërkon njohje enciklopedike të mjedisit, njohje të thellë të burimeve të shkruara për arkeoniminë, etnoniminë e patroniminë; të historikëve të fiseve, të fshatrave, të mëhallave, të pronave dhe zotërve të tyre në zall e në bjeshkë, në mal e në vërri, në kullë e në stan, të katundit e të fshatit, *të parisë e të vogjlisë, të malit e dheut*, të krenëve bujarë dhe të polemit punëtor, të *malësisë e jallisë*, të *jallisë e tallisë* (*jallaj e tallaj*), deri dhe të dallimeve midis *fshatit të epër* e *fshatit të poshtëm* (*të poshtër*), të fshatit tradicional e të *fshatit të madh* (*fshatit të bashkuar*).

Si t'i shkojë në mendje kërkuesit të zakonshëm se në emërtimin *Ligjeta e Shllajut*, që ruhet në shumë forma thuajse në të gjitha fshatrat e krahinës, duke dalë edhe në trajtat *Shllajni* e *Shlleni*, ruhet emri i shenjtit protektor të krahinës, *Shën Ilias*, kishat dhe kulti i të cilit kishin përhapje në gjithë popullsinë e vendit, dhe jo një fjalë e përgjithshme e shqipes, *shllina*? Si t'i shkojë në mendje atij që nuk ka jetuar bashkë me bartësit e këtyre emërtimeve, se toponimi *Ksolla e Xhitakës* lidhet me një emër të përveçëm historik tripjesësh, që kishte qenë quajtur *Xhilkë Koltraka* (*Gjyle / Xhilkë*), mbërritur në gjendjen e sotme pas aq e aq përngjitjesh, rrudhjesh e shmangiesh fonematike të pafundme. Risemantizimi i emërtimeve toponimike të shkallës së dytë e të tretë, rimbushja e tyre kuptimore duke ecur pas si gaforrja, duke rindërtuar në prapavajtje procesin historik të largimit prej formës fillestare-zanafillëse, ka qenë një detyrë shumë e vështirë për autorët, por njëherësh dhe një arritje e librit të tyre.

Toponimia e Çidhnës është tashmë një libër që do t'u shërbejë studiuesve si një udhërrëfyes për kërkime të tjera. Do t'u shërbejë arkeologëve, me të dhënat për gjetje të kulturave të kryehershme dhe për lidhje të mundshme të vendbanimeve të sotme me *xhitetet* e *shkënjellet* (*shqellet, këshqelet, shtjellet*); do t'u shërbejë historianëve, me emërtimet që ndërlidhin epokën e Gjergjit të Madh, shekujt e krishterimit, Ndokën e dikurshëm kryengritës, me pasardhësit e tyre *hem me vorr, hem me fe tjetër*; do t'u shërbejë antropologëve, leksikologëve dhe në përgjithësi *entotekstologëve*.

Duke qenë tek kjo çështje, që në thelb është një formë tjetër e pyetjes së vazhdimësisë, duhet ta pranojmë se, me vështirësitë që ka krijuar, vazhdimësia e shqiptarëve prej periudhës paraosmane në kohët e reja, prej krishterimit në islamizim, është bërë po aq e rëndësishme sa dhe kapërcyelli prej ilirishtes tek shqipja, prej protoshqiptarëve tek shqiptarët. Tek e fundit, vazhdimësia nga etërit tek bijtë sot është një çështje elitare shkencore, kurse vazhdimësia prej krishterimit në shekujt osmanë është edhe një çështje politike. E gjithë ngrehina e mitit serb të Kosovës, si djep i formimit të atij populli, është ndërtuar mbi tezën që shqiptarët atje janë myslimanë dhe kjo do të thotë se erdhën në trojet e tjetërkujt, në trojet e një populli të krishterë, që nuk mund të ishte kush tjetër veç serbëve. Jo më kot Kosova për një gjysmë shekulli u bë me dy krerë, *Kosovë e Metohi*, që fjalë për fjalë do të thotë *Kosova e metoqeve* (nga gr. *μετοχή*, pronë manastiri), Kosova e manastireve, duke nënkuptuar me këtë një Kosovë sllave. *Toponimia e Çidhnës* është një libër ku kjo vazhdimësi nuk shihet, por tejshihet, nuk shqiptohet, por vërtetohet. Pa dyshim, në duart e studiuesve albanologë më të njohur: E. Çabej, A. Buda, K. Frashëri, po dhe të një brezi pasuesish të tyre, ky libër do të merrte dhe do të marrë vlerë tjetër një *surplus* të padiskutueshëm.

Haki Përnezha e Rruzhdi Bitri, autorë të librit *Toponimia e Çidhnës*, meritojnë nderimin e bashkëvendësve të tyre jo vetëm për faktin që i kanë dhënë krahinës një pasaportë të vërtetë të banorëve në trojet e tyre, qysh prej kohës së zotërimit të Kastriotëve, të aristokracisë së *motit të madh*, me *kisha e shenjtorë*, me *kroje zojash e zotnish*, me udhë të madhe tregtarësh e karvanarësh dhe ura druri për popullin; me fortesa kështjellarësh dhe sheshe të kavalerisë e të topave; me kopshte kuvendesh e me pyje kusarësh; me varosh e dogana. Aty ku historia është e prirur të fshehë vetveten, ja ku vjen etnoteksti të dekonspirojë: ndoshta dikush do të kishte dashur ta fshihte *Varrin e Ballabanit*, sepse nuk i shkojnë Dibrës edhe kryetrimi, edhe kryetradhtari, por emërtimet vendore nuk e bëjnë këtë gabim.

Toponimia e Çidhnës dëshmon mbi të gjitha se populli i këtyre anëve nuk ka jetuar si popull malesh, si barinj shtegtarë, sikurse shkruhet edhe sot në disa botime enciklopedike, por ka ditur të jetojë dhe madje ka jetuar mirë. Nëse do të numëroheshin frekuencat e fjalëve-njësi që përsëriten në emërtimet e krahinës, pa dyshim që fjala *lamë* (*lëm-i*) do të ishte e para. Ky vend, me kaq shumë *lëmenj*, ka pasur me çfarë të jetojë, ka prodhuar për vete e për të shitur. Banorët e Çidhnës kanë njohur arën dhe bjeshkën, drithërat dhe bulmetin, linin dhe leshin, verën dhe mushtin, tregtinë dhe mjeshtëritë, paratë dhe argjendet, veshën e verës e të dimrit, festën dhe ritet, Zotin dhe mitet, qefalinjtë dhe kararet, familjen dhe fisin, fshatin dhe krahinën. Të gjitha këto na i sjellin të dhënat që përmbajnë emërtimet e këtij libri, me kroje të ndërtuar prej burrash fisnikë dhe varre sakralë, me ara që janë trashëguar në emrin e *ma të parit* dhe me prona *merà*, me ura bamirësish e vahe të paemër; me vakëfe të frikshëm e *gramatikanë* të çuditshëm. Aty janë *paraspori* bizantin dhe *vila* e *shullani* latin, *selishta* sllave e *karakolli* osman, duke dëshmuar se krahina nuk ka qenë asnjëherë as e veçuar dhe as e vetëmjaftueshme.

Libri përmban edhe një *glosar* të fjalës së rrallë ose në zhdukje të shqipes nëndialektore të këtyre anëve. Të shpëtosh një fjalë nga vdekja është një shërbim i paçmueshëm për një gjuhë. Bashkë me atë fjalë mund të humbet një çelës për të zbritur në thellësitë e saj. Duke qenë se të folmet e Dibrës kanë gjetur pak vend në letërsi (Josif Bageri e Haki Stërmilli do të mund të quheshin përfaqësuesit më të denjë të ligjërimit etnografik dibran); duke qenë se dhe botimet përmbledhëse të etnoteksteve nga Dibra janë shumë të kufizuara; libri i Haki Përnezhës dhe i Rruzhdi Bitrit merr rëndësi edhe si certifikues i gjendjes së sotme të të folmeve të saj. Mbi të gjitha, prej shpjegimeve të autorëve, del se dallimet e të folmes së Çidhnës me shqipen letrare janë kryesisht, për të mos thënë vetëm, të rrafshit fonetik. Sa i takon fjalëformimit, ai përmban të njëjtat gjedhe si fjalëformimi në toskërisht, duke përfshirë Labërinë (le të përmendim vetëm një prej tyre, formën e gjinores në *-e: Grika e Marxhone* (*Gryka e Markagjonëve*), e cila për emrat e fiseve është e njëjta në të dy skajet) dhe në krahë e anë të tjera të Shqipërisë. E njëjta konvergjencë provohet edhe për rendin sintaksor e morfologjik.

Pa dashur të teorizojmë rreth dobisë së këtij libri, duhet pohuar se, po t'u referoheshim koncepteve sosyriane për raportet *gjuhë - ligjërim* (*langue & parol*, *language & speeking*), *kompetencë* e *performancë*, në raportet mes të cilave e para gjithnjë ka më shumë rëndësi se e dyta, në librin e Haki Përnezhës dhe Rruzhdi Bitrit është ligjërimi ai që tenton të ngrihet në shkallën e gjuhës, jo e kundërta, siç do ta kërkonte didaskalia teorike, dhe kjo gjithashtu shpreh origjinalitetin e punës së këtyre autorëve.

Shaban Sinani

Autorë dibranë në Panairin e Librit







Sipas romanit historik
"Të jetosh në paqe" të shkrimtarit Naim Berisha

Gjeneralët e Skënderbeut Nikollë dhe Dhimitër Berisha

Nga SAKIP CAMI

Marin Barleti në veprën e tij madhore "Histori e Skënderbeut" faqe 314, 315 shkruan "Ndër fisnikët më të mirë të atij vendi (në Dibër) ka qenë familja e lashtë e Berishëve. Dy vëllezërit gjeneralë të Skënderbeut dhe njëherësh kryetrima të rinisë dibrane, Dhimitri dhe Nikolla, ndihmën e të cilëve Skënderbeu e kishte të dëndur dhe të shënuar, kur dëgjuan për fatkeqësinë e ushtrisë sonë dhe për përfundimin e rrethimit të Beratit, kur morën pastaj vesh për rrebelimin dhe pabesinë e Moisiut, nuk u vonuan aspak, por vrapuan fluturimthi për tek roja dhe kryeporta e mbretërisë , të trembur se mos roja atje shpërndahej nga frika apo ngaqë s'kishte kush e frenonte dhe se mos vendi mbetej pa mbrojtës, sidomos kur vinin lajmet se Sebalia ndodhej ende në Epir."

Kanë kaluar 600 vjet dhe janë shkruar mijëra faqe dhe qindra libra për Skënderbeun, por çuditërisht shkrimtarët dhe studiuesit nuk i përmendin apo i përmendin zgriptas gjeneralët e tij më të mirë Nikollë dhe Dhimitër Berisha. Shkrimtari Naim Berisha, pinjoll i kësaj familje 600 vjeçare mori nismën dhe nëpërmjet një romani historik na e jep më të plotë dhe më të detajuar historinë dhe jetën e këtyre dy vëllezërve gjeneralë të Skënderbeut, që janë edhe kushurinj të tij sepse nëna e tyre Majra është motra e Gjon Kastriotit.

Dhimitër dhe Nikollë Berisha nga Mazreka e Muhurrit të Dibrës janë djemtë e Gjergj Berishë Mazrekës, njëherësh kunat dhe gjeneral i Skënderbeut. Vëllai i vogël, Nikolla pati fatin e keq, kur së bashku me shtatë gjeneralë të tjerë u kapën të gjallë nga Ballaban Pasha në betejën e Vajkalit në prill të vitit 1465 dhe me gjithë përpjekjet e Skënderbeut për ti kthyer në atdhe,por Sulltan Mehmeti II, i zemëruar nga humbjet rradhë, i torturoi deri në vdekje këto trima të Skënderbeut.

Për gjeneralët, vëllezërit Dhimitër e Nikollë Berisha shkruajnë përveç Barletit edhe Fan Noli e Naim Frashëri tek "Historia e Skënderbeut", por letërsia nuk e zëvëndëson historinë dhe me të drejtë autori i këtij libri Naim Berisha shqetësohet për faktin se si studiuesit deri në ditët e sotme i anashkaluan këto figura të fuqishme , gjeneralë të Skënderbeut.

Historiografia ushtarake na mëson se asnjë mbret apo prijës ushtarak nuk mund të fitojë luftën apo betejat pa gjeneralë të zotë. Ushtarët e zotë i përgatitin gjeneralët e zotë dhe të tillë ishin Nikollë dhe Dhimitër Berisha.

Mazreka e Muhurrit, Gardhi i Poshtëm po në Muhurr, Sina, Kuka dhe Kastrioti janë vendbanimet e Kastriotëve dhe kjo nuk diskutohet më nga askush, por është e nevojshme nga studiuesit që studimi të shtrihet edhe tek Berishajt, Kukajt, Vladen Gjurica etj.

Lidhur me një anekdotë të tejçuar keqas nga brezi në brez për Berishën e Muhurrit, gjoja se ai e ka tradhëtuar Skënderbeun, e ka spiunuar tek turqit, kur ai fshihej në pyllin e Muhurrit dhe më pas Skënderbeu e ka nëmur Berishën , kjo nuk është veçse një përrallë që nuk e beson asnjë njeri, për vetë faktin se Heroi ynë kombëtar Gjergj Kastrioti, Skënderbeu kishte një staturë princi, mbreti, kryekomandanti dhe kryegjenerali me dhjetra kështjella në zotërim dhe me mijëra ushtarë dhe nuk fshihej në zabelet e Muhurrit. Edhe nëqoftëse kjo i referohet gjyshit të Skëndebeut, Palit që kishte në zotërim Gardhin e Poshtëm në Muhurr dhe Sinën, përsëri kjo nuk qëndron. Megjithëse kjo anekdotë është botuar në librin e folklorit për mendimin tim kjo nuk përbën fakt apo dokument dhe nuk hyn tek të vërtetat historike.

Autori në këtë libër shkruan edhe për pemën gjenealogjike të Berishëve, të cilët edhe pas myslimanizimit të detyruar e ruajtën mbiemrin, vazhdimësinë e fisit dhe sot ata me të drejtë krenohen si një familje 600 vjeçare , stërnipër të Kastriotëve. Autori Naim Berisha shquhet si poet dhe romancier dhe kjo është sprova e parë në fushën e romanit historik, spovë që e ka kaluar me sukses.



Kushtuar: Dhimitër dhe Nikollë Berishës nga Dibra, gjeneralë të Skënderbeut

Është fat i madh edhe për kombin që familje të tilla dhe fise të shquara e kanë ruajtur identitetin në 600 vjet. Me sa di unë Kastriotët jetojnë sot në Itali dhe kanë ardhur në Shqipëri për ta vërtetuar vijimësinë e tyre. Edhe Berishajt sot nuk janë dy shtëpi, por qindra, jo vetëm në Dibër , por edhe në Kosovë, Pukë, Tropojë dhe jashtë në diasporë.

Vëllezërit gjeneralë të Skënderbeut, Dhimitër e Nikollë Berisha sipas dokumentave të kohës kishin nën komandë tre mijë ushtarë dhe me pronat dhe të ardhurat e tyre e mbanin këtë ushtri, ashtu si edhe Topiajt, Aranitajt, etj.

Marin Barleti në faqen 236 tek "Historia e Skënderbeut" nënvizon: "Vetëm pak nga këta të parë vendor janë përmendur prej biografëve bashkëkohës , ndër ta bëjnë pjesë Berishët, Kukët dhe Perlatët".

Demetër Franku numëron ndër nënkomandantët besnikë të Skënderbeut Mois Gjuricën, Nikollë Berishën, Muzakën e Angjelinës, Gjin Muzaka, Gjon Perlati, Gjergj Kuka dhe Gjin Maneshi.

Sipas Barletit disa nga këta gjeneralë arritën tu mbijetojnë luftërave dhe ti japin biografit Franko, vetë me gojën e tyre dëshmitë dhe bëmat e tyre konkrete. Dhe këta ishin: Pjetër Emanueli, Dhimitër Berisha, Zaharia Gropa, Lekë Kuka dhe Pal Maneshi. Përpara betejës së Sfetigradit në vitin 1464 u shfaqën si nënkomandantë të Skënderbeut nipi i Skënderbeut Gojko Stres Balshiqi, Tanush Dukagjini, Dhimitër Berisha, Muzaka , Pal Maneshi, Pjetër Manueli dhe Rajan Kuka.

Për historinë e Skënderbeut, origjinën dibrane të tij dhe për betejat në Dibër, për mendimin tim një kontribut të rëndësishëm kanë luajtur edhe studiuesit dibranë Hazis Ndreu, Vahid Kormaku , Rakip Sinani, Hilmi Sadikaj, Moisi Murra, Xhafer Martini, Besnik Kbej, Haki Koltraka, Fatos Daci etj të cilët në vitet 70 të shekullit XX bënë të mundur ngritjen e muzeut të Skënderbeut dhe të Kastriotëve në Sinë të Dibrës. Pse u zgjodh Sina dhe jo Kastrioti, Muhurri apo Kukaj? Kjo për mendimin tim është si të thuash pse gishti i vogël i dorës dhe jo i madhi. Të gjithë këto fshatra si dhe shumë fshatra të tjera nga Golloborda, Maçadi, Oraniku, Sfetigradi, Vajkali, Valikardhi, Torviolli, Cidhna dhe katër fshatrat zotërime dhe shumë të tjera janë territoret e Kastriotëve dhe të Skënderbeut dhe kjo duhet të përbëjë krenari për dibranët dhe jo ndasi.

Shqetësimi i autorit N. Berisha për vakumin e madh të historisë së gjeneralëve të Skënderbeut dhe jo vetëm të parardhësve të tij Dhimitër e Nikollë Berisha, por edhe për gjeneralët e tjerë dibranë Vladen Gjurica, Pal Kuka etj është i drejtë. Prof. Kristo Frashëri në veprën e tij "Historia e Dibrës" që i kushton një vend të zgjeruar Kastriotëve dhe Skënderbeut nuk i përmend fare gjeneralët e Skënderbeut Dhimtër e Nikollë Berisha, aq më tepër kur Nikolla ishte një nga tetë gjeneralët që u kapën të gjallë në betejën kundër Ballaban Pashës dhe Sulltani i torturoi deri në vdekje në shenjë hakmarrje ndaj shqiptarëve dhe Skënderbeut. Si studiues ushtarak pajtohem me shqetësimin e Naim Berishës për vetë faktin se nuk ka prijës ushtarak fitimtar pa gjeneralë të zot, bile edhe pa ushtarë të zot të cilët stërviten nga këto gjeneralë. Ndoshta mitizimi i figurës së Skënderbeut ndodhi edhe për vetë faktin se figura e Skënderbeut u muar nga historianët, studiuesit dhe shkrimtarët e shkëputur nga ushtria e tij, nga gjeneralët e tij. Historia nuk është film apo poemë, por një studim me fakte dhe dokumente në tërësi. Pra e thënë më shkoq edhe për Skënderbeun historianët e kohës së mesjetës duhet të rikthehen studimit duke e trajtuar në bashkësi me ushtrinë e tij, me gjeneralët dhe ushtarët e tij, ku një vend kryesor luajnë gjeneralët dhe ushtarët dibranë dhe midis tyre shkëlqejnë si meteor Dhimitër dhe Nikollë Berisha.

Autori në këtë libër shkruan edhe për pemën gjenealogjike të Berishëve, të cilët edhe pas myslimanizimit të detyruar e ruajtën mbiemrin, vazhdimësinë e fisit dhe sot ata me të drejtë krenohen si një familje 600 vjeçare , stërnipër të Kastriotëve.

Autori Naim Berisha shquhet si poet dhe romancier dhe kjo është sprova e parë në fushën e romanit historik, spovë që e ka kaluar me sukses.

Botime të tjera nga ky autor

botime

Në 23 vitet e fundit Naim Berisha numëron 35 libra artistikë, pra, të gjitha të botuara pas viteve '90-të.

Një ngjitje e re në shkallaren e poezisë

Nga **HALIL RAMA**

Në 23 vitet e fundit Naim Berisha numëron 35 libra artistikë, pra, të gjitha të botuara pas viteve '90-të. Ndër ta, gjashtë romane, shumë libra me poezi, me tregime, me hajke, me fabula, dy libra me sonetet e Shekspirit të përkthyera prej tij nga anglishtja, disa libra për fëmijë, dy albume muzikore me këngë të kompozuara dhe të kënduara nga vetë ai, një libër me 100 tekste këngësh, e tjerë.

Naimi nuk ka asnjë libër socrealist. Në diktaturë krijimet e tij konsideroheshin të errta, hermetike dhe, si të tilla, të pabotueshme. Krijimtaria e Naimit, gjithmonë, është vlerësuar nga autorë të vjetër e të rinj, të cilët janë të shquar në letrat shqipe, si: Dritëro Agolli, Teodor Laço, Bedri Dedja, Fatos Arapi, Odhise Grillo, Bardhyl Xhama, Miho Gjini dhe shumë të tjerë.

Ja si shkruan Teodor Laço në parathënien e një libri të këtij autori: "Poeti Naim Berisha ndihet i mërguar vetëm fizikisht. Shpirti i tij i ndjeshëm poetik është këtu, në malet, fushat, luginat dhe lumenjtë e vendlindjes. Aty ku realisht dhe simbolikisht mbeten vlerat e mëdha njerëzore, që janë lënda e parë e qasjeve të tij ndaj poezisë..." Dhe më pas, zoti Laço do të nënvizonte: "Naim Berisha nuk vjen nga librat, por nga nëna. Ai është një talent gjenuin, veprat më të mira të të cilit, bëjnë pjesë në fondin më të mirë të letërsisë sonë. Naimi ka mësuar nga letërsia, por nuk imiton letërsi. Për mua ai bën pjesë në grupin e vogël të poetëve më të mirë të kohëve të reja. Ndërsa Dritëro Agolli, qysh në fillimet e krijimtarisë së Naimit, qe prononcuar me profecinë e tij se N. Berisha premton shumë për të ardhmen. Dhe tani që Naimi ka publikuar 35 libra në pak më shumë se 20 vite, çuditërisht, shohim të realizuar profecinë e të madhit Dritëro.

Kësaj here Naim Berisha del përpara lexuesit të tij me një tjetër libër befasues, me 100 sonete, të titulluar "Kashta e Kumtrit". Siç duket, është frymëzuar nga puna e tij e gjatë dhe e kujdesshme e përkthimit virtuoz të 100 soneteve të para të Shekspirit. Të jemi të sinqertë, nuk dimë ndonjë autor tjetër shqiptar të ketë botuar një libër të tërë me sonete. Naimi, ndoshta, mund të jetë i pari ose ndër të parët poetë me një libër të tillë, siç është, në të njëjtën kohë, ndër të paktët hajkistë, poetë që ka botuar tri përmbledhje poetike me gjithsej 1001 hajke.

Naimi është shumë i dhënë pas prozës, por, sidomos, pas vargut. Këtë të fundit e dëshmon dhe fakti se romanin e tretë "Gurkështjella" e ka shkruar në vargje. Ai mund të rreshtohet ndër te të parët poetë shqiptarë edhe për numrin e madh të vargjeve të botuara. Vetëm romani që përmendëm më lart përbëhet prej më shumë se pesë mijë vargjeve. Po të shtojmë këtu dhe numrin e vargjeve të 20 librave poetikë të botuar, (libra për të rritur dhe për fëmijë) numri i vargjeve të botuara nga ky poet, sa cilësor, aq dhe produktiv, i kalon 30 mijë vargjet.



Sonetet i këndojnë dashurisë, sado që, jo rrallë, një dashurie efemere. Edhe pse të një tematike, sonetet e Naimit janë shumë të ndryshëm nga njëri-tjetri. Sa më shumë t'i lexosh dhe të depërtosh në thellësi të tyre, aq më shumë do bindesh për veçanësinë e bukurisë që përcjellin, për pasqyrimin e bukur ideo-estetik të temave dhe detajeve të jetës në kohë të ndryshme të poetit dhe jo vetëm.

100 sonetet e "Kashtës së Kumtrit" përshkohen nga nostalgjia e poetit për gjithçka që ndodhet larg, por që, njëherësh, kjo "gjithçka" është, gjithnjë, pranë tij. Malli dhe dashuria e shprehur me mjeshtëri artistike, me një gjuhë të pasur dhe figuracion të zgjedhur poetik, herë si një trishtim i lehtë, herë si një klithmë e thellë shpirtërore, përshkon si një fill i blertë të 100 sonetet e librit.

Në sonetet e tij vërshojnë si gurrat e kthjellta të bjeshkëve të Runjës dhe Korabit mendimet dhe ndjenjat e gjalla të njeriut, përpjekjet e mundimshme të njerëzve për të ruajtur të paprekur dashuritë e tyre nga dora rrënimtare e së keqes.

Në sonetet e Naimit triumfon dashuria mbi tendencën e fortë të prishjes së përhershme të kohës. Ky lajtmotiv ravijëzohet në disa nga sonetet, ndërsa në shumë sonete të tjerë të drithëron zemrën pathosi i bukurisë së jetës. Është pikërisht ky pathos që të grish për të ecur gjithnjë përpara pa droje, pa iu dorëzuar forcës shkatërrimtare të vdekjes. Në sonetin "Ti ishe lindur t'më bëje të lumtur" poeti i këndon me aq pasion të dashurës, e cila mbërrin në Londër me 1998 vetëm disa muaj pas tij. Ndërsa në sonetin "Pas puthjes së parë" shohim një magjepsje të poetit. Tek "Më thuaj, e dashur" mposhtet errësira, e liga, vdekja. Te "Kish ndërruar devri" himnizohet përmallshëm babai. Tek soneti "Aromë nëne" që është një tjetër perlë, përshkruhet dhimbja madhështore e nënës.

Në të 100 sonetet, ku më shumë e ku më pak, sintetizohen me ndjeshmëri të lartë të gjitha dridhjet e ngashërimet që të shkakton jeta. Tek soneti "Para dhe pas vitit "Një" autori pyet, retorikisht, "Ç'e dua dashurinë pa dridhje zemre". Sonetet i këndojnë dashurisë, sado që, jo rrallë, një dashurie efemere. Edhe pse të një tematike, sonetet e Naimit janë shumë të ndryshëm nga njëri-tjetri. Sa më shumë t'i lexosh dhe të depërtosh në thellësi të tyre, aq më shumë do bindesh për veçanësinë e bukurisë që përcjellin, për pasqyrimin e bukur ideo-estetik të temave dhe detajeve të jetës në kohë të ndryshme të poetit dhe jo vetëm.

Sonetet e Naimit, gjithë ndjenja të bukura e të pastra, bien menjëherë në sy edhe për një psikologji dhe filozofi sinjifikative, që, më së shumti, të kujton psikologjinë dhe filozofinë e bisedave të mençura të pleqve të Dibrës, të trevës nga vjen poeti. Në këtë kontekst mund të përmendim sonetet "Trojet e mia", "Dhe në varr", "Ëndërr mashtruese", "Buka e vjetër", "Të digjesh për dashurinë", "Për shkak të ëndrrës", "Derë hekuri", "Bari i ringjalljes", e tjerë.

Me frymëzim të rrallë e bukuri të veçantë janë shkruar dhe sonetet "Rinia ime", "Malli i rinisë", "Mos ma vetmo verën", "Puthja", "Peizazh me një gazel", "Currila drite", "Gjuha shqipe", "Pikëllimi i vjershës", e tjerë. Mesazhe të bukura dhe domethënëse përcjellin sonetet "Pranverore", "Romeo dhe Zhuljeta", "Gur mermeri", "Vajza e jugut", "Fluiditet", "Trishtim i bukur", "Ëndrra e fundit e Gjorg Berishës", "Ditiramb për gratë", "Vizatoj atdheun", "Shpirti british", "Metamorfozë", "Kanarina", "Gjithësia e fjalëve", "Grua, mos më pyet", "Zogu i këngës" e shumë të tjerë. Te soneti "Letër e hapur" shpirti i poetit revoltohet kur sheh sesi në jetën e të atit të tij shpërfilljet bënin ligjin. Këto e të tjera kontradikta na kujtojnë, veç të tjerave, përplasjet e egra në kohën e diktaturës komuniste.

Herë-herë, në sonetet e Naim Berishës ndihet dhe një jehonë e largët epike e poezizë së lashtë si dhe asaj mesjetare. Le të kujtojmë sonetet "Homeri ynë i verbër", "Poezia", "Ilirët, stërgjyshat e mi hyjnorë", "Iliria", "Pemët e ullirit", "Shqypni", e ndonjë tjetër. Në ndonjë sonet tjetër autori hedh idenë se bukurinë e asaj që dashuron, në të vërtetë, e kanë parakënduar poetët e antikitetit, të cilët thurnin ditirambe për zonja të bukura dhe kalorës të magjishëm. Çdo sonet i këtij vëllimi, duke qenë një poezi mjaft e ndjeshme lirike, është, në të njëjtën kohë, dhe një kyç, me të cilin poeti hap zemrën e tij të pastër e të sinqertë përpara të gjithëve. Sonetet që kemi në dorë, si gjithë poezia tjetër e Naim Berishës, nuk janë ushtrime retorike a madrigale të shkruara kuturu, siç ndodh sot rëndom në mjaft autorë, por janë ndjenja të sinqerta dhe të pastra, të cilat përbëjnë gjetje dhe që burojnë natyrshëm nga thellësia e shpirtit poetik të Naimit. Me këtë libër të veçantë Naim Berisha shënon një ngjitje tjetër në shkallaren e poezisë së re shqipe.

Botime të tjera nga ky autor





Prof. dr. Mahmud Hysa deri në ditën e fundit të jetës (17 mars 2016) u mor me studime e kritikë letrare, përpiloi në masë të madhe libra shkollorë, qe njohës i mirë i historisë sonë...

Prof.dr. Mahmud Hysa,
i pazëvendësueshëm për letërsinë shqipe

Nga **ARSIM KOLARI**

Mahmud Hysa lindi më 20 korrik 1934 në Dibër të Madhe. Qysh si fëmijë iu dalluan aftësitë e studimit të gjuhës shqipe, për t'u bërë sot një ndër njohësit më të mëdhenj të letërsisë së vjetër shqipe. Shkollën fillore e kreu në qytetin e lindjes, tetëvjeçaren në Tiranë (1945 - 1948), ndërkaq normalen në Tetovë (1951). Pasi punoi dy vjet si mësues, vazhdoi studimet në Fakultetin Filologjik, Degën e Albanologjisë në Beograd (1953-57). Fillimisht punësohet si profesor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në gjimnazin e Dibrës, por më 1971 në Akademinë Pedagogjike të Shkupit dhe nga viti 1974 në Fakultetin Filologjik të Prishtinës, si profesor i letërsisë së vjetër. Doktoroi më 1980 në Universitetin e Prishtinës me temën: "Andon Zako Çajupi, jeta dhe veprat".

Në vitin 1972 merr pjesë në Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë, ku në mënyrën më të përsosur përfaqëson shtresën intelektuale letrare, nga ku kthehet me emblemën e artë "Kongresi i Drejtshkrimit - Tiranë 1972". Profesor Mahmudi ishte një ndër themeluesit e Universitetit Shtetëror të Tetovës, ku ligjëroi deri në vitin 2011. Përgjithësish, profesor Mahmudi u mor me studime letrare, meqë dimë që të studiosh një vepër letrare do të thotë të merresh me mënyrën e thurrjes së asaj vepre, e më pas të rezultojë e mirë, bindëse e artistike në sy të lexuesit. Me mbledhjen e materialeve letrare është marrë që në vitin 1959, ku dallohen studimet e letërsisë arbëreshe dhe të romantizmit. Botoi studime në revistat dhe gazetat e vendit. Ka botuar përbledhje të studimeve: "Letrari dhe vepra", Shkup, 1972, "Gjurmë të letërsisë arbëreshe", Shkup, 1977, "Andon Zako Çajupi", Prishtinë, 1983, "Kristomaci e letërsisë së vjetër shqiptare", Prishtinë, 1986, "Alamiada shqiptare" vëllimi I dhe II, Shkup, 2000, "Hyrje në letërsinë shqiptare", Prishtinë, 2000, etj.

Në vitin 1992 boton përmbledhjen biografike të pishtarit të arsimit shqip, dibranit Said Najdeni - Hoxhë Voka, e në vitin 1996 boton studimin "Shtjellime letrare". Viti 2008 sjell në dritë të dhëna të reja dhe të padëgjuara më herët për autorin e shek. XVII Pjetër Bogdani, falë profesor Mahmud Hysës me veprën "Bogdani, si nuk e njohim". Vepra tjera të prof. dr. Mahmud Hysës, janë: "Studime I" (Tema nga letërsia shqiptare), "Studime II" (Tema për historinë kombëtare), "Studime III" (Qasje veprave të pesë studiuesve shkodranë), "Studime IV" (Këtu autori bën shtjellimin e disa çështjeve kombëtare-arsimore", "Studime V" (Polifonia e tekstit letrar - "Fiksioni në romanet e Ibrahim Kadriut"), "Studime VI" (Përshkruan personalitetet e shquara dibrane - Said Najdeni e Hafiz Sherif Langu), "Studime VII" (Polifonia e tekstit letrar



II - "Fiksioni në romanet e Ibrahim Kadriut"), "Orët e liga", "Gjurmë të letërsisë arbëreshe" (Studim mbi kulturën dhe traditën arbëreshe) "Gramatika" (Sintaksa e gjuhës shqipe për klasën e shtatë fillore), bashkë me profesor Remzi Nesimin përpilojnë dy libra "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe" (për vitin e parë dhe të dytë gjimnaz), "Të folurit dhe të shkruarit" (gjithashtu për vitin e dytë gjimnaz), "Gjuhë shqipe" (libër për klasën e shtatë fillore, bashkëpunim me profesor Xhemaludin Idrizi), "Një Kosovë të vogël në Dibrën e madhe" (është një nga veprat më të arrira të autorit që përmbledh të gjithë veprimtarët dibranë dhe kontributin e Dibrës së Madhe në periudhën e luftës së Kosovës). U mor edhe me publicistikë, ka botuar: "Prokrusti modern", Shkup, 2000. Për veprën "Hyrje në letërsinë shqiptare" në vitin 2000 merr shpërblimin "Naim Frashëri" nga Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore Prishtinë, si teksti më i mirë i vitit.

Prof. dr. Mahmud Hysa deri në ditën e fundit të jetës (17 mars 2016) u mor me studime e kritikë letrare, përpiloi në masë të madhe libra shkollorë, qe njohës i mirë i historisë sonë, bashkëpunoi në mjaft projekte letrare e artistike, për t'u ngritur në nivelin më të lartë profesional, pse jo dhe të quhet si "truri" i kombit tonë.

Prezantohet libri "U rrita me lotët e nënës" nga Adem Kormaku

***NGA* ILMI DERVISHI**

Në 9 tetor 2016,l në sallën e madhe të Muzeu Historik Kombëtar u promovua libri me shënime e kujtime të inxhinierit dibran Adem Kormaku me titull "U rrita me lotët e nënës", botim i Dita Print, organizuar nga shoqata "Stebleva".

Për librin foli poeti e gazetari Kujtim Boriçi, një mik i hershëm dhe redaktor i librit. Për jetën e autorit, që gjashtë muajsh mbetur jetim e rritur me nënën, foli Ramazan Hoxha, publicisti Velo Cfarku, poetja Nexhi Baushi, etj.

Libër është shumë interesant dhe krejt i veçantë, tha redaktori Kujtim Boriçi. Përveçse peripecive jetësore të një fëmije që mbeti jetim në moshën 6 muajshe në vendlindjen e tij në Steblevë, deri në 'firmën' që ai ka hedhur në më shumë se 5 dekada punë në ndërtimin e veprave të rëndësishme kapitale në Tiranë e qytete të ndryshme të Shqipërisë, do të gjeni mesazhe jetësore të një intelektuali që ka dhënë, jep e fal gjithmonë mirësi... Do të njiheni me ndërtimin e Pallatit të Madh të Kulturës në Tiranë, Muzeut Historik Kombëtar, godinës së Ministrisë së jashtme, Memorialin e Mat'hauzenit në Austri ndërtuar nga Ademi e kolegë të tij për një kohë rekord tre muaj, e shumë objekte të tjera të rëndësishme...

Me mjaft interes ishte përshëndetja e mjekut, dr. Ilia Mazniku për trashgimninë e artit të ndërtimit në zonën e



Gollobordës. "Edhe unë kam punuar në ndërtim dhe e njoh zanatin e ndërtuesit, tha doktor Ilia Mazniku.

Pas fjalës përshëndetëse të autorit Adem Kormaku u dha një koktej ku u shkëmbyen libra dhe mendime.

Gruaja që sfidoi diktaturën

Nga **SAKIP CAMI**



Libri i dhjetë i publicistit dhe studiuesit të njohur Halil Rama i kushtohet Liri Belishovës, një nga figurat më interesante, përfaqësuese të elitës intelektuale mbarëkombëtare. Në promovimin e këtij libri, pikërisht ditën që Zonja e Rrallë, Belishova festoi 90-vjetorin e ditëlindjes, përveç dhjetra personaliteteve të letrave shqipe, ishin të pranishëm dhe ish-presidenti i Republikës, Alfred Moisiu, Heroi i Popullit dhe nderi i Kombit, gjeneral rrahman Parllaku, emblema e qëndresës në burgjet serbe, deputetja e parlamentit të Kosovës, Flora Brovina si dhe ikonat e skenës dhe ekranit tonë, Tinka Kurti, Margarita Xhepa e Raimonda Bulku.

I moderuar me mjeshtri të rrallë artistike nga gazetarja e mirënjohur, Tefta Radi, promovimi i librit "Liri Belishova, gruaja që sfidoi diktaturën", si dhe Akademia Jubilare, organizuar me këtë rast nga OBVL, sollën në vëmendjen e qindra pjesëmarrësve në sallën e Akademisë së Shkencave portretin e kësaj gruaje emblematike, të edukuar, të shkollur, të përkushtuar dhe të kulturuar në shkallën më sipërore. Si e tillë, ajo zë vendin e merituar në panteonin e nderit të kombit shqiptar.

Në këtë libër, i cili është i ndarë në pesë kapituj jepet aktiviteti politik dhe shoqëror i Liri Belishovës, spikatja e saj në luftë, por dhe pas luftës, si një politikane që nisi të dallonte që në rininë e saj nga kontributoret e kohës.

Kryetari i OBVL-së, gjeneral Rrahman Parllaku, evidentoi faktin se një pjesë të rëndësishme në libër, si dhe në jetën e Belishovës, zënë vuajtjet e saj si dhe të familjes pas internimit e burgosjes së bashkëshortit Maqo Çomo, por dhe tregimet e njerëzve që e kanë njohur atë nga afër, disa bashkëvuajtës të regjimit komunist të Enver Hoxhës, por dhe miq të fëmijëve të Belishovës.

Prof.Dr. Ana Lalaj, që ka trajtuar shkencërisht më mirë se kushdo historinë e LANÇ-it dhe të pasluftës, nisur nga trajtimi i fakteve e ngjarjeve në këtë libër, ndër të tjera tha se e sheh jetën dhe veprimtarinë e Belishovës në tri kohë.Portreti i Liri Beloshovës na shpalos një pjesë të historisë kombëtare që na bën të ndjejmë emocione. Pikërisht këto emocione i përcolli në këtë takim promovues edhe Kryetari i Shoqatës të Veteranëve të LANÇ të Kosovës, z.Zija Mulhaxha.

Nga ky këndvështrim i evidentuan vlerat e këtij libri ish-presidenti Moisiu, Znj.Grida Duma - Sekretare për Marrëdhënjet Publike në PD, si dhe Prof.Dr.Nevila Nika.

Fjalë zemre shprehën gjithashtu për Znj.Liri Belishova në 90-vjetorin e ditëlindjes së saj, artistet e Popullit Tinka Kurti e Margarita Xhepa, si dhe deputetja dhe shkrimtarja disidente kosovare, Flora Brovina. Ata thanë se libri i sapobotuar i publicistit dhe shkrimtarit Halil Rama, me titullinin sinjifikativ: LIRI BELISHOVA - GRUAJA QË SFIDOI DIKTATURËN" vjen si një dhuratë e çmuar për të në këtë ditëlindje të 90-të të saj.

Në këtë libër gjejmë portretin e gruas emblematike, si luftëtare e paepur antifashiste, si diplomate dhe politologe e shkëlqyer.Në pesë kapitujt e librit gjejmë profilin e kësaj zonje me cilësi të ralla kulturore, komunikative e propagandistike, bindëse. Në kapitullin e fundit, "Bashkëkohësit për liri Belishovën", gjejmë edhe vlerësimin e diplomatit Arian Starova - President i Këshillit Atlantik të Shqipërisë. Ndër të tjera ai shprehet: "Liri Belishova do të më befasonte përherë me dijet e saj të gjera e të thella, logjikën e saktë të të arësyetuarit, kujtesën e pagabueshme, interesin e jashtëzakonshëm për zhvillimet demokratikë të vendit dhe sfidat e ndryshme me të cilat përballeshim, si edhe me aftësinë e saj të mrekullueshme për të dëgjuar dhe respektuar mendimin e bashkëfolësit. Aftësitë intelektuale dhe dijet e kësaj zonje janë ruajtur brenda një shpirti të madh që nuk e ka lejuar kurrë të shajë askënd, as përndjekësit e saj të pashpirt gjatë viteve të internimit".

Në këtë këndvështrim e shohin profilin e Liri Belishovës artistja e Popullit, Rajmonda Bulku, gazetarët e njohur Kozeta Mamaqi e Hyqmet Zane, si dhe Dr.Arta Sakja si pjesë këtij libri. Të pranishmit mirëpritën gjithashtu interpretimin dinjitoz të poezisë "Ditiramb për Liri Belishovën", nga autori i saj, poeti Naim Berisha që është dhe redaktor i librit.

Një urim të përzemërt në këtë 90-vjetor të ditëlindjes, përcolli dhe mbesa, Daniela Belishova, e cila kishte ardhur nga Italia, ku punon dhe jeton, për ta përshëndetur hallën e saj në emër të familjarëve dhe të afërmëve.

botime

Shihni ku i dhëmb poetit

Nëpër disa vargje të vëllimit "Flakërimi i shpirtit" të poetit Hamdi Skeja

Nga **FEJZULLA GJABRI**

Një krijimtari mjaft interesante na vjen nga poeti i ri Hamdi Skeja. Konçiz në mendime, i matur në fjalë dhe në mesazhe.

"E bukura është e kufizuar tek e pakufishmja, kur sublimja është e pakufizuar tek e kufizuara". Ka dy vëllime poetike: Ekstremume dhe Flakërima e shpirti. Hapa faqen e tij në internet dhe pashë mesazhet e vëllimit parë: Pafund urimesh dhe fjalësh të ëmbla. Në të dytin poeti gjendet vetë ne çdo poezi, diku i qeshur, diku i zymtë, diku i dashuruar, diku i zemëruar, deri në "Ku dreqin talentin blejnë e vjedhin", për ta përfunduar me mesazhi "sot për sot, si të gjithë të tjerët, vrapo edhe ti!"

Nga nisja në rrugën e poezive deri në "Vrapo edhe ti", ka jetë, ka jetë, por jo pa sakrifica. Një rrugë që jeta e ka bërë "Në sy më shoqëron një lot" me "Kam parë, eh, sa kam parë!"...." . Dashuria e ngre personin prej një vetëdije të ngushtë dhe e bën motër me të gjitha vuajtjet e njerëzimit! Hamdiu është i ri, por poezitë flasin sikur ka kaluar moshën e pjekurisë. Prandaj mund të themi se "Flakërim shpirti" nuk ka poezi vetëm për të rinj, por ndjehet te të gjitha moshat. Është i tillë se di të komunikojë me të gjithë, me fëmijët, me të rinjtë, me të rritur e me moshë të thyer. Kudo e për këdo del se dashuria është brenda qenies njerëzore. Një fjalë që e ka përdorur njerëzimi që me lindjen e tij. Hamdiu nuk e shpërdoron fjalën 'dashuri', por e shpalos bukur me një linjë subjekti. "E shpalos bukur", them edhe "e shpalos me realizëm, me gjithë pasurinë dhe larminë e saj, që nga fillesat, me naivitetin e fisnikërinë, dhimbjet e gëzimet, shpresat e dyshimet, vuajtjet, frikën e krenarinë.

Rruga e dashurisë në ketë vëllim poetik jepet edhe si rruga që hap dritaret e mendjes, rruga që çon drejt ngritjes shpirtërore të njeriut, drejt nxitjes për zhvillim, drejt përsosjes morale të njerëzimit në përgjithësi. Këtë e vëren edhe redaktorja, e cila shprehet se "... nga një akt në tjetrin, nuk e ka humbur asnjëherë fillin e rrjedhshmërisë".

Në libër gjen qëmtime të imta të botës njerëzore, gjen vetveten, shoqërinë, kombin. Diku "Lëmsh", diku "Bota ime", që janë poezi në vazhdim të njëra tjetrës. Aty në poezi është brenga e femra, pranvera e shiu i malit, mali vetë, malli e shpirti, që të gjitha së bashku lidhen me "'Flakërima shpirti". Të bën përshtypje që në këtë moshë të ndjesh dhimbje, dhimbje shpirti. Jo vetëm t'i ndjesh, por të dish t'i shpalosësh në poezi. Dhimbje ndjen gjithkush, se që kur lind njeriu, lind dike qarë. Kjo se jeta nuk është e lehtë, është e bukur, por brenda bukurisë ka edhe shëmtime, brenda kësaj jete ka brenga, ka ofshama. Shpesh në poezitë e Hamdiut i ndjemjë këto ofshama. "Djallosa veten, fatin me fjalë djalli/ Fatit hije i ulërita me gjithë forcë./... dhe qeshi me ironinë e turpshme,/ .../besnikërinë time e përdhosi".



Hamdi Skeja
FLAKËRIMA SHPIRTI
Redaktore; Vjollca Shurdha

Botimet ADA
ISBN 978-9928-223-23-4
136 faqe
Çmimi: 500 L

> Me rrugë të sigurt të një poeti të ri e të talentuar, thellësisht të ndjeshëm, Hamdiu na ka dhënë shkurt e qartë modelin e shpirtit dashuror, ndjenjën e së bukurës e neverinë e të shëmtuarës.

Lexojeni këtë poezi! Shihni ku i dhëmb poetit! Me rrugë të sigurt të një poeti të ri e të talentuar, thellësisht të ndjeshëm, Hamdiu na ka dhënë shkurt e qartë modelin e shpirtit dashuror, ndjenjën e së bukurës e neverinë e të shëmtuarës.

Ec në rrugën e poezisë, poet i Kalasë së Dodës, se ke rrugë të gjatë për të bërë! Nëse yt atë, Tahiri, ishte artist i valles e folklorit, ti vazhdo në kohën tënde rrugën e bashkëkohores!

Poetesha studente

Nga **SELMAN MËZIU**

Ndoshta nuk mundem me zbulue në shpirtin poetik të studentes që i është përkushtuar sociologjisë e psikologjisë, se ku fillon muza e saj poetike, se ku proza e saj e shkurtër do të emocionoi gjithëkënd apo...

Origjina e saj stërgjyshore është nga Stelushi, nga ai shkëmb ku ngriheshin bedenat e një kalaje. Nga kjo pikë gjeografike ku shikoheshin bukur shume yjet në qiell, e fitoret e Kastriotit të madh, përcilleshin nga Dibra në Mat e habisnin qeveritë e vogla të evropës perëndimore, për përmasat madhore të fitoreve kundër superfuqisë më të madhe të shekullit të pesëmbëdhjetë. Mbiemri i saj ende ka mbetur aty edhe pse janë rrokullisur qindra e qindra shekuj; ara e Strakës ose legjata e Strakës.

Ajo tokë e bekuar ku u rrit elbi, thekra, tërshëra, urofi, meli u mprehën shpatat e u rritën kuajt trupë mëdhenj, do të gatuante me kujdes breznitë e poetes së re Urime Straka, duke udhëtuar nga Qaf Murra në Cetush të Dibrës së poshtme, ku balta e tij ishte fillesa e artizanatit të guzhinës së moçme dibrane. E pashme, e shijshme buka që piqesh në çerepët e grosha e zier me pastërma në vorbat prej dheut, botës së tokës ku lindi ajo. Shpirti i saj fëminor filloi të vargëzoi poezitë e para, me një strof me dy, me tre, kështu vargu filloi të peshoi, të ngjalli emocione, të ngrinte peshë zemrat e të ledhatonte shpirtrat që i këndonin. Ashtu hap pas hapi poetesha del para lexuesit me vëllimin e parë poetik "Qetësisht" Tiranë 2013. Por edhe të gjurmëzoi poezia e saj në faqet e gazetave të kohës si në "Nacional", "Muzgu", "Rruga e Arbërit", "Dibra", "Intervista" etj., duke mbledhur rreth vargut të saj, përkundruall zhargonit poetik vlerësimet e lexuesve nga e gjithë Shqipëria, si buqeta frymëzimi e shtyerje përpara.

Krijimet e saja si fraza të çastit në trajta aforizmash, copëzat e mendimesh për dukuri e çështje që e lëndojnë zemrën e shpirtin e saj tanimë 21 vjeçar, skicat letrare etj., ajo iu ka gjetur edhe dritare të tjera botimi në rrjetet sociale, siç janë "Mendimi poetik Urime Straka" dhe faqja e saj ne FB.

Ndërsa poetja e re në rrokullimën e vitit 2014 paraqitet përpara lexuesve me librin e saj të dytë: "Përtej ëndrrës", botimet M&B, Tiranë 2014, për të cilin kritiku letrar Fatmir Minguli do të shkruaj:

"Në pamje të jashtme duket se i gjithë libri i nënshtrohet një dëshire të autores e cila ka zgjedhur prozën dhe jo poezinë. Por në një vështrim të brendshëm, nën frymëzimin që faqet e këtij libri të japin, lexuesi kupton se ka të bëjë me një prozë poetike. Përveç se prozë poetike ajo herë-herë ngjan me ese të vogla. Prozë – eseja, ja enigma e bukurisë së librit të brishtë të kësaj autoreje".

Pra poetja e re dibrane kalon natyrshëm pa sforco, pa detyrime patetike, në gjininë e prozës apo siç e quan z. Minguli "prozë poetike" duke hyre në skalitje karakteresh, në thurje dialogësh, në përshkrime ngjarjesh e mjedisesh ku lëvizin personazhet.

Ajo si një psikologe e lindur, e mësuar në studimet universitare, filozofon me frazat, kaq bukur, tërheqshëm sa të bën për vete, të rrëmben e të detyron ëmbëlsisht të mos shkëputesh nga leximi, deri në fundin e eses së saj apo të mendimeve të ardhura nga ngacmimet e realitetit të sotëm dramatik e tragjik shqiptar në zhanre të ndryshme. Dhe ja se si e zbulon vetveten në një prozë të shkurtër në FB të datës 6 shtator 2016: "Jam tip që nuk i fal detajet, i urrej padrejtësitë dhe injorancën. Jam tip që dëshiroj dhe kërkoj tek njerëzit të kenë së paku sensin e diçkaje në jetët e tyre...

> "Në pamje të jashtme duket se i gjithë libri i nënshtrohet një dëshire të autores e cila ka zgjedhur prozën dhe jo poezinë. Por në një vështrim të brendshëm, nën frymëzimin që faqet e këtij libri të japin, lexuesi kupton se ka të bëjë me një prozë poetike. Përveç se prozë poetike ajo herë-herë ngjan me ese të vogla. Prozë – eseja, ja enigma e bukurisë së librit të brishtë të kësaj autoreje".
>
> **Fatmir Minguli**

Nuk jam tip që mbytem e marrosem duke sharë qeverinë, pushtetarët, një parti politike a një tjetër. Jam ai tipi që në heshtje respektoj edhe ata që na marrin frymën me premtime diplomatike elektorale, fundja është aftësi e tyre për të gënjyer dhe idiotësi, naivitet dhe verbëri e jona për të besuar".

Sa lirshëm, thjesht, kuptueshëm i shpreh mendimet, dhe zbulon karakterin e saj poetesha dibrane, që nuk përton së shkruari, së gjykuari, edhe pse ndonjë natë rri pa gjumë, duke përballuar leksionet e shumta për provimin e nesërm në disiplinat e psikologjisë e sociologjisë. Dhe përsëri shkruan e shkruan me stilin e saj të veçantë, me mendimet e saja të matura e labirinthe që din t'i zbuloi veç pena e saj.

Por ajo në momente të caktuara shpërthen edhe me poezinë, dhe ja një strofë e shkëputur nga FB: Mos fol teksa ikën dhe kokën nuk e kthen, / I urrej lamtumirat kur thuhen mes ndjenjash... / Kur çdo gjë na ndan për t'mos patur rikthim. / Më thuaj vetëm: një ditë do të shihemi... / Ta mbaj në gji këtë fjalë, si të vetmin ngushëllim...!

Sa koherente është me vargun e saj të gjatë, përmes kundërshtive të ndërsjellta dhe emocioneve në zgjim që natyrshëm të çojnë poetikisht në zgjidhje. Gjithashtu një mënyre të edukuari, të sjelluri dhe ëmbëlsie të një jete me plotë shpresa e dashuri njerëzore.

Poetesha e re dibrane Urime Straka, së shpejti do të dalë para lexuesve me një botim të ri, sigurisht më i arrirë nga ana artistike, më i pëlqyeshëm nga lexuesit e kulturuar, por që ajo na u lut të mos shkonim më tej së treguari që ju kur të shfletoni fletët e librit të ardhshëm t'iu gurgulloi kureshtja e të papriturat e këndshme të jenë dhurata më e çmuar për juve. Rrëfimet e saj do të kenë aromën e bukurinë e luleve të pranverës, e gjetheve shumëngjyrshe të vjeshtës, e yjezave të borës së janarit e gurgullimave të përrenjeve të pranverës e shoqërise shqiptare që po kalon dramën e vërtet të varfërimit material e moral e të intrigave politike që cfilitën natyrën, mjedisin e njeriun.

Rruga e Arbërit nr. 126

Stadiumi i "Korabit", jo si Rruga e Arbrit...!

Nga **DEFRIM METHASANI**

Sezonin që shkoi, kur skuadra e Korabit luante në kategorinë e parë, zbuloi një statistike interesante, ku mesatarja e numrit të sportdashësve vinte menjëherë pas Korçës për praninë e njerëzve në një ndeshje futbolli, përjashto këtu, një derbi mes Partizanit e Tiranës.

Ndaj, të shpresojmë dy gjëra të rëndësishme: Së pari, që skuadra do të gjejë forcën dhe motivin e duhur për ta përballuar këtë sezon dhe të mos zbresë në kategorinë e parë. Dhe së dyti, por që është më e rëndësishme, të nisë puna për rindërtimin e stadiumit "Korabi", këtij tempulli sportiv, që dibranët jo vetëm e duan, por edhe e meritojnë.

Pak ditë më parë në rrjetet sociale, lexova një lajm për rindërtimin e stadiumit të Korabit, duke plotësuar kësisoj kushtet që ekipi dibran të luajë në shtëpinë e tij dhe pranë tifozëve dibranë. Në këtë lajm tregohej që fondi prej 1.5 milionë eurosh, thuajse ishte garantuar dhe tashmë mbetej vetëm konkretizimi për të nisur punimet, që gjithnjë sipas lajmësit, mbetej të shihej dita e parë e dhjetorit ose e muajt janar për t'u konkretizuar.

Mendohet kësisoj rehabilitimi i tribunës, mjediseve të brendshme, shkallët, rrethimi, tapeti i ri i fushës dhe gjithçka tjetër që t'i ndryshojë pamjen objektit më të rëndësishëm sportiv në Peshkopi.

Sipas burimeve mësohet se 1 milion euro është fondi i qeverisë shqiptare, ndërsa 500 mijë euro fondi i FSHF, si mbështetje dhe ndihmë për futbollin dibran.Natyrisht, që si dibran, por edhe si gazetar e qytetar, çdo lajm i mirë më gëzon dhe më bën optimist. Por, jo rastësisht, edhe titullin e shkrimit e bëra të tilla, duke e lidhur edhe me rrugën e Arbrit. Them kështu, sepse nuk dua që stadium i ri me parametra bashkëkohorë, të zgjasë pafund e të mbetet thjesht një ëndërr e bukur vjeshte...

Nuk dua që premtimet e shpeshta për ndërtimin e stadiumin, si dje, ashtu edhe sot, të jenë premtime boshe dhe thjesht elektorale. Nuk dua që ata njerëz të gënjehen e zhgënjehen sa herë ka zgjedhje apo fushata. Nuk dua që, unë, si moderator, të ridal e flas në tribunën aktuale të stadiumit, apo skena të tjera, për lajme të rreme dhe stadium të ri... E thënë ndryshe, nuk dua që fati i stadiumit, të ishte binjak me fatin e rrugës së Arbrit, e cila të paktën prej 15 vitesh flitet e flitet dhe kurrë s'u mbarua e nuk i dihet fundi i saj.

Në fakt, nëse shohim politikën e qeverisë aktuale për investimin në sport, dua ta besoj, sepse u ndërtuan brenda tre viteve dy stadiume, ai i Elbasanit dhe i Shkodrës, ndërsa vijon puna për atë të kryeqytetit. Por, po kaq i vlefshëm do të ishte stadium "Korabi", sepse edhe qyteti i Peshkopisë dhe bashkia Dibër, të shohë dritën jeshile me stadiumin e ri, që do të plotësonte edhe interesat e tifozëve më të shumtë që shkojnë në shkallët e një stadium.

Sezonin që shkoi, kur skuadra e Korabit luante në kategorinë e parë, zbuloi një statistike interesante, ku mesatarja e numrit të sportdashësve vinte menjëherë pas Korçës për praninë e njerëzve në një ndeshje futbolli, përjashto këtu, një derbi mes Partizanit e Tiranës.

Pra, kemi të bëjmë me një treve, e cila e do futbollin dhe e ndjek atë. Dibranët vërtet u gëzuan për rikthimin e ekipit të tyre pas 54 vitesh në superligën shqiptare, por ky gëzim dhe kjo atmosferë pozitive u përhumb, që kur stadiumi nuk plotësonte kushtet për të luajtur ndeshjet brenda.

Aktualisht, skuadra e Korabit luan në stadiumin "Selman Stermasi" dhe paguan 2.5 milionë lek për çdo ndeshje dhe 1 milionë lekë për një muaj stërvitje për fushën e klubit Tirana. Vërtet mëkat! Deri dje kemi luftuar për të parë ekipin në superligë, ndërsa tashmë nuk luajmë dot në shtëpi. Kësaj i thonë: Të kesh shtëpi e të jetosh me qira"...

Ndaj, të shpresojmë dy gjëra të rëndësishme: Së pari, që skuadra do të gjejë forcën dhe motivin e duhur për ta përballuar këtë sezon dhe të mos zbresë në kategorinë e parë. Dhe së dyti, por që është më e rëndësishme, të nisë puna për rindërtimin e stadiumit "Korabi", këtij tempulli sportiv, që dibranët jo vetëm e duan, por edhe e meritojnë.

KORABI GJEN SHPËTIMIN ...

Dorëhiqet trajneri Artan Mergjyshi në javën e 9-të të kampionatit, pas humbjes në Vlorë. Shpëtim Duro mund të jetë timonieri i ri.

Skuadra e Korabit do të ketë trajner të ri nga e hëna, ndërsa ish trajneri Artan Mergjyshi që e udhëhoqi ekipin që nga grumbullimi i pare, ka dhëne dorëheqjen. Rezultatet e dobëta ne këto 9-të javë kampionat, detyruan trajnerin Mergjyshi të bëj divorc me Korabin, duke lënë vend për një tjetër emer të njohur te futbollit, pikërisht Shpëtim Duron. Pas ndeshjes në Vlorë dhe humbjes më të thellë në superligë 4-1, Mergjyshi deklaroi në media se s'do të jetë më trajner. Menjehere stafi u mblodh dhe përzgjodhi emrin e Shpetim Duros, një nga më të njohurit e trajningut shqiptar.

Duro ka punuar edhe si trajner me ekipe të mëdha, si Partizani, Skenderbeu, Shkëndija e Tetoves, por aktualisht ishte i lirë. Bashkë me emrin e tij, u lakuan edhe ai i Agim Canes, Gerti Haxhiut, Klodjan Dures, etj. Një lajm i mire ishte edhe shlyerja e pagesave të prapambetura të futbollistëve dhe stafit nga donatorët Selim Rusi dhe Naim Agolli, me banim në USA. Tashme mbetet të shihet ndryshimi dhe kursi që ekipi do të ketë në ndeshjet e ardhshme të fazës së dyte të kampionatit ,deri në muajin janar ku edhe mund të ketë ndërhyrje në merkato me emra të tjerë lojtaresh.

Deri tani rezultatet nuk kanë qenë sinkron me lojërat përgjithësisht të mira të zhvilluara, madje ndeshja më e dobët ishte humbja me Flamurtarin. 5 piket e grumbulluara ne 9-te takime nuk justifikojnë emrat e futbollisteve të cilët thuajse te gjithë kane luajtur ne kategorinë superiore. Kjo javë rezervon përballjen e vështirë me Laçin ne fushën e tij, ndërsa një javë më pas, skuadra udhëton në Korçë, përballë Skënderbeut kryesues.

Tetori i zi

i futbollit shqiptar

Bashkë me gjethet e vjeshtës në këtë muaj të dytë të kësaj stine, u këputen edhe disa prej yjeve të sportit, me emrat e të cilëve ishim mësuar një jetë të tërë.

Telat Agolli, Esat Rakiqi, Gezim Kasmi dhe Safet Berisha, janë katër figura interesante të futbollit, dhe jo vetëm, që tashme na mungojnë dhe nuk kemi fatin t'i shohim, as në ekrane, as në studio televizive e aq më keq, as në fusha futbolli apo arena cirku.

Arshiva dhe kujtesa, gjithnjë në raste të tilla na vjen në ndihmë dhe kujtojmë gjurmët që këta mjeshtra lanë pas, këta korifej të sportit shqiptar në Tiranë, Dibër e deri në Shkodër. Shkodrani Esat Rakiqi, fjalëpaku e punëshumi, ishte sinjali i parë i zymtësisë së një ikje të parakohshme, duke lënë në pikëllim jo vetëm qytetin djeplindës të futbollit, Shkodrën, por edhe të gjithë ata që mbajnë mend, Esat Rakiqin futbollist dhe Esat Rakiqin trajner e ndihmës trajner deri në këtë vit dhimbje të vjeshtes së 2016-tës. Ish futbollisti i viteve '60-'70 me Vllazninë, ka luajtur afro 297 ndeshje me kuq e blutë dhe ka shënuar 56 gola.

Po kaq trondítës ishte lajmi për dy ikonat e futbollit të Partizanit dhe Tiranës, por që i bënte bashkë ekipi kombëtar, Gëzim Kasmi dhe Safet Berisha. Mbrojtësi i pakalueshëm dhe potent Kasmi, por më shumë se kaq, qendërmbrojtësi vigan, që i ngjante një muri të fortë në mbrojtje Safet Berisha, lanë pas një boshllëk jo vetëm fizik, por edhe historik. Ata të dy, gdhendën thuajse të njëjtën histori me firmën e mbiemrave të tyre. Gëzim Kasmi ishte një mbrojtës i fortë e luftarak i Tiranës së viteve '60-'70, por që luajti denjësisht edhe atje ku e degdisën për tre vite radhas, në Skrapar me ekipin e "5 shtatorit". Biografikisht nuk pati fat të luante më shumë se katër ndeshje me uniformën kuq e zi. Ai ishte djaloshi që zbukuronte formatin sportiv të dinastisë Kasmi, bashkë me vëllezërit e tij, Kujtimin basketbollist dhe Bujarin futbollist.

Safet Berisha ishte një lojtar klasi, që erdhi nga "Lokomotiva" në vitin 1969 si ushtar, por që u bë shumë shpejt lider te Partizani. Aty shpërtheu e nuk diti të ndalej nga viti 1970 e deri në vitin 1983, sa te Partizani, po aq edhe te kombëtarja, duke patur edhe rolin e një kapiteni të madh me shiritin e besueshmërisë në krah. Në 12 vite, ai fitoi tre tituj kampion e tre kupa Shqipërie, pa harruar edhe 20 gola të shënuar në librin e artë të futbollit edhe pse një lojtar mbrojtës.

Në muzën e dhimbjes, por jo nga bota e futbollit, ishte edhe artisti sportist Telat Agolli, "Mjeshtër i Madh", dibrani i mirë që kish bërë vend në kryeqytet e shumëkush e mendonte si një tiranas të vjetër. Aktori dhe interpretuesi famoz në arenat e cirkut ishte bërë një figurë shumë e dashur për sportdashësit dhe spektatorët, si një mundës dhe peshëngritës kampion. Ai mbetet një emër i madh dhe një sportist universal, duke dhënë kontribute, sa në tapetin e mundjes, pedanen e peshëngritjes, aq edhe në arenën e cirkut.

Ky muaj mund të thuhet ndryshe si tetori i zi, sepse solli lajme që indinjuan të gjithë ata që i kanë njohur dhe njohën sadopak sportin dhe futbollin. Përmes ceremonive dhe respektit të pafund, në ditët e lamtumirës së tyre, ata morën me vete homazhin e duhur, ndërsa si një testament i gjallë do t'ju mbesë pas brezave, rruga e bukur dhe e suksesshme e tyre. Ata ecën me këmbët e veta në karrieren e tyre, pa sforco, pa miq dhe pa parti. Ata ecën në jetë si mjeshtra të mëdhenj, ndërsa ikën nga kjo jetë, si njerëz të thjeshtë, ashtu si vetë sporti që bënë për dekada me radhë.

Defrim Methasani

portret

Pavdekësia e Izet Ketës mes dy kohëve

Nga **AZIZ KETA**

Fshati Koçe në Bulqizë vazhdon të quhet "Ballkoni Fushës së Madhe". Ruajti e emrin e krishterë të vendbanimit me emrin Koçe, që me gjasa ishte prijësi Koço, që i vuri emrin vendbanimit (Y.Keta). Më 23 nëntor 1949, mbas tre morekujeve të zgjatura për humbje në luftë të tre burrave të kësaj kulle kur kishte mbaruar lufta, tre fishekë jepnin lajmin e gëzimit: lindi Izeti.

Kulla e ndërtuar në vitet 1800 nga Halil Keta i vjetër, pas tre viteve të fundit të luftës, do kishte dhe pesë vdekje të tjera të mëdha, të gjitha aksidentale. E vetmja shpresë mbijetese ishte djepi dhe vazhdimësia e ngjitjes së emrave të vjetër. Kjo ishte arsyeja që Izet Keta do përkundej në djepin e Halil Ketës së vjetër. Ende nuk kemi gjetur në arkiva kush ishte i pari, por sot kemi të përsëritur tre herë emrin Halil dhe Ymer Keta, katër herë Brahim Keta i Ri (Folklori 7 i Dibrës) dhe dy herë emri i Asllanit. Djepet kanë simbolin e shqiponjës dhe kulla 300 vjeçare ka në një pllakë guri ku shkruhet: Atdheu mbi të gjitha!

Ja pse, nuk duhet të çuditemi pse djemtë e ri të Ketës, dalin tre here kampionë Bote. Ishin pasues në sport të Izet Ketës, që e filloi mundjen që në moshën 16 vjeçare, duke punuar në vagon kromi dhe ushqyer me bukë misri. Konkurrojë denjësisht në kategorinë superiore për të rritur (1965- 1970) dhe do bëhej "Krenaria e Mundjes Dibrane" dhe asaj shqiptare, që shokët do i vinin nofkën "Arusha" (Xh. Cibaku).

Ja pse është vazhdimësi dhe jo rastësi. Tre djemtë e Ketës, gazetari Defrim Methasani i ka quajtur "Dinasti", sepse sa herë që dalin në ring në Gjermani, do valëvisin Flamurin Shqiptar dhe në gjoks do të mbajnë një shqiponjë të qëndisur në fije ari mbi të kuqen e gjakut, si hajamali. Në krah portretin e Skënderbeut dhe në djepet e vazhdimësisë së gjakut, të pastërtisë rracës, emrat Gjergj dhe Arianit.

Dikush këto mund ti quaj zbukurime folklorike, por nëse do gjeni kohën të studioni historinë e këtij fisi, befasitë janë nga më të çuditshmet dhe faktet janë të blinduara në më shumë se dy burime arkivore dhe historike plus analizave të tërthorta.

Kulla e Ketës në Koçe, dëshmitare e "Betejës Drinit" (1844) me Sheh Zerqanin prijës, të "Betejës Xixullës me" Sheh Fejzë Bulqiza" prijës, të dy luftrave Ballkanike dhe të Luftës Nacional Çlirimtare ku kjo kullë i dha tre të rënë për Atdhe, përkund historinë e djeshme dhe të sotme.

Izet Ketën do e gjejmë në komisionin nismëtar të krijimit të PD-së kur fillojë pluralizmi në Shqipëri në vitet '90- të. Do ishte ai pluralizëm që do kërkonin burrat e këtij fisi qysh në vitin 1945 dhe Halil Keta në Kovashicë të Maqellarës, do përsëriste Matrazovin e Luftës Dytë Botërore. I vuri gjoksin mitralozit të diktaturës dhe, i plagosur, nuk ja fali shpirtin dreqit por Drinit. E skuqi Drinin me gjakun e tij dhe u bë byrazer me të. Dhe populli i zonës, edhe sot atij shullani ku luftoj Halil Keta, edhe se nuk ka varr, i thonë "Vorri Halil Ketës". Edhe gurrës ku piu ujë do i mbetej emri "Gurra e Halil Ketës". Edhe vendi ku ra dëshmor Izeti, i thonë "Galeria e Izet Ketës". Edhe livadhit ku djemtë e Ketës ringritën kështjellën fushore dhe Gjetani bëri atë fitore të famshme me rusin, një plak do thoshte:"Ky është Gjorgu i Ri, porsi dre'/ që lag shpatën në liqe".

Prej kësaj kulle të Ketës në Koçe, ashtu si dhe prej asaj të Karajit, Duriçit, Hupit, etj. bulqizakët bashkë me grykamëdhejtë dhe martaneshasit i zunë istikamet në gjithë pe-

riudhat historike që luftuam kundër ushtrive të huaja (L.Hanku).

DASMA E GJAKUT, NJË FAKT HISTORIK

Izet Keta ishte 12 vjeç, kur e pyeti katragjyshen e vet: Çdo me thenë tre herë i prekun dhe "dasëm gjaku". Plaka i thotë: "Halil Keta i vjetër ka një histori që nuk e mbajnë këto trenë. Asaj i thonin sepse nisi për dasëm dhe përfundoj me gjak. "Dasmorët e gjakut! Para se të bëheshin me gjak, ishin njerëz të mirë, miq me njëri-tjetrin. U pritën me lodra por u përcollën me "morekujej!". Dasma nisi me lodra, me valle shpata, duke u marrë ngrykë kry më kry dhe përfundoj në sherr për një qefmbetje mes valle burrash. Se dasmën nuk e bëjnë vetëm lodrat, por dhe dasmorët...

Halil Keta, ende pa shkuar brisk në faqe (1914), do çarmatoste austrogungarezët në shenjë revolte pse do mblidhinin armët në Bulqizë. Kur u hap shkolla e parë ushtarake shqiptare e xhandarmërisë, do ishte nxënësi i parë i saj dhe në vitin 1926 del me gradën aspirant (AQSH). Më 1928 e gjejmë me gradën toger. Befasi: marrje e tre gradave brënda dy vjetëve, dhenja e detyrës së lartë të komandantit të kufirit në vijën Kukës – Librazhd dhe, bashkë me gradimin e parakohshëm, i dhurohet me ceremoni në "Oborr Mbretëror" pistoleta me mbishkrimin e larë në ar: Zogu i Parë!

Po ky Halil, do përfaqësonte Bulqizën në "15 Vjetorin e Shpalljes Pavarësisë" më 1927. Në shtator 1942, në kthim nga PEZA, do e priste Haxhi Lleshin në sofër buke të Kullës në Koçe. Halilit ju kërkua që bëhej pjesë e Luftës por ai dha arsye të forta ekonomike pse ja bënte të pamundur marrjen pjesë: ishin 40 goja që prisnin nga rroga e tij në Kodër Koçe shkëmb e gurë. Por ranë dakort: nga kulla e Ketës të dilnin partizanë Asllani dhe Dalipi.

Çfarë ndodhi më vonë, kur Shqipëria ishte e çliruar? Asllani, komisar batalioni në Br18S do sëmurej në luftë dhe do vdiste pas lufte, në shtrat. Emrin e tij, mbasi ishte shpall dëshmor, do e merrte shkolla e Fushë Bulqizës.

Halili, nuk pranojë komunizmin e pasluftës, do etiketohej bashkëpunëtor fashizmi edhe se nuk pati asnjë vendim gjykate për të dhe u vra pa gjyq.

Izet Keta do quhej i prekur aq sa rezervoheshin moshatarët e tij të uleshin në një bankë me të. Mbarojë shkollën shtatëvjeçare me rezultate shumë të mira por askush nuk i dha Izet Ketës të drejtë studimi për shkollë të mesme.

IZET KETA MES PLAGËVE TË SHPIRTIT DHE ZJARRIT

Për Izetit,"Plaga e shpirti" ishte damkosja "si berr" me vulën "i prekur" që do të thoshte: i persekutuar në katër breza. Vetëm punë nën tokë por jo "zjarrmëtar" sepse, lënda plasëse në dorë të një të "prekuri" mund të ishte rrezik për "pushtetin popullor".

Plagë shpirti se, edhe se bënte më shume një plan dhe në sektorët më të vështirë ku rreziku për jetën ishte në çdo sekondë, vetëm marteli do ishte e vetmja pajisje që i ishte besuar. Sepse ajo ishte puna më e vështirë. Fëmijëve të tij, njëlloj si ai, nuk do ju jepej shkolla e lartë.

Plagë shpirti se do bënte ushtri "pa të drejtë mbajtje arme", vetëm në xhenjo, përsëri nën tokë sepse, martelin, e kishte "armë zjarri brezi" që nga Bulqiza.

Plagë shpirti sepse, ndërsa eprorët e tij do jepnin vlerësime maksimale për cilësinë e punës dhe vlerat intelektuale që kishte, atij, nuk do i jepej asnjë hapësirë për t'u shfaqur.

DISA VLERËSIME PËR IZET KETËN:

Hamza Gurra, ish drejtor i Minjerës Veriore: "Minator i paarritshëm. Perëndia ishte treguar bujare me Izetin se i kishte dhenë një trup shumë të fuqishëm ç'ka e bëri në gjithë minierën një emër të njohur. Punoi në Pusin Nr. 2 në sektorët më të vështirë të prodhimit/shembjeve ku diferenca midis niveleve shkonte deri në 70 metra. Ishte shumë e vështirë lidhja midis niveleve me furnela. Në gjithë minierën, vetëm dy veta përballonin këtë shkallë vështirësie dhe i pari ishte Izet Keta".

Prof. Dok. Gafur Muka:" Kam patur fatin ta njoh Izetin në rrugëtimin e tij aktiv. Njeriun e fortë, serioz, që gjithë sa merrte përsipër i realizonte. Kishte një seriozitet në dëgjim që ja shprehte krejt qartë fytyra e tij burrërore. Kishte një fjalëdhënje që të impononte besim të plotë. Kishte një punëbërje që të inkurajonte. Kishte respekt shqoqëror që e demonstronte krejt pa lajka. Izeti iku nga kjo Botë, për të mbetur për të gjithë ata që e kanë njohur, si një njeri me mision të pa përfunduar. Ai nuk e konsumojë forcën e tij fizike sepse iku me fuqinë e " Arushës". Ai nuk mori dot shpërblimin e merituar, pasi shpërblimdhënësit e donin vetëm për punë."

Xhelil Cibaku: "Izeti ishte shumë i fortë. Edhe në moshën 66 vjeçare kur mori Medaljen "Nderi i Mundjes Shqiptare" në Pallatin e Sportit "Bashkim Lala" në Peshkopi, tentova t'a shtërngoja por nuk munda. Ta lidhja me të dy krahët për beli, por nuk munda. Se shpatullat dhe gjoksi i tij ishin aq të gjëra dhe të fortë si gurë, si shkëmbi i Korabit".

Besnik Çupi: "Izet Keta ishte minatori më i madh i minierës-vdekjes. Shtatë burra ka mundur. I vuri si thasë çimentoje sipër njëri-tjetrit. Ishte i rrallë. Super i ndershëm. Guximtarë. Luan i fortë. Punëtor dhe drejtues i palodhur".

Ymer Keta: "Izeti, 40 vjet nën tokë, nuk gërvishti një gisht. Shumë e dyshimtë vdekja e tij aksidentale. Është i mbi i 400-ti minator, dëshmor i nëntokës, në 50 vjet. Këto shifra do të ishin të frikshme dhe për një luftë të rregullt frontale. Kam shkruar me dhimbje për minatorët e rënë në detyrë se mund të isha dhe unë pjesë e tyre. Kam synuar evidentimin dhe përjetësimin e këtyre heronjve dhe nxitjen e studimeve të thelluara për parandalimin e humbjeve të pakthyeshme sepse ende shifrat janë alarmuese."

Selim Pira, burrë i rëndë, **90 vjet Korab** në këmbë

Është një kënaqësi dhe detyrim për mua të shkruaj disa rreshta për një veteran të nderuar e të respektuar, i cili vjen sot në 90-vjetorin e lindjes aq i freskët e aq energjik, i palodhur dhe dashamir. Që i ri Selimi ishte një luftëtar trim e guximtar i Brigadës së 18 Sulmuese të Dibrës e më pas një kuadër i lartë e shembullor në të gjitha funksionet e ndryshme që ai kreu në radhët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Kudo ku ka punuar e drejtuar është karakterizuar nga veti e virtyte model e shembullor i cili me inteligjencën për t'i kuptuar e trajtuar problemet me ndershmëri të lartë e metodë efikase pune, me ndërgjegjen dhe shpirtin e sakrificës, gjithmonë në ballë të vështirësive dhe gjithmonë i suksesshëm.

Selim Pira, i brumosur me moralin e lartë dhe besnikërinë ndaj idealeve të larta të Atdhedashurisë nuk i njohu kurrë përkuljen e nënshtrimin ndaj padrejtësisë por as fodullëkun e as indiferencën ndaj shokëve e kolegëve të tij. Ai është i ndjeshëm e i vëmendshëm si dhe i papërtuar ndaj halleve e shqetësimeve të njerëzve në nevojë gjithnjë pranë tyre i preokupuar dhe i angazhuar në dëgjimin e zgjidhjen e shqetësimeve të tyre. Sepse është i mbrujtur kështu, sepse është i tillë, ai nuk e ndërpret këtë aktivitet e dhunti prej fisniku edhe në jetën e pensionistit. Sigurisht që njeri i dijshëm dhe i freskët nga memoria por edhe tepër energjik e i palodhur si Selimi nuk mund të qëndroj dot indiferent ndaj jetës shoqërore.

Ai është i kudondodhur si aktivist shoqëror si në Komitetin Kombëtar të organizatës së veteranëve të LANÇ ku ka marrë titullin "Nderi i organizatës së Veteranëve të LANÇ" ashtu edhe në shoqatën e Ushtarakëve të Liruar e në Rezervë. Për merita të veçanta trimëria atdhetarie e patriotizmi si dhe të punës drejtuese e komandues, është dekoruar me shumë urdhra e medalje të ndryshme. Të gjitha vlerësimet që mund t'i bëhen Selimit për vlerat, kontributet apo nderimet në radhë të parë ato janë merita individuale të tij, por për mua si njohës i Dibrës, ai trashëgon edhe vlerat aq të larta, të adhurueshme e të jashtëzakonshme të Dibranëve të cilët në gjithë historinë tonë të vjetër e të re njihen si njerëz me mençuri, urtësi e drejtësi të rrallë trimërie, Atdhetari e drejtësi të pafund, ndershmëri e bujari që të mrekullon e lumturon.

Djemtë dhe vajzat e Dibrës kudo ku janë, ku punojnë e jetojnë janë një vlerë e rrallë dhe e admirueshme, një shembull nga mund të mësojmë e të frymëzohemi. Me këtë rast unë i uroj shokut dhe mikut tim të nderuar Selim Pira jetë të gjatë dhe gëzime e lumturi së bashku me familjen dhe miqësinë e tij.

VEXHI GJONI

Ish-komandant i Divizionit të Dibrës

Botime të reja nga M&B

I gjeni pranë stendës së Botimeve M&B në Panairin e Librit në Pallatin e Kongreseve nga data 9-13 Nëntor 2016



XHAFER MARTINI
Kanuni i Dibrës - *Trashëgimi etnojuridike*
ISBN 978-9928-172-77-8
480 faqe/ Çmimi: 1500 leke

Kanuni i Dibrës vjen si dëshmia më e madhe dhe më e plotë e tipologjisë së civilizimeve lokale shqiptare. I njëkohshëm dhe i barabartë për nga rëndësia me "Kanunin e Lekë Dukagjinit" dhe me "Kanunin e Skënderbeut" (me variantet dhe invariantet e tij), – "Kanuni i Dibrës" ka të përbashkëta dhe dallime nga dy të parët. Më hollësisht këto dallime do t'i gjeni në "Hyrjen" e mbledhësit të këtij Kanuni, shkrimtarit dhe kulturologut të mrekullueshëm, Xhafer Martini. Këtu vlen të përmend vetëm një veçori dalluese të Kanunit të Dibrës – papraninë (mospërfshirjen) e institucioneve religjoze (kishës e xhamisë) duke mos privilegjuar e favorizuar në sanksionet kanunore as klerin. Nga ana tjetër, përpos barazisë së rreptë të rregullit, të cilit duhet t'i nënshtrohet gjithkush njëlloj, pa dallim, – Kanuni i Dibrës spikat për një elasticitet më human e vetëpërmbajtje më të thellë në shumë çështje "të nxehta" si "Gjakmarrja", "Hakmarrja", "Gjaku", "Xhipi"etj.

Një tjetër "avantazh" i këtij Kanuni është sasia e bollshme e fakteve, detajeve dhe e rrëfimeve të vërteta që ballafaqohen e pranëvihen gjegjësisht me tabutë e sanksionuara dhe përkufizimet e së drejtës, duke i dhënë Kanunit dimension të gjallë sintetik. "Kanuni i Maleve të Dibrës" është dëshmia monumentale e asaj "Atlantide" civilizimi të kredhur në memorien dhe etnopsikikën e dibranit. Jehona dhe energjia pozitive e kësaj "vatre civilizimi" dërgon impulset veta sipas ligjësish të ndërdukshme në momente krizash e gjëmash sociale. Vigjilenca intuitive dhe ndjeshmëria e komunikimit me këtë kod të lashtë etiko–social, lyp, para së gjithash, të jesh një recipient jo banal, përkundrazi: ta perceptosh veten në epiqendër të interferencës së këtyre valëve me urtësi mijëvjeçare dhe të dish ta transfigurosh këtë trashëgimi të vyer sipas një evolucioni "krijues" ndërpersonal.

Agron Tufa

MUNIR SHEHU
Dibra në shekujt e sundimit osman
ISBN 978-9928-172-95-2
124 faqe/ Çmimi: 700 leke

Askush nuk mund të thotë se këto këngë e gojëdhëna u trilluan ashtu, kot së koti nga populli. Ato e kanë një burim, për këtë as që mund të dyshohet. Në to shihet qartë vringëllima e shpatës, lufta për mbijetesë, për liri.

Burimi është populli, vetë historia e tij. Pra, mund të konsiderohen si dokumente historike për ngjarjet që përshkruhen në to.

Çështja e folklorit me burim shumë të vjetër është si puna e muzikës. Nuk mund ta lexosh melodinë pa parë më parë çelsin e muzikës në krye të pentagramit.

Ashtu si për muzikën, që, këtë çelës nuk mund ta gjesh gjëkundi, vetëm në muzikë, po ashtu edhe për folklorin, këtë çelës nuk mund ta gjesh gjëkundi, vetëm në folklor, d.m.th., në popull.

Munir Shehu

10 vjet gazeta Rruga e Arbërit

ATA E PREMTUAN NDËRTIMIN E RRUGËS SË ARBRIT POR NUK E MBAJTËN FJALËN. NE PUNUAM SË BASHKU PËR GAZETËN "RRUGA E ARBËRIT" DHE E NDËRTUAM PËRMES LIRISË SË FJALËS DHE MENDIMIT, ME PËRKUSHTIM DHE DASHURI!

Abdi Baleta, Abdi Shehu, **Abdurahim Ashiku**, Abdyl Koleci, Adela Halo, **Adem Bunguri**, Adi Darsi, Adrian Blackledge, Afrim Karoshi, Agim Baçi, Agim Boba, Agim Çadri, **Agim Deva**, Agim Gjini, Agim Kaba, Agim Kasa, Agim Shenjatari, Agim Vinca, Agron Sela, **Agron Tufa**, Agron Xhagolli, Agustin Gjinaj, Ahmet Çaushi, Ahmet Kamberi, Ahmet Përleka, Albert Vataj, Albert Zholi, Aleko Minga, Aleksandër Çipa, Ali Hoxha, Ali Koçeku, Ali R. Berisha, Alma Mile, Andi Balla, Andon Andoni, Aneta Cani, Aqif Ademi, Aqif Karaj, Aqif Ymeri, Arbana Qormemeti, Arben Muka, Arbër Lleshi, Ardian Reçi, Ardit Selami, Ardita Abdiu, Aria Sukniqi, Arian Avrazi, Arian Kadiu, Ariola Lami, Arjana Tollja, Arjeta Tafçiu, Armond Duraku, Arqile Teta, Arsim Kolari, Artan Gjyzel Hasani, Artan Hoxha, Artan Lame, Arthur Nelsen, Artin Spahiu, Astrit Balliu, Astrit Gjunkshi, Astrit Hoxha, Atli Dema, Avni Alcani, Axel Kronholm, Baftjar Gazidede, Bajram Hyseni, Bajram Xhafa, Bardhyl Agasi, Bardhyl Berberi, Bardhyl Marku, Bardhyl Xhama, Bashkim Frangu, Bashkim Lami, **Bashkim Lleshi**, Bashkim Rama, Bedri Tahiri, Begzad Baliu, Behar Gjoka, Ben Andoni, Bena Kërluku, Beqir Ajet Shehu, Beqir Sina, Bernard Zotaj, Besnik Alku, Besnik Rama, Blerim Lazimi, Bleta Qormemeti, Bujar Kapexhiu, **Bujar Karoshi**, Bujar Leskaj, Bujar Plloshtani, Bujar Vitija, Dali Horeshka, Dali Noka, Dali Tërshalla, Dalip Greca, Danjel Bica, Dashmir Zaçe, Dashnor Kaloçi, Daut Shehi, Dedë Llesh Doçi, **Defrim Methasani**, Dejang Nova, Denis Lushi, Destan Rama, Dhimitër Shtëmbari, Dhori Qiriazi, **Dionis Xhafa,** Dita Torte, Dragush Totozani, Dritan Bocku, Dritan Murrja, Drite Ademi, Driton Zenku, Dukagjin Hata, Dylbin Reçi, Edibe Selimi - Osmani, Edison Balla, Edison Ypi, Edlira Haxhiymeri, Edmond Hasani, Edmond Zhulali, Eduard Abazi, Eduard Ilnica, Elliot Hasan Moglica, Elmaz Lala, Elona Mazari, Elvana Zaimi, Emrie Skuka, Engjëll Celibashi, Ëngjëll Musai, Enver Halili, Enver Hysa, Enver Kaloshi, Eqrem Basha, Eralda Skarra, Erisa Saraçi, Ermir Dizdari, Ermir Hoxha, Ermira Isufaj, Ermira Shehu, Esat Ruka, Eshref Ymeri, Esmeralda Bica, Esmeralda Ilnica, Eva Gjura, Eva Zaimi, Evi Melani, Faik Bruçi, Faik Prençi, Faik Xhani, Faruk Kaba, Fatbardh Cena, Fatjon Pandovski, Fatmir Delishi, Fatmir Minguli, Fatmir Terziu, Fatmir Zhuzhi, Fatos Baxhaku, Fehmi Lleshi, Fejzulla Gjabri, Femi Sufaj, Ferit Fixha, Fitim Dika, Flamur Hadri, Flora Nikolla, Florika Bushi, Gafur Muka, Gafur Zota, Gafur Zoto, **Gazmend Kërkuti**, Genc Melonashi, Genci Luarasi, Genta Nishica, Geri Selenica, Gëzim Alpion, Gjergj Marku, Gjergji Mima, Gjokë Beci, Gjon Fierza, Gjon Ndreja, Grehans Uka, Hajredin Toca, Hajri Mandri, Hajri Shehu, Hajrush Mani, Haki Duka, Haki Kola, Haki Përnezha, Halil Rama, Halil Robi, **Halil Teodori**, Hamdi Hysuka, Hamdi Skeja, Hamit Taka, Hamit Vata, Hane Burnett, Hasan Leka, Hasan Lleshi, Hasan Pasha, Hekuran Vladi, Hilë Lushaku, Hyqmet Gonxhja, **Hysen Likdisha**, Hysen Mirku, Hysen Repa, **Hysen Uka**, Hysni Bruçi, Hysni Stafasani, Ibrahim Egriu, Ibrahim Kolari, Ibrahim Milushi, Ida Nurçe, Idriz Xhomara, Ilir Krosi, Ilir Sinanaj, Ilir Spata, Ilirjana Sulkuqi, Iljaz Bobaj, Iljaz Kaca, Ilmi Dervishi, Ina & Erta Disha, Ina Xhaferi, Inva Halili – Kuhn, Isa Halilaj, Islam Cani, Islam Çenga, Islam Sharofi, Ismail Hysa, Isuf Miho, Isuf Salla, Iva Cipuri, Ivzi Çipuri, Jahe Delia (Selmani), Jani Thomai, Jera Isakaj, Jorgji Muzaka, Jorgo Bulo, Kadri Dauti, Kamber Faruku, Kastriot Caka, Keze (Kozeta) Zylo, Klara Kodra, Krenare Ollogu, Kristo Zharkalliu, Kristofor Beduli, Kujtim Boriçi, Kujtim Osmani, Laura Papraniku, Laurant Bica, Lavderim Shehu, Liman Hoxha, Lindita Çela, Lisien Bashkurti, Llazar Semini, Luan Deda, Lulzim Çota, Lutfi Hanku, Lutfi Turkeshi, Mahir Jangulli, Mahmud Hysa, Majlinda Hoxha, Malvina Shehi, Marin Mema, Marius Dobrescu, Mark Tirta, Martin Cukalla, Mehdi Dema, Mehmet Dume, Melsi Tafa, Mendu Dema, Mentas Nasufi, Mentor Hoxha, Meral Ismaili, Mersin Hoxha, Metodija Velevski, Metush Skeja, Mevlud Buci, Mexhit Prençi, Mhill Velaj, Miftar Fana, Mimoza Erebara, Mimoza Shqefni, Mina Hysa, Mira Ymeraj, Miran Tafa, **Miranda Goleci**, Mirela Sula, Mirvet Lala, Moisi Murra, Molnar Kolaneci, Monika Stafa, Muhamet Bitri, Murat Gecaj, Murat Koltraka, Musa Kraja, **Musa Riçku**, Mustafa Tola, Muzafer Korkuti, Myhyr Hoxha, Myslim Islami, Nadire Skënderi (Murra), Naim Berisha, **Naim Plaku**, Naim Zoto, Namik Selmani, Naxhi Hasa, Ndue Dedaj, Nefail Spahiu, Neki Feta, Neki Kaloshi, Nerilda Meda, Nexhi Baushi, Nexhmie Mehmeti, Nikoll Kola, Nikolla Madzirov, Nin Gj. Rajta, **Nuri Abdiu**, Nuri Koleci, Odise Plaku, **Osman Xhili**, Pajtim Përnezha, Pandeli Koçi, Perikli Jorgoni, Përparim Luca, Përparim Spahiu, Përparim Tomçini, Petr Hlobil, Petrit Dunga, Petrit Fetahu, Petro Luarasi, Pjetër Jaku, Qamil Sula, Qazim D. Shehu, Qazim Hata, Qazim Prejsi, Qemal Skendo, Qenan Hasani, Qeram Cibaku, **Rakip Suli**, Ramadan Ajazi, Ramadan Ndreka, Ramazan Biba, Ramazan Buci, Ramazan S. Ilnica, **Ramiz Gjini**, Ramiz Lushaj, Ramiz Zekaj, Rasim Buci, Renato Totraku, Resul Bendo, Rexhep Doda, Rexhep Ndreu, **Rexhep Torte**, Rezehana Hysa, Rifat Malaj, Robert Reçi, Roland Çene, Roland Zisi, Rovena Vata, Rozi Theohari, Rremzi Ndreu, Rruzhdi Bitri, Rustem Deva, Ruzhdi Lata, Sabri Gjeçi, Sadik Lala, Saimir Shatku, Sakip Cami, Sali Ajazi, Sali Bushi, Samet Zagradi, Sami Milloshi, **Sashenka Ndreka**, Sazan Goliku, Sazan Guri, Sefedin Shabani, Sefulla Kata, Sejdi M. Hashi, **Selman Mëziu**, Shaban Bitri, **Shaban Sinani**, **Shaqir Skarra,** Shefki Aliti, Shefqet Hoxha, Shehat Cami, Shehat Marku, Shemsi Daci, Shemsi Manjani, Shemsi Prençi, Sherif Delvina, Shinasi Rama, Shkëlqim Lusha, Shkëlqim Shemsi Hatipi, Shpend Topollaj, Shpetim Cami, Shpëtim Hyka, Shpëtim Pollozhani, Shuaip Marku, Shukri Hajdari, Skënder Minxhozi, Sokol Çobo, Sokol Demaku, Spiro Xhavarra, Srecko Sekeljic, Stephen Schëartz, Suat Saqipi, Suela Lala, Sulejman Borova, Sulejman Tomçini, Syrja Stafa, Tefik Jegeni, Tefik Skera, Tefta Cami, Tefta Nuredini, Thanas Feka, Theodhori Karaj, Ulkie Sinani, Ullmar Qvick, Valbona Zunçe, Valeria Dedej, Valmir Gashi, Valter Shtylla, Vehbi Bajrami, Vehbi Hoti, Veip Proda, Veli Vraniçi, **Vesel Hoxha**, Vezir Muharremaj, Virion Graçi, Viron Kona, Vita Koja, Vojsava Leka, **Xhafer Martini**, Xhafer Seiti, Xhavit Deda, Xheladin Çelmeta, Xhelal Luca, Xhelal Marku, Xhelal Roci, Xhelal Zejneli, Xhelil Cibaku, Xhemail Ali Peci, Xhemal Domi, Xhemal Mato, Xhezair Abazi, Ylber Nuredini, Ylli Molla, Ylli Prapa, Ymer Keta, Ymer Stojku, Zabit Lleshi, **Zaim Elezi**, Zaim Korsi, Zamira Gjeleshi, Zef Çoba, Zejnel Sula

Rruga e Arbërit - aty ku fjalët nuk i merr era!

Bej "**Like**" dhe "**Share**". Qëndro me gazetën #rrugaearberit më pranë #Dibrës!

Rruga e Arbërit | rrugaearberit

Për më shumë informacion:
Tel: 00455 68 65 08 441. +355 **68 65 08 441** +355 **69 20 68 603**
Email: rrugaearberit@gmail.com | www.rrugaearberit.com

Klinika Mjekësore
"VENIS"

Klinika mjekësore "VENIS" është klinika e parë private e Shëndetit Mendor në Shqipëri, e licencuar nga Ministria e Shëndetësisë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) si një aktivitet i tatueshëm.

Në klinikën "VENIS" ofrohet një shërbim i standarteve bashkëkohore si përsa i përket diagnostikimit dhe opsioneve të trajtimit mjekësor jo vetem me skemat e mjekimeve më të reja me barna por dhe me aplikimin e terapisë biologjike të elektrokonvulsoterapise ECT-Thymatron IV (Teknologjia më bashkëkohore), për trajtimin e pacientëve, te të cilët trajtimi i mëparshëm me barna nuk ka dhënë rezultatet e duhura.

1. **DIAGNOSTIKIM.** Procesi i diagnostikimit të çrregullimeve psikologjike apo psikiatrike realizohet pas një ekzaminimi të kujdesshëm nga specialistët e shëndetit mendor të cilët janë psikiatrit ose psikologët klinikë.
2. **TRAJTIM I DEPRESIONEVE REZISTENTE.** Procedura e ECT-së është një procedurë që realizohet vetëm në klinikën "VENIS" në Shqipëri dhe në trojet e tjera shqiptare.
3. **TRAJTIM MJEKËSOR.** Në klinikët tonë ruhet privatësia e individit, respektohen dhe mirëkuptohen orientimi seksual, përkatësia etnike, gjinore, apo preferencat fetare.
4. **KONSULENCË PROFESIONALE LIGJORE.** Klinika mjekësore "VENIS" ju ofron informim dhe ndihmë konkrete ligjore mbi të drejtat e pacientëve.

MOS KINI PARAGJYKIME! Sa më herët të kërkohet ndihma e specializuar, aq më shpejt trajtohen çrregullimet e çdo lloji.

"Venis" ju ofron mbështetjen e duhur.
Klinika ofron shërbimet e saj vetëm në ditët e javës
Orari: 08:00 - 16:00 E Shtunë, E Diel dhe Festat zyrtare: PUSHIM
Vizitat kryhen me planifikim paraprak.
Kontakt: Sekretaria: **04 2400 669** dhe **068 23 96287**
E-mail: **sadikhlala@gmail.com**